

Marrës AV shumëkanalësh

Udhëzimet e përdorimit

PARALAJMËRIM

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj. Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo.

Mos e instaloni pajisjen në hapësira të kufizuara si p.sh. në rafta librash apo në mobilie inkaso.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, futeni njësinë në priza elektrike që mund të arrihen lehtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë.

Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është futur në prizë, edhe nëse vetë njësia është e fikur.

Presioni i tepruar i zërit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.



Ky simbol njofton përdoruesin për sipërfaqe të nxehta, e cila mund të jetë e tillë nëse preket gjatë punës normale.

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve të përcaktuara në Direktivën EMC për përdorimin e një kabloje lidhëse më të shkurtër se 3 metra.

Për klientët në Evropë



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe shtetet e tjera evropiane me sistem të diferencuar grumbullimi)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatesë të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Europe Only



Pb

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që vjen me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personeli i kualifikuar shërbimi.

Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.

Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Njoftim për klientët: Informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen Direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojeni adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit të garancisë.

Përmes kësaj, Sony Corp., deklaron se kjo pajisje është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/KE.

Për detaje, vizitoni adresën e mëposhtme: <http://www.compliance.sony.de/>



Rreth manualit

- Udhëzimet në këtë ky manual janë për modelin STR-DN1040. Numri i modelit ndodhet në këndin e djathtë të poshtëm të panelit të përparmë. Ilustrimet e përdorura në këtë manual janë të modelit për Evropën dhe mund të jenë ndryshe nga modeli juaj. Çdo ndryshim në funksionim shënohet në manual si "Vetëm modelet evropiane".
- Udhëzimet në këtë manual përshkruajnë funksionimin e marrësit me telekomandën e dhënë. Mund të përdorni gjithashtu edhe butonat ose çelësat e marrësit nëse kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm me ato të telekomandës.

Rreth të drejtave të autorit

Ky marrës përmban Dolby* Digital dhe Pro Logic Surround dhe DTS** Digital Surround System.

* Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Pro Logic, Surround EX dhe simboli me dy "D" janë marka tregtare të Dolby Laboratories.

** Prodhuar me licencë nën patentat amerikane me numër: 5,956,674; 5,974,380; 6,226,616; 6,487,535; 7,212,872; 7,333,929; 7,392,195; 7,272,567 dhe patenta të tjera amerikane dhe botërore të marra dhe në pritje. DTS-HD, Simboli dhe DTS-HD e Simboli bashkë janë marka të regjistruara tregtare dhe DTS-HD Master Audio është markë tregtare e DTS, Inc. Produkti përfshin dhe softuerin. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky marrës përmban teknologji High-Definition Multimedia Interface (HDMI™) (Ndërfaqe multimediale me definicion të lartë).

Termit HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, si dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

AirPlay, iPhone, iPod, iPod classic, iPod nano dhe iPod touch janë marka të Apple Inc., të regjistruara në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

Të gjitha markat e tjera tregtare dhe të regjistruara tregtare janë të pronarëve përkatës. Në manual nuk përcaktohen markat ™ dhe ®.

"Made for iPod" dhe "Made for iPhone" nënkuptojnë se një aksesor elektronik është projektuar për t'u lidhur në mënyrë specifike përkatësisht me një iPod ose iPhone dhe është certifikuar nga zhvilluesi i tij se përputhet me standardet e performancës së Apple.

Apple nuk është përgjegjëse për funksionimin e kësaj pajisjeje ose pajtueshmërinë e saj me standardet rregullatore dhe të sigurisë. Ju lutemi vini re se përdorimi i këtij aksesori me iPod ose iPhone mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.

DLNA™, logoja DLNA dhe DLNA CERTIFIED™ janë marka tregtare, marka shërbimi ose marka certifikimi të Digital Living Network Alliance.

Logoja "Sony Entertainment Network" dhe "Sony Entertainment Network" janë marka tregtare të Sony Corporation.

Wake-on-LAN është markë tregtare e International Business Machines Corporation në Shtetet e Bashkuara.

Windows dhe logoja e Windows janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.

Ky produkt mbrohet nga teknologji të caktuara që janë subjekt i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft Corporation. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencë nga Microsoft apo një filial i autorizuar i Microsoft.

Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.

"x.v.Color (x.v.Colour)" dhe logoja "x.v.Color (x.v.Colour)" janë marka tregtare të Sony Corporation.

"BRAVIA" është markë tregtare e Sony Corporation.

"PlayStation" është markë e regjistruar tregtare e Sony Computer Entertainment Inc.

"WALKMAN" dhe simboli "WALKMAN" janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.

MICROVAULT është markë tregtare e Sony Corporation.

VAIO dhe VAIO Media janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.

PARTY STREAMING dhe logoja PARTY STREAMING janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.

Simboli Wi-Fi CERTIFIED është shenjë certifikimi e Wi-Fi Alliance.

MHL, Mobile High-Definition Link dhe simboli MHL janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të MHL Licensing, LLC.

InstaPrevue™ është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e Silicon Image, Inc. në SHBA dhe në shtete të tjera.

FLAC Decoder

Të drejtat e autorit © 2000, 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007 Josh Coalson

Rishpërndarja dhe përdorimi në formë burimore dhe binare, me ose pa modifikim, lejohet me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Rishpërndarja e kodit burimor duhet të përmbajë njoftimin e mësipërm të të drejtës së autorit, këtë listë kushtesh dhe heqjen dorë nga përgjegjësia më poshtë.
- Rishpërndarja në formë binare duhet të riprodhojë njoftimin e mësipërm të të drejtës së autorit, këtë listë kushtesh dhe heqjen dorë nga përgjegjësia më poshtë dhe/ose materiale të tjera të dhëna me shpërndarjen.
- Emri i Fondacionit Xiph.org dhe as emrat e kontribuuesve të tij nuk mund të përdoren për të miratuar apo promovuar produktet e krijuara nga ky softuer pa lejen paraprake specifike me shkrim.

SOFTUERI JEPET NGA MBAJTËSIT E TË DREJTËS SË AUTORIT DHE KONTRIBUESIT "SIÇ ËSHTË" DHE HIQET DORË NGA ÇDO GARANCI E NDONJË LLOJI, DUKE PËRFSHIRË POR PA U KUFIZUAR ME, GARANCITË E NËNKUPTUARA TË TREGTUESHMËRISË DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR. NË ASNJË RAST FONDACIONI APO KONTRIBUESIT NUK DO TË JENË PËRGJEGJËS PËR NDONJË DËM TË DREJTPËRDREJTË, TË TËRTHORTË, RASTËSOR, TË VEÇANTË, SHEMBULLOR, APO PASUES (DUKE PËRFSHIRË, POR PA KUFIZUAR ME PROKURIMIN E MALLRAVE APO SHËRBIMEVE ZËVENDËSUESE; HUMBJE TË PËRDORIMIT, TË TË DHËNAVE OSE FITIMEVE, OSE NDËRPRERJE TË BIZNESIT) SIDO QË TË JETË SHKAKTUAR DHE SIPAS ÇDO TEORIE PËRGJEGJËSIE, QOFTË NË KONTRATË PËRGJEGJËSI TË CAKTUAR APO SHKELJE (DUKE PËRFSHIRË NEGLIZHENCËN OSE TJETËR) QË LIND NË NDONJË MËNYRË NGA PËRDORIMI I KËSAJ MARRËVESHJEJE, EDHE NËSE JANË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E KËTIJ DËMI.

Pasqyra e lëndës

Rreth manualit	3
Aksesorët e dhënë	8
Përshkrimi dhe vendndodhja e pjesëve	9
Fillimi	20

Lidhjet

1: Instalimi i altoparlantëve	23
2: Lidhja e altoparlantëve	25
3: Lidhja e televizorit	27
4: Lidhja e pajisjeve të tjera	28
5: Lidhja e antenave (ajrore)	33
6: Lidhja me rrjetin	34

Përgatitja e marrësit

Lidhja e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)	36
Ndezja e marrësit	36
Konfigurimi i marrësit me anë të Easy Setup	36
Konfigurimi i cilësimeve të rrjetit të marrësit	38
Guidë për përdorimin e ndërfaqes (GUI)	42

Funksionet bazë

Shfrytëzimi i figurës/zërit nga pajisjet e lidhura	44
Luajtja e një iPod/iPhone	46
Luajtja e një pajisjeje USB	48

Funksionet e sintonizuesit

Dëgjimi i radios FM/AM	51
Paravendosja e radiostacioneve FM/AM (Preset Memory)	52
Marrja e transmetimeve RDS	53

Përdorimi i efekteve zanore

Zgjedhja e fushës zanore	53
Rregullimi i balancuesit	57
Përdorimi i funksionit Sound Optimizer	57
Zgjedhja e llojit të kalibrimit	57
Përdorimi i funksionit Pure Direct	58
Rivendosja e fushave zanore në cilësimet e parazgjedhura	58

Përdorimi i Network Features

Rreth funksioneve të rrjetit të marrësit	59
Konfigurimi i serverit	59
Përdorimi i materialeve audio të ruajtura në server	65
Shijimi i Sony Entertainment Network (SEN)	68
Përdorimi i funksionit PARTY STREAMING	70
Shijon muzikë nga iTunes me AirPlay	72
Përditësimi i softuerit	73
Kërkimi për artikujt të caktuar me anë fjalësh kyçe	75

Veçoritë e "BRAVIA" Sync

Çfarë është "BRAVIA" Sync?	76
Përgatitja për "BRAVIA" Sync	77
One-Touch Play	77
System Audio Control	77
System Power-Off	78
Scene Select	78
Home Theatre Control	79
Remote Easy Control	79
Komandimi i pajisjes MHL	79
Ndërrimi i monitorëve që nxjerrin sinjale video HDMI	80

Veprimet e tjera

Kalimi mes audios dixhitale dhe analoge (INPUT MODE)	80
Përdorimi i foleve të tjera hyrëse video/audio (Input Assign)	81
Përdorimi i një lidhjeje me dy amplifikatorë	82
Përdorimi i funksioneve shumëzonëshe	83
Kthimi në cilësimet e parazgjedhura të fabrikës	85

Rregullimi i cilësimeve

Përdorimi i menysë "Settings"	85
Easy Setup	88
Menyja "Speaker Settings"	88
Menyja "Audio Settings"	92
Menyja "HDMI Settings"	94
Menyja "Input Settings"	95
Menyja "Network Settings"	96
Menyja "System Settings"	97
Funksionimi pa përdorur ndërfaqen GUI	97

Përdorimi i telekomandës

Programimi i telekomandës	103
Rivendosja e telekomandës	107

Informacion shtesë

Masat paraprake	108
Zgjidhja e problemeve	109
Specifikimet	121
Indeksi	124

Aksesorët e dhënë

- Udhëzimet e përdorimit (vetëm për modelin e Australisë) (ky manual)
- Udhëzuesi i shpejtë i konfigurimit (1)
- Udhëzuesi i referencës (1) (vetëm për modelin e Evropës)
- Telekomanda (RM-AAP103) (1)
- Bateri R6 (përmasa AA) (2)
- Antena FM me tel (ajrore) (1)



- Antena AM në formë kornize (ajrore) (1)




- Mikrofoni i optimizuesit (ECM-AC2) (1)



Futja e baterive në telekomandë

Futni dy bateri R6 (madhësia-AA) (të përfshira) në telekomandë. Ruani polaritetin e duhur gjatë vendosjes së baterive.




Shënime

- Mos e lini telekomandën në vende të nxehta apo me shumë lagështirë.
- Mos përdorni bateri të re së bashku me të vjetrat.
- Mos përzieni bateri me mangan me lloje të tjera baterish.
- Mos e ekspozoni sensorin e telekomandës ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose aparaturave që lëshojnë dritë. Duke vepruar kështu mund të shkaktoni keqfunksionim.
- Nëse nuk do ta përdorni telekomandën për një periudhë të gjatë, hiqini bateritë për të shmangur dëmtimet e mundshme nga rrjedhja dhe gjërryerja e baterive.
- Kur ndërroni ose hiqni bateritë, kodet programuara mund të shuhen. Nëse ndodh diçka e tillë, riprogramoni telekomandën (faqe 103).
- Kur marrësi nuk i përgjigjet më telekomandës, zëvendësoni të gjitha bateritë me të reja.

Përshkrimi dhe vendndodhja e pjesëve

Paneli i përparmë



1 I/O (ndezur/në gatishmëri) (faqe 36, 58, 85)

Treguesi mbi buton ndizet si më poshtë:

I gjelbër: Marrësi është i ndezur.

Portokalli: Marrësi është në modalitet gatishmërie, dhe

– "Control for HDMI" (faqe 94) ose "Network Standby" (faqe 96) është caktuar në "On".

– "Pass Through" është caktuar në "On"* ose "Auto" (faqe 94).

– Marrësi në zonën 2 është ndezur (faqe 84).

Fiket kur marrësi është në modalitet gatishmërie dhe "Control for HDMI", "Pass Through" dhe "Network Standby" janë caktuar në "Off".

* Vetëm për modelin e Australisë.

Shënim

Nëse treguesi pulson me ngadalë, po kryhet përditësimi i softuerit (faqe 73).

2 SPEAKERS (faqe 38)

3 TUNING MODE, TUNING +/-

Shtypni TUNING MODE për të përdorur një sintonizues (FM/AM). Shtypni TUNING +/- për të skanuar një stacion.

4 A.F.D./2CH, MOVIE, MUSIC (faqe 44, 53, 58)

5 Display panel (faqe 11)

6 SOUND OPTIMIZER (faqe 57)

7 INPUT MODE (faqe 80)

8 DIMMER

Rregullon ndriçimin e panelit të ekranit në 3 nivele.

9 DISPLAY (faqe 102)

10 Sensori i telekomandës

Merr sinjal nga telekomanda.

11 PURE DIRECT (faqe 58)


Treguesi mbi buton ndizet kur aktivizohet funksioni Pure Direct.

12 MASTER VOLUME (faqe 44, 92)

13 INPUT SELECTOR (faqe 38, 44, 81)

- 14** Foleja HDMI/MHL (VIDEO 2 IN)
(faqe 31)
- 15** Foleja Ψ (USB) (faqe 33)
- 16** Foleja AUTO CAL MIC
- 17** Foleja PHONES
Lidhet me kufjet.

Treguesit në panelin e ekranit



1 Treguesi i hyrjes

Ndizet për të treguar sinjalin aktual hyrës.

HDMI

Marrësi e njeh pajisjen e lidhur nëpërmjet një foleje HDM IN.

ARC

Zgjidhet hyrja e televizorit dhe diktohen Audio Return Channel (ARC).

COAX

Sinjali dixhital hyn nëpërmjet folesë COAXIAL (faqe 80).

OPT

Sinjali dixhital hyn nëpërmjet folesë OPTICAL (faqe 80).

2 PARTY

Ndizet kur aktivizohet funksioni PARTY STREAMING (faqe 70).

3 S.OPTIMIZER

Ndizet kur aktivizohet funksioni Sound Optimizer (faqe 57).

4 D.C.A.C.

Ndizet kur zbatohen rezultatet e matjes së funksionit Auto Calibration.

5 Treguesi i Dolby Digital Surround*

Ndez treguesin përkatës kur marrësi dekodon sinjalet përkatëse të formatit Dolby Digital.

 Dolby Digital

 TrueHD Dolby TrueHD

6 Treguesi DTS(-HD)*

Ndez treguesin përkatës kur marrësi dekodon sinjalet përkatëse të formatit DTS.

DTS DTS

DTS-HD DTS-HD

7 Treguesi i sistemit të altoparlantëve (faqe 37)

8 Treguesi i sintonizimit

ST

Ndizet kur marrësi sintonizohet në një transmetim stereo.

MEM

Ndizet kur është aktivizuar një funksion memorieje, si p.sh. Preset Memory (faqe 52) etj.

9 HDMI OUT A + B (faqe 80)

10 SLEEP

Ndizet kur aktivizohet Sleep Timer (faqe 15).

11 EQ

Ndizet kur aktivizohet balancuesi.

12 D.L.L.

Ndizet kur aktivizohet funksioni Digital Legato Linear (D.L.L.) (faqe 92).

13 D.R.C.





Ndizet kur aktivizohet kompresimi dinamik i gamës (faqe 93).

14 NEO:6

Ndizet kur aktivizohet dekodimi DTS Neo:6 Cinema/Music (faqe 55, 55).

15 Treguesi Dolby Pro Logic

Ndez treguesin përkatës kur marrësi bën përpunimin Dolby Pro Logic. Kjo teknologji dekodimi matricë e tingullit rrethues mund të përforcojë sinjalet hyrëse.

	PL	Dolby Pro Logic
	PLII	Dolby Pro Logic II
	PLIIx	Dolby Pro Logic IIx
	PLIIz	Dolby Pro Logic IIz

Shënim

Këta tregues mund të mos ndizen, në varësi të cilësimit së motivit të altoparantit.

16 ZONE 2

Ndizet kur aktivizohet veprimi në zonën 2.

17 A.P.M.




Ndizet kur aktivizohet funksioni A.P.M. (Automatic Phase Matching). Mund të caktoni vetëm funksionin A.P.M në funksionin DCAC (Digital Camera Auto Calibration) (faqe 90).

18 UPDATE

Ndizet kur është i disponueshëm një softuer i ri (faqe 73).

19 Treguesi i fuqisë së sinjalit LAN me valë

Ndizet për të treguar fuqinë e sinjalit të LAN-it me valë (faqe 40, 41).

- Nuk ka sinjal.
-  Fuqia e sinjalit është e dobët.
-  Fuqia e sinjalit është mesatare.
-  Fuqia e sinjalit është e fortë.

20 Treguesi i rrjetit LAN me kablo


Ndizet kur lidhet LAN me kablo.

21 USB




Ndizet kur zbulohet një iPod/iPhone ose një pajisje USB.

* Kur lexoni disqe të formatit Dolby Digital ose DTS, sigurohuni që të keni përfunduar lidhjet dixhitale dhe që INPUT MODE të mos jetë caktuar në "ANALOG" (faqe 80) ose të mos jetë zgjedhur "2ch Analog Direct".



Paneli i pasmë




1 Seksioni DIGITAL INPUT/OUTPUT

-  Foletë HDMI IN/OUT* (faqe 27, 30)
-  Foletë OPTICAL IN (faqe 27, 32)
-  Foletë COAXIAL IN (faqe 32)



2 Seksioni TUNER

-  Foleja FM ANTENNA (faqe 33)
-  Termialet AM ANTENNA (faqe 33)

3 Foletë e komandave për pajisjet Sony dhe për pajisje të tjera të jashtme

-  Foletë IR REMOTE IN/OUT (faqe 83)





4 Seksioni NETWORK

-  Foleja LAN** (faqe 35)
-  Antena e rrjeti LAN me valë (faqe 35)

5 Seksioni SPEAKERS (faqe 25)

-  +
-  -

6 Seksioni AUDIO INPUT/OUTPUT

-  I bardhë (L) Foletë AUDIO IN (faqe 32)
-  I kuq (R)
-  I zi Foletë SUBWOOFER OUT (faqe 25)
-  Foletë ZONE 2 OUT (faqe 83)

7 Seksioni VIDEO INPUT/OUTPUT (faqe 27, 32)

-  I verdhë Foletë VIDEO IN/OUT*

8 Seksioni COMPONENT VIDEO INPUT/ OUTPUT (faqe 27, 32)

● I gjelbër (Y):

● I kaltër (Pb) Foletë Y, Pb, Pr IN/
OUT*

● I kuq (Pa)


* Duhet të lidhni folenë HDMI OUT ose MONITOR OUT me televizorin për të parë figurën e zgjedhur hyrëse (faqe 27).

** Këtë fole mund ta përdorni dhe për mirëmbajtje dhe shërbim (faqe 96).

Telekomanda

Përdorni telekomandën e dhënë për të komanduar marrësin dhe pajisjet e tjera. Telekomanda është programuar paraprakisht për të komanduar pajisjet audio/video Sony. Telekomandën mund ta programoni dhe për të komanduar pajisje jo Sony. Për hollësi, shihni "Programimi i telekomandës" (faqe 103).

RM-AAP103



- 1 I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)**
Ndez marrësin ose e cakton në modalitet gatishmërie.
Nëse shtyp ZONE (20) për ta kaluar telekomandën në modalitet zone 2, energjinë për zonën 2 mund ta caktosh ndezur apo fikur me anë të I/⏻ (faqe 84).

Kursimi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë

Kur "Control for HDMI", "Pass Through" dhe "Network Standby" janë caktuar në "Off" dhe marrësi në zonën 2 është fikur.

- 2 AV I/⏻¹ (ndezur/në gatishmëri)**
Ndez ose fik pajisjet audio/video të programuara për komandim nga telekomanda.
Për të ndezur ose fikur televizorin shtypni TV (21) dhe pastaj AV I/⏻.

Shënim

Funksioni i AV I/⏻ ndryshon automatikisht çdo herë që shtypni butonat e hyrjes (5).

- 3 SLEEP**
Shtypni AMP (4), dhe më pas SLEEP për ta caktuar marrësin të fiket automatikisht në një kohë të përcaktuar. Sa herë që shtypni SLEEP, ekrani ndryshon në mënyrë ciklike si më poshtë:

0:30:00 → 1:00:00 → 1:30:00 →
2:00:00 → OFF

Këshilla

- Për të kontrolluar kohën e mbetur përpara se marrësi të fiket, shtypni SLEEP. Koha e mbetur shfaqet në panelin e ekranit.
- Kohëmatësi i Fjetjes do të anulohet kur vepron si më poshtë.
 - Shtypni përsëri SLEEP.
 - Përditësoni softuerin e marrësit.
 - Shtypni I/⏻.

TV INPUT

Shtypni TV (21) pastaj TV INPUT për të zgjedhur sinjalin hyrës (hyrje televizori ose videoje).

- 4 AMP**
Aktivizon funksionimin e marrësit për zonën kryesore (faqe 102).

- 5 Butonat e hyrjes²**
Zgjedh pajisjen që dëshironi të përdorni. Marrësi ndizet kur shtypni një nga butonat e hyrjes. Butonat e hyrjes janë paracaktuar për komandim automatik të Sony-t kur i zgjidhni. Gjithashtu mund ta programoni telekomandën për të komanduar pajisje jo Sony sipas hapave të "Programimi i telekomandës" në faqe 103.

- 6 HDMI OUTPUT (faqe 80)**

- 7 Butonat e numrave/tekst¹2)**

Shtypni
– për të paravendosur/për t'u sintonizuar te stacionet e paravendosura (faqe 52).
– për të zgjedhur numrat e pjesëve audio. Shtypni 0/10 për të zgjedhur numrin e pjesës 10 audio.
– për të zgjedhur numrat e kanaleve.
– për të zgjedhur shkronjat (ABC, DEF etj.).
– për të zgjedhur @ për shenjë pikësimi (!, ? etj.) ose simbole të tjera (#, % etj.) kur ju duhet të shkruani simbole për funksione të rrjetit.
Shtypni TV (21), pastaj butonat numerikë për të zgjedhur kanale televizive.

ENT (ENTER)¹

Jep vlerë pas zgjedhjes së kanalit, diskut ose pjesës audio nga butonat numerikë.

CHARACTER

Zgjedh llojin e simbolit për funksionet e rrjetit.
Sa herë që shtypni CHARACTER, lloji i simbolit ndryshon në sekuencë si më poshtë:
"abc" (shkronjat e vogla) → "ABC"
(shkronjat e mëdha) → "123" (numrat)

CLR (CLEAR)¹⁾

Shtypni

- për të fshirë një shkronjë për funksionet e rjetit.
- për të spastruar gabimin kur shtypni buton të gabuar të numrave/tekstit.

-/-¹⁾

Zgjedh modalitetin e futjes së kanalit, njëshifror ose dyshifror.

Shtypni TV (21), pastaj -/- për të zgjedhur modalitetin e futjes së kanalit.

>10¹⁾

Zgjedh numrat e pjesëve audio mbi 10.

INPUT MODE (faqe 80)

8 AMP MENU

Shfaq menynë për të komanduar marrësin (faqe 97).

9 ⊕¹⁾, ↕/↔/↔/↔¹⁾

Shtypni ↕/↔/↔/↔ për të zgjedhur elementet e menysë dhe më pas shtypni ⊕ për të vendosur/konfirmuar përzgjedhjen.

10 OPTIONS¹⁾

Shfaq dhe zgjedh artikuj nga menyte e opsioneve.

Shtypni TV (21), pastaj OPTIONS për të shfaqur opsionet e funksioneve të televizorit.

11 HOME¹⁾

Shfaq menynë e pajisjeve audio/video që kontrollohen aktualisht nga telekomanda.

Për shembull, shtypni AMP (4), pastaj HOME për të shfaqur menynë kryesore (faqe 43).

Shtypni butonat e hyrjes (5), pastaj shtypni HOME për të shfaqur menynë e pajisjes që dëshironi të kontrolloni.

12 ◀◀/▶▶¹⁾, ◀◀/▶▶¹⁾, ▶▶¹⁾²⁾, ||¹⁾, ■¹⁾

Anashkalo, prapa/përpara, luaj, pusho, ndalo veprimin.

PRESET +/-¹⁾

Zgjedh stacionet ose kanalet e paravendosura.

TUNING +/-

Kërkon stacionin.

D.TUNING²⁾

Kalon drejtpërdrejt në modalitetin e sintonizimit.

PARTY START/CLOSE

Fillon ose mbyll një PARTY (faqe 71).

PARTY JOIN/LEAVE

Bashkohet ose largohet nga një PARTY (faqe 71).

☰ (Guida)¹⁾

Shtypni TV (21), pastaj ☰ (Guida) për të shfaqur guidën e programeve në ekran.

REPEAT¹⁾

Luan një pjesë ose dosje audio në mënyrë të përsëritur.

SHUFFLE¹⁾

Luan një pjesë ose dosje në mënyrë të rastësishme.

13 PROG +/-¹⁾²⁾

Shtypni TV (21), pastaj PROG +/- për të kërkuar për TV channels e paracaktuara

SOUND FIELD +/-²⁾

Zgjedh një fushë zanore (faqe 53).

14 ALPHABET SEARCH

Kërkon për artikullin me anë fjale të posaçme (faqe 75).

ALPHABET PREVIOUS

Kërkon për artikullin e mëparshëm.

ALPHABET NEXT

Kërkon për artikullin e radhës.

PREVIEW (HDMI)

Zgjedh funksionin "Preview for HDMI". Aktivizon shikimin e një shqyrtimi të drejtpërdrejtë figurë-në-figurë të hyrjeve HDMI të lidhura në këtë marrës.

Shtypni vazhdimisht ↕/↔ për të zgjedhur secilin shqyrtim HDMI, pastaj shtypni ⊕ për të futur/konfirmuar përzgjedhjen. (Kjo veçori mundësohet nga teknologjia Silicon Image InstaPrevue™)

Shënim

Funksioni "Preview for HDMI" disponohet për hyrjen HDMI BD, DVD, GAME dhe VIDEO 2.

Këshilla

- Ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme:
 - Pajisja nuk është e lidhur me folenë e hyrjes HDMI.
 - Pajisja e lidhur me folenë e hyrjes së mbështetur HDMI nuk është e ndezur.
 - Hyrja aktuale nuk është hyrje HDMI.
 - Kur "Fast View" është e vendosur si "Off".
 - Kur një format i pambështetur i videos HDMI (480i, 576i, 4K, disa sinjale videoje 3D disa sinjale video të kamerës ose sinjale VGA) është si hyrje.
- Shqyrtimi figurë-në-figurë do të bëhet i zi kur ka sinjale video 3D ose 4K në hyrje.

TOP MENU¹⁾

Hap ose mbyll menynë kryesore të BD-ROM-it ose të DVD-së.

POP UP/MENU¹⁾

Hap ose mbyll menynë e posaçme të BD-ROM-it ose menynë e DVD-së.



15 iPhone CTRL

Hyn në modalitetin e kontrollit të iPod/iPhone kur përdorni iPod/iPhone.



MEMORY

Ruan një stacion gjatë përdorimit të sintonizuesit.

16 (Heshtja)¹⁾



Mbyll përkohësisht zërin. Shtypni butonin sërish për të rikthyer zërin. Shtypni TV ()¹⁾, pastaj  për të aktivizuar funksionin e heshtjes së televizorit.

17 (Volumi) +/-¹⁾

Rregullon nivelin e volumnit të të gjithë altoparantëve njëkohësisht. Shtypni TV ()¹⁾, pastaj  +/- për të rregulluar nivelin e volumnit të televizorit.


18 RETURN ¹⁾

Kthehet në menynë e mëparshme ose del nga menya kur në ekranin e televizorit shfaqet menya ose guida në ekran.

Shtypni TV ()¹⁾, pastaj RETURN  për t'u kthyer në menynë e mëparshme të televizorit Sony.

19 DISPLAY¹⁾

Shfaq informacionet në panelin e ekranit.

Shtypni TV ()¹⁾, pastaj DISPLAY për të shfaqur informacionet e televizorit.

20 ZONE (faqe 84)

21 TV

Ndërron funksionin e butonit të telekomandës për të aktivizuar butonat me ngjyrë të verdhë.

22 RM SET UP

Programon telekomandën (faqe 103).

23 PURE DIRECT (faqe 58)

¹⁾ Shikoni tabelën në faqe 18 dhe 19 për informacione rreth butonave që mund të përdorni për të komanduar secilën pajisje.

²⁾ Butonat VIDEO 2, 5, ►/D.TUNING dhe PROG +/SOUND FIELD + kanë pika të prekshme. Përdorini pikat e prekshme si referencë kur përdorni marrësin.

Shënime

- Shpjegimi i mësipërm shërben si shembull.
- Në varësi të modelit të pajisjes së lidhur, disa funksione të shpjeguara në këtë paragraf mund të mos funksionojnë me telekomandën e dhënë.

Për të kontrolluar pajisje të tjera Sony

Emri	TV	VCR	Luajtës DVD, grup DVD/VCR	Luajtës disqesh Blu-ray	Regjistrues HDD	PSX	Luajtës Video CD, luajtës LD
2 AV II/⏻	●	●	●	●	●	●	●
7 Butonat numerikë	●	●	●	●	●	●	●
ENT (ENTER)	●	●	●	●	●	●	● ^{b)}
CLR (CLEAR)			●	●		●	
-/--	●				●		
>10		●					●
9 ↕/↔/↔/↔, ⊕	●	●	●	●	●	●	
10 OPTIONS	●		●	●	●	●	
11 HOME	●	●	●	●	●	●	
12 I◀/▶I	●	●	●	●	●	●	●
PRESET +/-							
◀◀/▶▶	●	●	●	●	●	●	●
▶, II, ■	●	●	●	●	●	●	●
☰ (Guida)	●		● ^{a)}	●	●	●	
REPEAT							● ^{c)}
SHUFFLE							● ^{c)}
13 PROG +/-	●						
14 TOP MENU, POP UP/ MENU			●	●		●	
16 🚫 (Heshtja)	●						
17 🔊 (Volumi) +/-	●						
18 RETURN ↶	●		●	●	●	●	●
19 DISPLAY	●	●	●	●	●	●	●

a) Vetëm luajtësi DVD.

b) Vetëm luajtësi LD.

c) Vetëm luajtësi Video CD.

Emri	Terminal CATV dixhital	DSS	Marrës satelitor/ tokësor dixhital	Luajtës kasetash A/B	Luajtës DAT	Luajtës CD, luajtës MD
2 AV I/⏻	●	●	●		●	●
7 Butonat numerikë	●	●	●	●	●	●
ENT (ENTER)	●	●	●	●	●	●
CLR (CLEAR)						
-/--		●	●			
>10				●		●
9 ↕/↔/↔/↔, ⊕	●	●	●			
10 OPTIONS	●	●				
11 HOME	●	●	●			
12 I◀◀/▶▶I	●			● ^{d)}	●	●
PRESET +/-		●	●			
◀◀/▶▶	●			●	●	●
▶, II, ■	●			●	●	●
☰ (Guida)	●		●			
REPEAT				● ^{d)}	●	●
SHUFFLE						●
13 PROG +/-						
14 TOP MENU, POP UP/ MENU						
16 🔊 (Heshtja)						
17 🔊 (Volumi) +/-						
18 RETURN ↶	●	●	●			
19 DISPLAY	●	●	●	● ^{d)}	●	●

^{d)} Vetëm luajtësi B.

Fillimi

Ju mund të shijoni pajisjet tuaja audio/video të lidhura me marrësin duke ndjekur hapat e thjeshtë të mëposhtëm.

Përpara lidhjes së kordonëve, sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).


Instalimi dhe lidhja e altoparlantëve (faqe 23, 25)



Lidhja e televizorit dhe e pajisjeve të tjera (faqe 27, 28)

Cilësia e figurës varet nga foleja ku bëhet lidhja. Shihni ilustrimin më poshtë. Zgjidhni lidhjen sipas foleve të pajisjeve.

Rekomandojmë t'i lidhni pajisjet e videos nëpërmjet HDMI nëse kanë fole HDMI.



Figurë e cilësisë së lartë



Përgatitja e marrësit

Shihni "Lidhja e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)" (faqe 36) dhe "Ndezja e marrësit" (faqe 36).



Konfigurimi i marrësit

Shihni "Konfigurimi i marrësit me anë të Easy Setup" (faqe 36).



Konfigurimi i cilësimeve të daljes së zërit në pajisjen e lidhur

Për daljen e audios dixhitale shumëkanalëshe, kontrolloni konfigurimin e daljes së audios dixhitale në pajisjet e lidhura.






Për një luajtës Sony Blu-ray Disc, kontrolloni që "Audio (HDMI)", "BD Audio MIX Setting", "Dolby Digital/DTS", "Dolby Digital" dhe "DTS" të jenë caktuar përkatësisht "Auto", "Off", "Bitstream", "Dolby Digital" dhe "DTS" (prej datës 1 gusht 2012).


Për një PlayStation 3, pasi ta keni lidhur marrësin me një kablo HDMI, zgjidhni "Audio Output Settings" në "Sound Settings" dhe zgjidhni "HDMI" dhe "Automatic" (me versionin 4.21 të softuerit të sistemit). Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit që vijnë me pajisjet e lidhura.


Funksion për konvertim të sinjaleve video

Marrësi është i pajisur me funksion për konvertimin e sinjaleve video.

Sinjalet video dhe Component mund të nxirren si sinjale video HDMI. Mi konfigurim i paracaktuar sinjalet video që vijnë nga pajisjet e lidhura dalin sipas tabelës me shigjeta solide.

Foleja INPUT		Foleja OUTPUT
HDMI IN		HDMI OUT
COMPONENT VIDEO IN	 	COMPONENT VIDEO MONITOR OUT
VIDEO IN	 	MONITOR OUT

 : Del i njëjti lloj sinjali si ai në hyrje.

 : Sinjalet video konvertohen me zmadhim rezolucioni dhe pastaj dalin (deri në 4K).

Shënime mbi konvertimin e sinjaleve video

- Kur sinjalet nga VCR etj. konvertohen me zmadhim rezolucioni në këtë marrës dhe në vijim shikohen në televizor, në varësi të gjendjes së sinjalit video në dalje, imazhi në ekranin e televizorit mund të shfaqet i deformuar horizontalisht ose mund të mos duket figura.
- Nëse përdorni qark për përmirësim të figurës në VCR, mund të ndikojë në konvertimin e sinjalit video. Rekomandohet ta çaktivizoni këtë funksion në VCR.
- Dalja e figurës së konvertuar në HDMI nuk mbështet "x.v.Color (x.v.Colour)", Deep Color (Deep Colour) dhe 3D.
- Sinjalet video HDMI nuk mund të konvertohen në sinjale video Component dhe në sinjale video.
- Sinjalet video Component 1080p nuk mund të konvertohen me zmadhim rezolucioni.

Formatet dixhitale audio të mbështetura nga marrësi

Formatet dixhitale audio që mund të dekodojë marrësi varen nga foletë dalëse të audios në pajisjet e lidhura. Marrësi mbështet formatet e mëposhtme audio.

Formati audio [Display] (Ekрани)	Numri maksimal i kanaleve	Lidhja midis pajisjeve luajtëse dhe marrësit	
		COAXIAL/OPTICAL	HDMI
Dolby Digital [DOLBY D]	5.1	○	○ ^{c)}
Dolby Digital EX [DOLBY D EX]	6.1	○	○ ^{c)}
Dolby Digital Plus ^{a)} [DOLBY D +]	7.1	×	○ ^{c)}
Dolby TrueHD ^{a)} [DOLBY HD]	7.1	×	○
DTS [DTS]	5.1	○	○ ^{c)}
DTS-ES [DTS-ES]	6.1	○	○ ^{c)}
DTS 96/24 [DTS 96/24]	5.1	○	○ ^{c)}
DTS-HD Audio me rezolucion të lartë ^{a)} [DTS-HD HR]	7.1	×	○ ^{c)}
DTS-HD Audio kryesore ^{a)b)} [DTS-HD MA]	7.1	×	○
DSD ^{a)} [DSD]	5.1	×	○
PCM lineare shumëkanalëshe ^{a)} [PCM]	7.1	×	○ ^{c)}

a) Sinjalet audio nxirren në format tjetër nëse pajisjet luajtëse nuk përkohjnë me formatin. Për hollësi, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve luajtëse.


b) Sinjalet me frekuencë modulimi prej mbi 96 kHz luhen në 96 kHz ose 88,2 kHz.

c) Këto formate mbështeten nga MHL kur lidhni pajisje burim që mbështesin MHL në folenë HDMI/MHL (VIDEO 2 IN).

1: Instalimi i altoparlantëve

Marrësi mundëson përdorimin e një sistemi deri në 7.2 kanale (7 altoparlantë dhe 2 nën-vuferë).

Shembull i konfigurimit të sistemit të altoparlantëve



- A** Altoparlanti i përparmë (majtas)
- B** Altoparlanti i përparmë (djathtas)
- C** Altoparlanti qendror
- D** Altoparlanti rrethues (majtas)
- E** Altoparlanti rrethues (djathtas)
- F** Altoparlanti i pasmë rrethues (Majtas)*
- G** Altoparlanti i pasmë rrethues (Djathtas)*
- H** Altoparlanti lart përballë (Majtas)*
- I** Altoparlanti lart përballë (Djathtas)*
- J** Altoparlanti bas

* Nuk mund të përdorni njëkohësisht altoparlantët e pasmë rrethues dhe altoparlantët e lartë të përparmë.


Foni 5.1-kanalëshe

Për të shijuar në tërësi audio rrethuese shumëkanalëshe kinemaje duhen pesë altoparlantë (dy të përparmë, një qendror dhe dy shumëkanalësh rrethues) dhe një nën-vufer.


Foni 7.1-kanalëshe me altoparlantë të pasmë rrethues

Mund të përjetoni riprodhim të besnikërisë së lartë të DVD-ve ose audio të regjistruar me softuer nga Blu-ray Disc në format 6.1-kanalësh ose 7.1-kanalësh.

- Vendosija e fonisë 6.1-kanalëshe
Vendoseni altoparlantin e pasmë rrethues mbrapa vendit ku dëgjoni.




- Vendosija e fonisë 7.1-kanalëshe
Vendoseni altoparlantët e pasmë rrethues siç tregohen në figurën më poshtë. Këndi **A** duhet të jetë njësoj.




Foni 7.1-kanalëshe me altoparlantë të lartë të përparmë

Mund të shijoni efekte vertikale të tingullit duke lidhur dy altoparlantë të tjerë të lartë të përparmë.

Vendosni altoparlantët e lartë të përparmë – në një kënd 25° deri 35° .



– në një kënd prej $20^\circ \pm 5^\circ$ në lartësi.




Këshillë

Duke qenë se nën-vuferi nuk nxjerr sinjale tepër orientuese, mund ta vendosni ku të dëshironi.

2: Lidhja e altoparlantëve

Përpara lidhjes së kordonëve, sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).



A Kablo audio mono (nuk jepet)

B Kablo altoparlanti (nuk jepet)


- * Kur lidhni nën-vufer me funksion gatishmërisë automatike, çaktivizojeni funksionin kur shikoni filma. Nëse funksioni i gatishmërisë automatike është aktiv, ai do të kalojë automatikisht në modalitet gatishmërie në varësi të nivelit të sinjalit që dërgohet te nën-vuferi dhe mund të mos ketë dalje zëri.
 - ** Shënime mbi lidhjen e terminaleve SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B.
 - Nëse lidhni vetëm një altoparlant të pasmë rrethues, lidhjeni me L të këtij terminali.
 - Nëse keni foni tjetër, lidhjeni me këtë terminal.
- Caktojini terminalet SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B te "Front B Speakers" me anë të "Speaker Connection" në menyne Speaker Settings (faqe 90). Mund të zgjidhni sistemin e altoparlantëve të përparmë që dëshironi duke përdorur butonin SPEAKERS te marrësi (faqe 37)
- Mund të lidhni altoparlantët e përparmë me këtë terminal duke përdorur lidhjen me dy amplifikatorë (faqe 26).
- Caktojini terminalet SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B te "Bi-Amplifier Connection" me anë të "Speaker Connection" në menyne Speaker Settings (faqe 90).

Shënim

Pasi të keni instaluar dhe lidhur altoparlantin, sigurohuni të zgjidhni motivin e altoparlantëve që dëshironi te "Speaker Connection" në menyne Speaker Settings (faqe 90).

Lidhja me dy amplifikatorë

Nëse nuk po përdorni altoparlantë rrethues të pasmë dhe altoparlantë të lartë të përparmë, mund të lidhni altoparlantët e përparmë me terminalet SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B duke përdorur një lidhje me dy amplifikatorë.



Lidhni foletë në anën Lo (ose Hi) të altoparlantëve të përparmë me terminalet SPEAKERS FRONT A dhe lidhni foletë në anën Hi (ose Lo) të altoparlantëve të përparmë me terminalet SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B.


Sigurohuni që montimet metalike Hi/Lo të ngjitura te altoparlantët janë hequr, për të shmangur avaritë e marrësit.

Pasi të kryeni lidhjen me dy amplifikatorë, caktoni terminalet SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B te "Bi-Amplifier Connection" me anë të "Speaker Connection" te menyja Speaker Settings (faqe 90).

3: Lidhja e televizorit

Mund të shihni figurën e zgjedhur hyrëse kur lidhni foletë HDMI OUT ose MONITOR OUT me një televizor. Marrësin mund ta komandoni me ndërfaqe grafike (GUI). GUI ofrohet vetëm për HDMI OUT A dhe HDMI OUT B.

Përpara lidhjes së kordonëve, sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).



- A** Kabllo video Component (nuk jepet)
- B** Kabllo video (nuk jepet)
- C** Kabllo audio (nuk jepet)
- D** Kabllo optike dixhitale (nuk jepet)
- E** Kabllo HDMI (nuk jepet)

— Lidhja e rekomanduar
 - - - Lidhja alternative

Sony rekomandon përdorimin e kabllave të autorizuar HDMI ose të kabllave HDMI Sony.

Për të shijuar transmetimin e televizorit në një tingulli rrethues shumëkanalësh nga marrësi

* Nëse televizori mbështet funksionin Audio Return Channel (ARC), lidhni **A**.
Sigurohuni ta caktoni "Control for HDMI" në "On" në menyën HDMI Settings (faqe 77).
Nëse dëshironi të zgjidhni një sinjal audio duke përdorur një kablo të ndryshme nga ajo HDMI (p.sh., nëpërmjet një kordoni dixhital optik ose një kordoni audio), ndërrojeni modalitetin e hyrjes audio duke përdorur INPUT MODE (faqe 80).

Nëse televizori nuk mbështet funksionin ARC lidhni **C ose **D**.

Sigurohuni të fikni volumin e televizorit ose të aktivizoni funksionin e heshtjes së televizorit.

Shënime

- Lidhni monitor televizori ose projektor në folenë HDMI OUT ose MONITOR OUT të marrësit.
- Në varësi të gjendjes së lidhjes mes televizorit dhe antenës (ajrore), figura në ekranin e televizorit mund të dalë e deformuar. Në një rast të tillë, vendoseni antenën (ajrore) më larg marrësit.
- Kur lidhni kablo dixhitale optike, futini fishat drejt derisa të puthiten duke bërë "klik".
- Mos i përthyni ose lidhni kabllo dixhitale optike.

Këshilla

- Të gjitha foletë e audios dixhitale mbështesin frekuenca modulimi 32 kHz, 44,1 kHz, 48 kHz dhe 96 kHz.
- Marrësi ka funksion konvertimi të videos. Për hollësi, shihni "Funksion për konvertim të sinjaleve video" (faqe 21).
- Kur lidhni folenë e daljes së audios të televizorit me foletë TV IN të marrësit për daljen e zërit të televizorit nga altoparlantët e lidhur me marrësin, caktojini folenë e daljes së audios të televizorit në "Fixed" nëse mund të ndërrohet mes "Fixed" ose "Variable".

Për të dëgjuar zërin nga televizori

Nëse televizori nuk e mbështet funksionin System Audio Control, caktojini "Audio Out" në "TV+AMP" te menya HDMI Settings (faqe 94).

4: Lidhja e pajisjeve të tjera

Përdorimi i lidhjes HDMI

High-Definition Multimedia Interface (HDMI) është një ndërfaqe që transmeton sinjale video dhe audio në formatin dixhital.

Duke lidhur pajisjet e përputhshme për sinkronizmin të Sony "BRAVIA" me anë të kabllave HDMI, veprimet mund të thjeshtohen. Shihni "Veçoritë e "BRAVIA" Sync" (faqe 76).

Funksionet HDMI

- Një sinjal audio dixhital i transmetuar nga HDMI mund të dalë nga altoparlantët e lidhur me marrësin. Ky sinjal mbështet Dolby Digital, DTS, DSD dhe PCM lineare. Për hollësi, shihni "Formatet dixhitale audio të mbështetura nga marrësi" (faqe 22).
- Marrësi mund të marrë PCM lineare shumëkanalëshe (deri në 8 kanale) me frekuencë modulimi prej 192 kHz e poshtë nëpërmjet lidhjes HDMI.
- Sinjalet video analoge që hyjnë në folenë VIDEO të marrësit ose foletë COMPONENT VIDEO mund të nxirren si sinjale HDMI (faqe 21). Sinjalet audio nuk nxirren nga foletë HDMI OUT gjatë konvertimit të figurës.
- Ky marrës mbështet audio me shpejtësi të lartë të bitëve (DTS-HD Master Audio, Dolby TrueHD), Deep Color (Deep Colour), "x.v.Color (x.v.Colour)" dhe transmetimin 4K ose 3D.
- Për figurë 3D, lidhni pajisje video dhe televizive që mbështesin 3D (luajtës disqesh Blu-ray, regjistruues disqesh Blu-ray, PlayStation 3 etj.) të marrësi me anë të kabllave HDMI të shpejtësisë së lartë, vendosni syzet 3D dhe pastaj luani materiale që mbështesin 3D.

- Për figurë 4K (hyrja HDMI BD, GAME dhe VIDEO 1), lidhni pajisje video dhe televizive që mbështesin 4K (luajtës disqesh Blu-ray, etj.) te marrësi me anë të kabllave HDMI të shpejtësisë së lartë dhe pastaj luani materiale që mbështesin 4K.
- Sinjalin hyrës HDMI BD, DVD, GAME dhe VIDEO 2 mund ta shihni në shqyrtimin figurë-në-figurë.

Shënime për lidhjet HDMI

- Në varësi të pajisjes së televizorit ose të videos, figurat 4K ose 3D mund të mos shfaqen. Verifikoni formatet e figurës HDMI video që mbështeten nga marrësi (faqe 122).
- Drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të çdo pajisjeje të lidhur për detaje.

Kur lidhni kordonët

- Përpara lidhjes së kordonëve, sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).
- Nuk është e nevojshme të lidhen të gjitha kabllot. Lidhni sipas disponueshmërisë së fishave në pajisjet e lidhura.
- Përdorni një kabllo HDMI të shpejtësisë së lartë. Nëse përdorni kabllo HDMI standard, figura 1080p, Deep Color (Deep Colour), 4K ose 3D mund të mos shfaqet siç duhet.
- Nuk rekomandojmë përdorimin e kabllave konvertuese HDMI-DVI. Kur lidhni kabllo konvertuese HDMI-DVI me një pajisje DVI-D, zëri dhe/ose figura mund të mungojë. Lidhni kabllot e posaçme audio ose kabllot dixhitale të lidhjes, pastaj ricaktoni foletë e hyrjes nëse zëri nuk del siç duhet. Për hollësi, shihni "Përdorimi i foleve të tjera hyrëse video/audio (Input Assign)" (faqe 81).
- Kur lidhni kabllo dixhitale optike, futini fishat drejt derisa të puthiten duke bërë "klik".
- Mos i përthyeri ose lidhni kabllot dixhitale optike.

Këshillë

Të gjitha foletë e audios dixhitale mbështesin frekuenca modulimi 32 kHz, 44,1 kHz, 48 kHz dhe 96 kHz.

Nëse dëshironi të lidhni disa pajisje dixhitale, por nuk mund të gjeni hyrje të lirë


Shihni "Përdorimi i foleve të tjera hyrëse video/audio (Input Assign)" (faqe 81).

Konvertimi i sinjaleve video

Marrësi vjen me funksion për konvertimin e sinjaleve video. Për hollësi, shihni "Funksion për konvertim të sinjaleve video" (faqe 21).

Lidhja e pajisjes me foletë HDMI

Nëse pajisja nuk ka foletë HDMI, shikoni faqen 32.



A Kablo HDMI (nuk jepet)

Sony rekomandon përdorimin e kabllave të autorizuara HDMI ose të kabllave HDMI Sony.

Shënime


- Kjo lidhje HDMI është lidhje shembull. Çdo pajisje HDMI mund ta lidhni në hyrjet HDMI, duke përfshirë hyrjen HDMI në panelin e përparmë.
- Hyrjet SA-CD/CD dhe BD kanë cilësi më të mirë të zërit. Nëse keni nevojë për cilësi më të lartë zëri, lidhni pajisjen te këto fole dhe zgjidhni si hyrje.
- Sigurohuni të ndërroni cilësimin e paracaktuar të butonit të hyrjes në telekomandë në mënyrë që të përdorni butonin për të kontrolluar pajisjet e lidhura. Për hollësi, shihni "Programimi i telekomandës" (faqe 103).
- Gjithashtu mund të riemëtoni hyrjen në mënyrë që të shfaqet në panelin e ekranit të marrësit. Për hollësi, shihni "Name" te menjja "Input Settings" (faqe 95).

Përdorimi i lidhjes MHL**Çfarë është MHL?**

MHL (Mobile High-Definition Link) është një ndërfaqe audioje dhe videoje HD për lidhjen e celularëve dhe të pajisjeve portative në HDTV dhe në produkte të tjera të argëtimit shtëpiak. MHL mund të mbështesë video deri në 1080p HD dhe sinjale audioje dixhitale si dhe të furnizojë njëkohësisht me energji pajisjen celulare. Gjithashtu u mundëson televizorëve dhe produkteve të tjera të argëtimit shtëpiak të komandojnë celularin dhe të hapin materialet e tij (faqe 79).

Lidhja e pajisjes celulare që mbështet MHL (Mobile High-Definition Link) për materiale audio/video

Marrësi vjen i integruar me teknologji MHL 2.


**A** Kabloja MHL (nuk jepet)

Përdorni kablo që mbështet MHL2. Sony rekomandon të përdorni kablo MHL Sony.

B MHL Direct Attach Device (nuk jepet)**Shënime**

- Pajisja celulare që mbështet MHL ngarkohet kur lidhet në folenë HDMI/MHL (VIDEO 2 IN) të marrësit ndërkohë që marrësi është i ndezur.
- Gjithashtu mund të riemëtoni hyrjen VIDEO 2 në mënyrë që të shfaqet në panelin e ekranit të marrësit. Për hollësi, shihni "Name" te menjja "Input Settings" (faqe 95).

Lidhja e pajisjes me fole të ndryshme nga ato HDMI




- A** Kablo optike dixhitale (nuk jepet)
- B** Kablo audio (nuk jepet)
- C** Kablo video Component (nuk jepet)
- D** Kablo video (nuk jepet)
- E** Kablo koaksiale dixhitale (nuk jepet)

———— Lidhja e rekomanduar

----- Lidhja alternative

* Kur lidhni pajisje me fole OPTICAL, ricaktoni foletë e hyrjes. Për hollësi, shihni "Përdorimi i foleve të tjera hyrëse video/audio (Input Assign)" (faqe 81).

Lidhja e iPod, iPhone, pajisjeve USB




- A** Kablo USB (nuk jepet)

5: Lidhja e antenave (ajrore)

Përpara lidhjes së antenave (ajrore), sigurohuni që të shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).

Antena AM në formë kornize (ajrore)
(e dhënë)



Shënime

- Për të parandaluar interferencat, mbajeni antenën qarkore AM (ajrore) larg marrësit dhe pajisjeve të tjera.
- Sigurohuni që të zgjatni plotësisht antenën FM me tel (ajrore).
- Pasi të lidhni antenën FM me tel (ajrore), mbajeni në pozicion sa më horizontal.

6: Lidhja me rrjetin

Nëse keni lidhje në internet, mund ta lidhni marrësin edhe me internetin. Mund ta lidhni nëpërmjet një lidhjeje LAN me valë ose me kablo.

Kërkesat e sistemit

Nevojitet sistemi i mëposhtëm i ambientit për të përdorur funksionin e rrjetit të marrësit.

Lidhje me linjë me brez të gjerë

Nevojitet lidhje e brezit të gjerë me internetin për të dëgjuar Sony Entertainment Network (SEN) dhe për të përditësuar softuerin e marrësit.

Modemi

Kjo është pajisja që lidhet me linjën e brezit të gjerë për të komunikuar me internetin. Disa nga këto pajisje janë të integruara me ruterin.

Ruteri

- Përdorni një ruter që përputhet me 100 Mbps ose me shpejtësi më të madhe transmetimi për të shfrytëzuar materialet në rrjetin tuaj të shtëpisë.
- Rekomandojmë të përdorni një ruter të pajisur me server të integruar DHCP (Dynamic Host Configuration Protocol). Ky funksion cakton automatikisht adresën IP në rrjetin LAN.
- Përdorni një ruter LAN-i me valë/pikë akses, nëse dëshironi të përdorni një lidhje të LAN-it me valë.

Kablo LAN (CAT5) (Vetëm për lidhje LAN me kablo)

- Rekomandojmë të përdorni këtë lloj kabloje për LAN me kablo. Disa kablo LAN të sheshta ndikohen lehtësisht nga interferencat. Rekomandojmë të përdorni kablo normale.
- Nëse marrësi përdoret në një mjedis ku ka interferenca nga produkte elektrike ose në mjedise rrjeti me interferenca, përdorni kablo LAN të izoluar.

Serveri


Serveri është një pajisje që i dërgon materiale (muzikë, foto, dhe video) një pajisjeje DLNA në një rrjet shtëpie. Një pajisje që mund të përdoret si server (një kompjuter, etj.) duhet të jetë e lidhur me rrjetin tuaj të shtëpisë LAN me valë ose kablo*.

* Për hollësi rreth serverëve që përputhen me këtë marrës, shihni faqe 59.

Shembull konfigurimi

Ilustrimi i mëposhtëm është shembulli i një konfigurimi rrjeti shtëpie me marrësin dhe një server.

Rekomandojmë të lidhni serverin me ruterin me një lidhje me kablo.



A Vetëm për lidhje LAN me kablo.

B Vetëm për lidhje të LAN-it me valë.

Sigurohuni të përdorni një ruter LAN-i me valë/pikë akses.


Shënim

Një riprodhim audio në një server mund të ndërpritet me raste kur përdorni një lidhje me valë.


Përgatitja e marrësit

Lidhja e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)

Futni kordonin elektrik në prizë.



Ndezja e marrësit



Shtypni I/O për të ndezur marrësin.

Marrësin mund ta ndizni dhe me anë të butonit I/O në telekomandë. Kur fikni marrësin, shtypni sërish I/O. "STANDBY" do të pulsojë në panelin e ekranit. Mos e shkëputni kordonin elektrik (përcjellës i rryjetit elektrik) gjatë pulsimit të "STANDBY". Kjo mund të shkaktojë defekt.

Konfigurimi i marrësit me anë të Easy Setup

Cilësimet bazë të marrësit mund t'i caktoni lehtësisht duke e komanduar marrësin sipas udhëzimeve në ekranin e televizorit. Kalojeni hyrjen e televizorit të hyrja me të cilën është i lidhur marrësi.

Kur ndizni marrësin për herë të parë ose pas nisjes së marrësit, në televizor shfaqet ekranin Easy Setup. Vazhdoni me konfigurimin e marrësit sipas udhëzimeve në ekranin Easy Setup.

Mund të konfiguroni funksionet e mëposhtme me anë të Easy Setup.

- Speaker Settings
- Network Settings

Shënime për Speaker Settings (Auto Calibration)

Ky marrës vjen me funksion DCAC (Digital Cinema Auto Calibration) që mundëson kalibrimin automatik si më poshtë:

- Kontrolloni lidhjen midis çdo altoparlanti dhe marrësit.
- Rregulloni nivelin e altoparlantit.
- Matni distancën e çdo altoparlanti nga pozicionin i ndenjes.¹⁾
- Matni madhësinë e altoparlantit.¹⁾
- Matni karakteristikat e frekuencës (EQ).¹⁾
- Matni karakteristikat e frekuencës (Faza).¹⁾²⁾

- 1) Rezultati i matjes nuk shfrytëzohet kur zgjidhet "2ch Analog Direct".
- 2) Rezultatet e matjeve nuk përdoren kur merren sinjale Dolby TrueHD ose DTS-HD me frekuencë modulimi mbi 48 kHz.

DCAC është i projektuar për të arritur një ekuilibër të përshtatshëm të zërit për dhomën tuaj. Sidoqoftë, mund të rregulloni manualisht nivelet e altoparlantëve sipas preferencës suaj. Për hollësi shihni "Test Tone" (faqe 92).

Para se të kryeni Auto Calibration

Para se të kryeni Auto Calibration, kontrolloni artikujt e mëposhtëm.


- Konfiguroni dhe lidhni altoparlantët (faqe 23, 25).
- Lidhni vetëm mikrofonin e dhënë të optimizuesit në fole të AUTO CAL MIC. Mos lidhni mikrofon tjetër në këtë fole.
- Nëse përdorni lidhje me dy amplifikatorë, caktoni terminalat SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B të "Bi-Amplifier Connection" me anë të "Speaker Connection" te menyja Speaker Settings (faqe 90).
- Nëse përdorni lidhje me altoparlantë të përpamë B, caktoni terminalat SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B të "Front B Speakers" me anë të "Speaker Connection" te menyja Speaker Settings (faqe 90).
- Sigurohuni që dalja e altoparlantit të mos jetë caktuar në "SPK OFF" (faqe 37).
- Sigurohuni që nuk jeni duke përdorur funksionin PARTY STREAMING (faqe 70).
- Shkëputni kufjet.
- Largoni çdo pengesë mes mikrofonit të optimizuesit dhe altoparlantëve për të shmangur gabime në matje.
- Merrni një matje të saktë duke u siguruar që ambienti nuk ka zhurma dhe është i qetë.

Shënime

- Altoparlantët lëshojnë një tingull shumë të lartë gjatë kalibrimit dhe volumi nuk mund të rregullohet. Kini parasysh fqinjët dhe fëmijët e pranishëm.
- Nëse funksioni i bllokimit të zërit është i aktivizuar para se të kryeni Kalibrimin automatik, funksioni i bllokimit të zërit do të fiket automatikisht.
- Mund të mos merren dot matjet e sakta ose mund të mos kryhet dot Auto Calibration kur përdoren altoparlantë të posaçëm, si p.sh. altoparlantët me dy pole.

Konfirmimi konfigurimit e altoparlantit bas aktiv

- Kur lidhet altoparlanti bas ndizeni dhe ngrijini volumin përpara se ta aktivizoni. Rrotulloni LEVEL deri pak përpara mesit.
- Nëse e lidhni nën-vuferin me një funksion të frekuencës kalimtare, caktojini vlerën në maksimum.
- Nëse lidhni nën-vuferin me funksionin e gatishmërisë automatike, caktojini në fikur (joaktiv).




Shënim

Në varësi të karakteristikave të altoparlantit bas që përdorni, vlera e konfigurimit në distancë mund të jetë e ndryshme nga pozicioni aktual.

Për të zgjedhur altoparlantët e përpamë

Mund të zgjidhni altoparlantët e përpamë që dëshironi të komandoni. Sigurohuni të përdorni butonat në marrës për të kryer këtë veprim.

SPEAKERS



Shtypni vazhdimisht **SPEAKERS** për të zgjedhur sistemin e altoparlantëve të përpamë që dëshironi të komandoni.

Mund të konfirmoni terminalet e zgjedhura të altoparlantëve duke shënuar treguesit në panelin e ekranit.

Treguesit	Altoparlantët e zgjedhur
SP A	Altoparlantët e lidhur me terminalet SPEAKERS FRONT A.
SP B*	Altoparlantët e lidhur me terminalet SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B.
SP A+B*	Altoparlantët e lidhur me të dyja terminalet SPEAKERS FRONT A dhe SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B (lidhje paralele).

"SPK OFF" shfaqet në panelin e ekranit. Nuk dalin sinjale audio nga terminalet e altoparlantëve.


* Për të zgjedhur "SP B" ose "SP A+B", caktojini terminalet SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B te "Front B Speakers" me anë të "Speaker Connection" në menynë Speaker Settings (faqe 90).

Shënim

Ky cilësim nuk disponohet kur janë lidhur kufjet.

Për të anuluar Auto Calibration

Funksioni i Auto Calibration do të anulohet kur veproni si më poshtë gjatë procesit të matjes:

- Shtypni I/⏻.
- Shtypni butonat e hyrjes në telekomandë ose aktivizoni INPUT SELECTOR në marrës.
- Shtypni .
- Shtypni SPEAKERS te marrësi.
- Ndryshoni nivelin e volumnit.
- Lidhni kufjet.

Për të konfiguruar manualisht marrësin

Shihni "Rregullimi i cilësimeve" (faqe 85).

Konfigurimi i cilësimeve të rrjetit të marrësit

Cilësimet e rrjetit për marrësin duhet të jenë caktuar saktë për të përdorur funksionet Home Network, SEN, AirPlay dhe PARTY STREAMING.

Përdorimi i lidhjeve të rrjetit LAN me valë

Ka metoda të ndryshme lidhjeve që mund të përdorni për të konfiguruar rrjet me valë: kërkimi i një pike aksesi, duke përdorur metodën e lidhjes WPS (metoda e shtypjes së butonit ose metoda e kodit PIN), ose cilësimi manual.

Shënime

- Sigurohuni të mos përdorni funksionin e LAN-it me valë aty ku përdoren pajisje mjekësore (si një stimulator kardiak) ose në vendet ku është i ndaluar komunikimi me valë.
- Përpara se të lidheni me rrjetin tuaj të shtëpisë, duhet të përgatitni një ruter LAN-i me valë/pikë aksesi. Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes.

- Në varësi të ambientit të rrjetit të shtëpisë, ruteri i LAN-it me valë/pika e aksesit mund të jenë konfiguruar në mënyrë të tillë që të mos lidhet gjatë përdorimit të WPS-së, ndonëse përshatet me WPS-në. Për hollësi nëse ruteri i LAN-it me valë/pika e aksesit përpunohet ose jo me WPS-në dhe me konfigurimin e lidhjes WPS, referojuni udhëzimeve të përdorimit të ruterit të LAN-it me valë/pikës së aksesit.
- Ju mund të hasni vështirësi gjatë konfigurimit nëse ruteri i LAN-it me valë/pika e aksesit janë shumë larg nga njëra tjetra. Nëse keni, afrojini pajisjet me njëra tjetrën.


Kërkimi për një pikë aksesi dhe konfigurimi i një rrjeti me valë (Access Point Scan Method)

Ju mund të konfiguroni një rrjet me valë duke kërkuar një pikë aksesi. Për konfigurimin e rrjetit me anë të kësaj metode lidhjeje, ju kërkohet të zgjidhni ose të shkruani informacionin e mëposhtëm. Kontrolloni paraprakisht informacionin e mëposhtëm, dhe regjistroni në hapësirën e dhënë më poshtë.







- Emri i rrjetit (SSID) që identifikon rrjetin tuaj^{**}. (Kjo do të nevojitet në hapin 7.)

- Nëse rrjeti i shtëpisë me valë është i siguar me enkriptim, çelësi i sigurisë (çelësi WEP, çelësi WPA/WPA2) për rrjetin tuaj^{**}. (Kjo do të nevojitet në hapin 8.)



* SSID (Identifikuesi i setit të shërbimit) është një emër që identifikon një pikë aksesi.
 ** Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm nga një etiketë në rrugëzuesin e rrjetit LAN me valë/pikën e hyrjes, nga udhëzimet e përdorimit, nga personi që kreu konfigurimin e rrjetit me valë, ose nga informacioni i dhënë nga ofruesi i shërbimit të internetit.











- 1 Shtypni AMP dhe shtypni HOME.**
Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.
- 2 Shtypni vazhdimisht $\uparrow/\downarrow/\leftarrow/\rightarrow$ për të zgjedhur "Settings", më pas shtypni \oplus .**
Lista e menyë "Settings" shfaqet në ekranin e televizorit.
- 3 Shtypni vazhdimisht $\uparrow/\downarrow/\leftarrow/\rightarrow$ për të zgjedhur "Network", pastaj \oplus .**
- 4 Shtypni vazhdimisht \uparrow/\downarrow për të zgjedhur "Internet Setting", pastaj \oplus .**
- 5 Shtypni vazhdimisht \uparrow/\downarrow për të zgjedhur "Wireless", pastaj \oplus .**
- 6 Shtypni \uparrow/\downarrow vazhdimisht për të zgjedhur "Access Point Scan", pastaj \oplus .**
Marrësi fillon kërkimin për pikat e aksesit dhe shfaq një listë me emrat e rrjeteve të disponueshme deri në 30 emra (SSID).
- 7 Shtypni në mënyrë të përsëritur \uparrow/\downarrow për të zgjedhur emrin e rrjetit që dëshironi (SSID), dhe shtypni \oplus .**
Cilësimi i sigurisë shfaqet në ekranin e televizorit.




- 8 Jepni kodin e sigurisë (kodin WEP, kodin WPA/WPA2) me anë të tastierës në ekran. Shtypni /// dhe  për të zgjedhur simbolin njëri pas tjetrit. Pastaj, zgjidhni "Enter" dhe shtypni  për të konfirmuar kodin e sigurisë.**

Në ekranin e televizorit do të shfaqet "How to acquire the IP Address".



- 9 Shtypni vazhdimisht / për të zgjedhur "Auto", pastaj shtypni .**

Kur përdorni adresë fikse IP

Zgjidhni "Manual", pastaj . Në ekranin e televizorit shfaqet dritarja për futjen e adresës IP. Jepni vlerën për "IP Address" me anë të tastierës në ekran. Shtypni /// dhe  për të zgjedhur simbolin njëri pas tjetrit. Pastaj, zgjidhni "Enter" dhe shtypni  për të konfirmuar vlerën. Jepni vlerën për "Subnet Mask", "Default Gateway", "Primary DNS" dhe "Secondary DNS". Pastaj, zgjidhni "Next" dhe shtypni .

- 10 Shtypni vazhdimisht / për të zgjedhur "Ok", pastaj .**

Në ekranin e televizorit shfaqet "Connecting to the network. Please wait."

"Network Settings are now complete and the receiver has been successfully connected to the network." shfaqet më pas nëse cilësimet e rrjetit përfundojnë në rregull dhe  ndizet në panelin e ekranit. Për t'u rikthyer në menyën Network Settings, shtypni . (Cilësimeve të rrjetit mund t'u duhet pak kohë në varësi të ambientit të rrjetit.)

- 11 Kryeni cilësimet e serverit.**

Për të dëgjuar materialet audio në server, duhet të konfiguroni serverin (faqe 59).

Shënim













Nëse rrjeti juaj nuk është i siguruar me enkriptim (duke përdorur çelës sigurie), ekranin e cilësimeve të sigurisë nuk shfaqet në hapin 8.

Këshillë

Kur kontrolloni cilësimet e rrjetit, shihni "Informacion" (faqe 96).

Nëse nuk mund të gjeni emrin e rrjetit (SSID) që dëshironi (metoda e konfigurimit manual)

Mund të fusni manualisht emrin e rrjetit (SSID) që dëshironi, në rast se nuk shfaqet në listë.

- 1 Zgjidhni "Manual Registration" në hapin 6 në "Kërkimi për një pikë aksesi dhe konfigurimi i një rrjeti me valë (Access Point Scan Method)" (faqe 39).
- 2 Shtypni vazhdimisht / për të zgjedhur "Direct Input", pastaj .
- 3 Jepni emrin e rrjetit (SSID) me anë të tastierës në ekran. Shtypni /// dhe  për të zgjedhur simbolin njëri pas tjetrit. Pastaj, zgjidhni "Enter" dhe shtypni . Emri që dhatë është i regjistruar.
- 4 Shtypni vazhdimisht / për të zgjedhur cilësimin e sigurisë që dëshironi, pastaj .
- 5 Ndiqni hapat 8 në 11 të "Kërkimi për një pikë aksesi dhe konfigurimi i një rrjeti me valë (Access Point Scan Method)" (faqe 39).

Konfigurimi i rrjetit me valë me pikë hyrjeje që mbështet WPS

Ju mund të konfiguroni lehtësisht një rrjet me valë duke përdorur një pikë aksesi të pajtueshme me WPS. Cilësimi WPS mund të kryhet duke përdorur metodën e konfigurimit të shtypjes së butonit ose me metodën e kodit PIN (Numri Personal i Identifikimit).


Çfarë është WPS (Konfigurimi i Mbrojtur Wi-Fi)?

WPS është një standard i krijuar nga Wi-Fi Alliance që ju lejon të konfiguroni lehtësisht dhe të sigurt një rrjet me valë.

Konfigurimi i një rrjeti me valë duke përdorur metodën e konfigurimit të butonit WSP push

Mund të konfiguroni lehtësisht rrjet me valë WPS, me një shtypje të butonit të caktuar.

- 1 Zgjidhni "WPS Push" në hapin 6 në "Kërkimi për një pikë aksesi dhe konfigurimi i një rrjeti me valë (Access Point Scan Method)" (faqe 39).
- 2 Ndiqni udhëzimet në ekran dhe shtypni butonin WPS në pikën e hyrjes. Mesazhi: "Push the WPS button on the access point within 2 minutes."



Butoni WPS në rrugëzuesin e rrjetit LAN me valë/pikën e hyrjes.

"Network Settings are now complete and the receiver has been successfully connected to the network." shfaqet pasi përfundojnë cilësimet e rrjetit dhe "📶" ndizet në panelin e ekranit. Për t'u rikthyer në menynë Network Settings, shtypni (+). (Cilësimeve të rrjetit mund t'u duhet pak kohë në varësi të ambientit të rrjetit.)

3 Kryeni cilësimet e serverit.

Për të dëgjuar materialet audio në server, duhet të konfiguroni serverin (faqe 59).

Këshillë

Kur kontrolloni cilësimet e rrjetit, shihni "Informacion" (faqe 96).

Konfigurimi i një rrjeti me valë duke përdorur metodën e kodit WPS PIN

Nëse pika e hyrjes mbështet lidhjen e kodit WPS PIN (Numri Personal i Identifikimit), mund të konfiguroni lidhje me valë WPS duke futur kodin PIN të marrësit te rrugëzuesi i rrjetit LAN me valë/pika e hyrjes.

- 1 Zgjidhni "Manual Registration" në hapin 6 në "Kërkimi për një pikë aksesi dhe konfigurimi i një rrjeti me valë (Access Point Scan Method)" (faqe 39).
- 2 Shtypni vazhdimisht ▲/▼ për të zgjedhur "WPS PIN" dhe shtypni (+). Shfaqet lista e SSID-ve të disponueshme (pikat e hyrjes).

Shënim

SSID-të që nuk mbështesin WPS PIN do të shfaqen të zbehta dhe nuk mund të zgjidhen.

- 3 Shtypni vazhdimisht ▲/▼ për të zgjedhur emrin e rrjetit që dëshironi (SSID) dhe shtypni (+).

Kodi PIN i marrësit (8 shifra) shfaqet në ekranin e televizorit. Lëreni të shfaqur kodin PIN deri sa të përfundojë lidhja. (Një kod ndryshe shfaqet sa herë e kryeni këtë komandë.)

- 4 Shkruani kodin PIN të marrësit në rrugëzuesin e rrjetit LAN me valë/pikën e hyrjes.

Marrësi fillon cilësimet e rrjetit. "Network Settings are now complete and the receiver has been successfully connected to the network." shfaqet pasi përfundojnë cilësimet e rrjetit dhe "📶" ndizet në panelin e ekranit. Për t'u rikthyer në menynë Network Settings, shtypni (+).

(Cilësimeve të rrjetit mund t'u duhet pak kohë në varësi të ambientit të rrjetit.)

- 5 Kryeni cilësimet e serverit.

Për të dëgjuar materialet audio në server, duhet të konfiguroni serverin (faqe 59).

Këshilla

- Kur kontrolloni cilësimet e rrjetit, shihni "Informacion" (faqe 96).
- Për hollësi rreth futjes së kodit PIN të rrugëzuesi i rrjetit LAN me valë/pika e hyrjes, referojuni udhëzimeve të përdorimit të rrugëzuesit LAN me valë/pikës së hyrjes.

Përdorimi i lidhjes LAN me kablo

- 1 Zgjidhni "Wired" në hapin 5 të "Kërkimi për një pikë aksesi dhe konfigurimi i një rrjeti me valë (Access Point Scan Method)" (faqe 39).**

Në ekranin e televizorit do të shfaqet "How to acquire the IP Address".

- 2 Shtypni vazhdimisht \uparrow/\downarrow për të zgjedhur "Auto", më pas shtypni \oplus .**

Kur përdorni adresë fikse IP

Zgjidhni "Manual", pastaj \oplus . Në ekranin e televizorit shfaqet dritarja për futjen e adresës IP.

Jepni vlerën për "IP Address" me anë të tastierës në ekran. Shtypni $\uparrow/\downarrow/\leftarrow/\rightarrow$ dhe \oplus për të zgjedhur simbolin njëri pas tjetrit. Pastaj, zgjidhni "Enter" dhe shtypni \oplus për të konfirmuar vlerën. Jepni vlerën për "Subnet Mask", "Default Gateway", "Primary DNS" dhe "Secondary DNS". Pastaj, zgjidhni "Next" dhe shtypni \oplus .

- 3 Shtypni vazhdimisht \uparrow/\downarrow për të zgjedhur "Ok", më pas shtypni \oplus .**

Në ekranin e televizorit shfaqet "Connecting to the network. Please wait."

"Network Settings are now complete and the receiver has been successfully connected to the network." shfaqet pasi përfundojnë cilësimet e rrjetit. Për t'u rikthyer në menyën Network Settings, shtypni \oplus . (Cilësimeve të rrjetit mund t'u duhet pak kohë në varësi të ambientit të rrjetit.)

4 Kryeni cilësimet e serverit.

Për të dëgjuar materialet audio në server, duhet të konfiguroni serverin (faqe 59).

Këshillë

Kur kontrolloni cilësimet e rrjetit, shihni "Informacion" (faqe 96).


Guidë për përdorimin e ndërfaqes (GUI)

Mund të shfaqni menyën e marrësit në ekranin e televizorit dhe të zgjidhni funksionin që dëshironi të përdorni në ekran duke shtypur $\uparrow/\downarrow/\leftarrow/\rightarrow$ dhe \oplus në telekomandë.

Kur filloni të përdorni marrësin, sigurohuni që të shtypni më parë AMP në telekomandë. Përndryshe, veprimet pasuese mund të mos jenë për marrësin.


Këshillë

Butoni AMP në telekomandë ndizet kur shtypni HOME.




Përdorimi i menysë

- 1 Kalojeni hyrjen e televizorit te hyrja me të cilën është i lidhur marrësi.**
- 2 Shtypni AMP dhe shtypni HOME.**
Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.
Në varësi të televizorit, menyja kryesore mund të kërkojë pak kohë për t'u shfaqur në ekranin e televizorit.



- 3 Shtypni vazhdimisht ←/→ për të zgjedhur një meny që dëshironi dhe shtypni + për të hyrë në meny.**
Lista e artikujve të menysë shfaqet në ekranin e televizorit.
Shembull: Kur zgjidhni "Watch".



- 4 Shtypni vazhdimisht ↑/↓/←/→ për të zgjedhur artikullin që dëshironi të rregulloni dhe shtypni + për ta hapur.**

Këshillë

Kur "OPTIONS" shfaqet djathtas në pjesën e poshtme të ekranit, mund të nxirri listën e funksioneve duke shtypur OPTIONS dhe duke zgjedhur një funksion përkatës.

Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm

Shtypni RETURN ↵.

Për të dalë nga menyja


Shtypni HOME për të shfaqur menyën kryesore dhe më pas shtypni përsëri HOME.

Përmbledhje e menyve kryesore

Menyja	Përshkrimi
Watch	Zgjedh burimin e videos që do të jetë hyrje për marrësin (faqe 44).
Listen	Zgjedh muzikën nga SA-CD/CD, pajisja USB, rrjeti lokal ose SEN (faqe 44). Mund të përdorni gjithashtu radion FM/AM të sintonizuesit të integruar (faqe 51).
Sound Effects	Mundëson dëgjimin e audios së procesuar nga teknologjitë ose funksionet e ndryshme të patentuara nga Sony (faqe 53).
Settings	Rregullon cilësimet e marrësit (faqe 85).


Funksionet bazë

Shfrytëzimi i figurës/zërit nga pajisjet e lidhura



- 1 Kalojeni hyrjen e televizorit te hyrja me të cilën është i lidhur marrësi.**
- 2 Shtypni AMP dhe shtypni HOME.** Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.

Në varësi të televizorit, menyja kryesore mund të kërkojë pak kohë për t'u shfaqur në ekranin e televizorit.



- 3 Zgjidhni "Watch" ose "Listen", pastaj shtypni (+).**

Lista e artikujve të menysë shfaqet në ekranin e televizorit.

- 4 Zgjidhni pajisjen që dëshironi dhe shtypni (+).**

- 5 Ndizni pajisjen dhe nisni laujtjen.**

- 6 Shtypni \triangle +/- për të rregulluar volumnin.**

Mund të përdorni gjithashtu MASTER VOLUME te marrësi.


- 7 Shtypni SOUND FIELD +/- për të shijuar tingullin rrethues.**

Mund të përdorni gjithashtu A.F.D./2CH, MOVIE ose MUSIC te marrësi. Për hollësi shihni faqe 53.


Këshilla

- Mund të aktivizoni INPUT SELECTOR në marrës ose shtypni butonat e hyrjes në telekomandë për të zgjedhur pajisjen që dëshironi.
- Mund ta rregulloni volumnin ndryshe me anë të çelësit MASTER VOLUME në marrës ose butonit \triangle +/- në telekomandë.
 - Për të ngritur ose ulur shpejt volumnin
 - Rrotullojeni shpejt çelësin.
 - Shtypni dhe mbani butonin.
 - Për të bërë rregullime të imëta
 - Rrotullojeni me ngadalë çelësin.
 - Shtypni dhe lëshoni menjëherë butonin.

Për të aktivizuar funksionin e heshtjes

Shtypni .

Funksioni i heshtjes do të anulohet kur veproni si më poshtë.

- Shtypni përsëri .
- Ndryshoni volumnin.
- Fikni marrësin.
- Kryeni Kalibrimin automatik.

Për të shmangur dëmtimin e altoparlantëve

Përpara se të fikni marrësin, sigurohuni që të ulni nivelin e volumnit.

Luajtja e një iPod/iPhone

Mund të shijoni materialet muzikore nga iPod/iPhone duke e lidhur me portën ψ (USB) në marrës.

Për hollësi mbi lidhjen e iPod/iPhone, shikoni faqen e 33.

Modelet e përputhshme të iPod/iPhone

Mund të përdorni modelet e mëposhtme iPod/iPhone me këtë marrës. Përditësoni iPod/iPhone me softuerin më të ri përpara se ta përdorni.



iPhone 4S



iPhone 4



iPhone 3GS



iPhone 3G



iPod touch
4th generation



iPod touch
3rd generation



iPod touch
2nd generation



iPod nano
6th generation



iPod nano
5th generation
(video camera)



iPod nano
4th generation
(video)



iPod nano
3rd generation
(video)



iPod classic


Shënime

- Sony nuk mban përgjegjësi në rast se të dhënat e regjistruara në iPod/iPhone humbasin apo dëmtohen gjatë përdorimit të iPod/iPhone të lidhur me marrësin.
- Ky produkt është krijuar konkretisht për të punuar me iPod/iPhone dhe është certifikuar për plotësimin e standardeve të performancës së Apple.

Zgjedhja e modalitetit të kontrollit të iPod/iPhone

Mund të zgjidhni modalitetin e kontrollit të iPod/iPhone me anë të menysë iPhone CTRL në telekomandë.

Mund të kontrolloni gjithashtu të gjitha veprimet duke parë informacionet në panelin e ekranit kur ekrani i televizorit është i fikur.




1 Zgjidhni "Listen" nga menya kryesore dhe më pas shtypni (+).

2 Zgjidhni "USB" dhe më pas shtypni (+).

Kur lidhet iPod ose iPhone, në ekranin e televizorit shfaqet "iPod/iPhone".

3 Ndiqni udhëzimet në ekran për të zgjedhur modalitetin e kontrollit iPod/iPhone.

Për të komanduar iPod/iPhone me anë të telekomandës



Shtypni USB para se të përdorni butonat e mëposhtëm.

Shtypni	Përdorimi
	Fillon luajtjen.
	Vendos luajtjen në pauzë.
	Shpejton prapa ose përpara.
	Kalon në pjesën para/prapa.
REPEAT	Hyn në modalitet përsëritje.
SHUFFLE	Hyn në modalitet përzjerjeje.
iPhone CTRL	Zgjedh modalitetin e kontrollit të iPod/iPhone.

Shënime për iPod/iPhone

- iPod/iPhone karikohet kur lidhet me marrësin ndërkohë që ky është i ndezur.
- Nga ky marrës nuk mund të transferoni këngë te iPod/iPhone.

- Mos e shkëputni iPod/iPhone gjatë punës. Për të shmangur dëmtimin e të dhënave ose dëmtimin e iPod/iPhone, fikeni marrësin gjatë lidhjes ose shkëputjes së iPod/iPhone.

Lista e mesazheve e iPod/iPhone

Mesazhi dhe shpjegimi

Leximi

Marrësi njezh dhe lexon informacionet e iPod-it ose iPhone-it.

Nuk mbështetet

Është lidhur një iPod ose iPhone që nuk mbështetet.

Nuk ka pajisje të lidhur

Nuk ka një iPod ose iPhone të lidhur.

Nuk ka asnjë pjesë

Nuk u gjet asnjë pjesë audio.

Kufjet nuk mbështeten

Nuk ka dalje të zërit nga kufjet kur lidhet iPod ose iPhone.

Luajtja e një pajisjeje USB

Mund të dëgjoni muzikë nga pajisja USB duke e lidhur me folenë Ψ (USB) në marrës. Për hollësi për lidhjen e një pajisjeje USB, shikoni "Lidhja e iPod, iPhone, pajisjeve USB" (faqe 33).

Formatet e skedarëve të muzikës që mund të riprodhohen nga ky marrës janë si më poshtë:

Formati i skedarit	Prapashtesat
MP3 (MPEG-1 Audio Layer II)	".mp3"
AAC*	".m4a", ".3gp", ".mp4"
WMA9 Standard*	".wma"
WAV	".wav"
FLAC	".flac"

* Marrësi nuk i luan skedarët të koduar me DRM.

Pajisjet USB të pajtueshme


Mund të përdorni pajisjet e mëposhtme USB nga Sony me këtë marrës.

Pajisje e verifikuar USB nga Sony


Emri i produktit	Emri i modelit
Walkman®	NWZ-A864
	NWZ-B152F / B162F / B172
	NWZ-E053 / E354 / E363 / E373 / E453 / E463 / E575
	NWZ-F805 / F806N
	NWZ-S755 / S764 / S774 / S774BT
	NWZ-W262 / W272
	NWZ-Z1040 / Z1070
	NWD-W253
MICROVAULT	USM1GL / 4GL / 8GL / 32GL
	USM16GLX / 32GLX / 64GLX
	USM4GN / 8GN / 32GN
	USM4GM / 16GM
	USM8GQ / 32GQ / 64GQ
	USM16GR / 32GR
	USM4GS / 8GJ / 8GT / 16GS / 16GU / 64GP / 512J
Regjistrues Dixhital Zanor	ICD-SX713 / SX1000 / PX232 / PX333F / FX8 / TX50 / UX513F / UX523F / UX532 / UX533F
	ICZ-R50 / R51

Shënime

- Marrësi nuk mund të lexojë të dhënat në formatin NTFS.
- Marrësi nuk mund të lexojë të dhënat e tjera përveç atyre të ruajtura në ndarjen e parë të njësisë së diskut të ngurtë.
- Nuk garantohehet funksionimi i modeleve që nuk janë të renditura këtu.
- Funksionimi mund të mos jetë gjithmonë i garantuar edhe kur përdorni këto pajisje USB.
- Disa nga këto pajisje USB mund të mos jenë të disponueshme për blerje në zona të caktuara.
- Kur formatoni modelet e mësipërme, sigurohuni që t'i formatoni duke përdorur vetë modelin ose softuerin e dedikuar të formatimit për atë model.
- Kur lidhni një pajisje USB me marrësin, sigurohuni që ta lidhni pasi të zhduket pamja "Creating Library" ose "Creating Database" në pajisjen USB.

Funksionimi i pajisjes USB

- 1 Zgjidhni "Listen" nga menya kryesore dhe më pas shtypni (+).**
- 2 Zgjidhni "USB" dhe më pas shtypni (+).**
Kur lidhet pajisja USB, në ekranin e televizorit shfaqet "USB". Pajisjen USB mund ta komandoni me anë të telekomandës së marrësit.
- 3 Zgjidhni përbajtjen që dëshironi nga lista e përbajtjeve dhe më pas shtypni (+).**
Përbajtja e zgjedhur do të fillojë të luhet dhe informacionet e përbajtjes muzikore do të shfaqen në ekranin e televizorit.

Për të komanduar pajisjen USB me anë të telekomandës

Shtypni te USB para se të përdorni butonat e mëposhtëm.

Shtypni	Përdorimi
	Fillon luajtjen.
	Vendos luajtjen në pauzë.
	Ndalon luajtjen.
	Kalon në skedarin para/ prapa.
REPEAT	Hyn në modalitet përsëritje.
SHUFFLE	Hyn në modalitet përzierjeje.

Shënime për pajisjen USB

- Mos e shkëputni pajisjen USB gjatë funksionimit. Për të shmangur dëmtimin e të dhënave ose dëmtimin e pajisjes USB, fikni marrësin kur lidhni ose shkëputni pajisjen USB.
- Kur nevojitet lidhje me kablo USB, përdorni kabllon që vjen me pajisjen. Për hollësi rreth mënyrës së përdorimit, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit që vijnë me pajisjen USB.
- Mos e lidhni marrësin dhe pajisjen USB përmes shpërndarësi USB.

- Kur lidhet pajisja USB, në ekranin e televizorit shfaqet "Reading".
- Mund të kalojnë rreth 10 sekonda përpara se të shfaqet "Reading" në varësi të llojit të pajisjes USB të lidhur.
- Kur lidhet pajisja USB, marrësi lexon të gjithë skedarët në pajisjen USB. Nëse ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB, mund të duhet një kohë e gjatë që të përfundohet leximi i pajisjes USB.
- Marrësi mund të njohë deri në
 - 256 dosje (duke përfshirë dosjen "ROOT").
 - 256 skedarë audio për çdo dosje.
 - 8 nivele të dosjeve (struktura pemë e skedarëve, përfshirë dosjen "ROOT").
 Numri maksimal i skedarëve audio dhe dosjeve mund të ndryshojë në varësi të strukturës së skedarëve dhe dosjeve. Mos ruani lloje të tjera të skedarëve ose dosje të panevojshme në një pajisje USB.
- Nuk mund të garantohet pajtueshmëria me të gjithë softuerët kodues/shkruer, pajisjet regjistruese dhe mjetet regjistruese. Një pajisje USB e papërpunueshme mund të krijojë zhurmë ose ndërprerje të audios ose mund të mos luhet aspak.
- Mund të duhet pak kohë për të filluar riprodhimin kur:
 - struktura e dosjeve është e ndërlikuar.
 - kapaciteti i memories është shumë i madh.
- Ky marrës nuk i mbështet domosdoshmërisht të gjitha funksionet e ofruara në një pajisje USB të lidhur.
- Rendi i riprodhimit për marrësin mund të ndryshojë nga rendi i riprodhimit i pajisjes së lidhur USB.
- Dosjet që nuk kanë skedarë audio do të kapërcehen.
- Kur luhet një pjesë shumë e gjatë, disa veprime mund të shkaktojnë vonesë në riprodhim.

Lista e mesazheve të USB-së

Mesazhi dhe shpjegimi

Reading

Marrësi njeh dhe lexon informacionet e pajisjes USB.

Device error

Memoria e pajisjes USB nuk mund të njihet (faqe 48).

Not supported

Është lidhur një pajisje USB e pambështetur, është lidhur një pajisje e panjohur ose pajisja USB është lidhur nëpërmjet një qendre USB (faqe 48).

No device is connected

Nuk është e lidhur asnjë pajisje USB ose pajisja e lidhur USB nuk njihet.

Cannot get info

Numri i skedarëve audio/dosjeve/niveleve të dosjeve ka arritur kufirin maksimal që mund të njihet nga marrësi (faqe 50).

Cannot play

Marrësi nuk mund të luajë skedarë audio për shkak të mospërputhjes së formatit të skedarit ose të kufizimeve të luajtjes.

Not in Use

Po kryhet një veprim që është i ndaluar për momentin.


No Track

Nuk u gjet asnjë pjesë audio.

Funksionet e sintonizuesit

Dëgjimi i radios FM/AM


Mund të dëgjoni transmetime FM dhe AM përmes sintonizuesit të integruar. Përpapërdorimit, sigurohuni të keni lidhur antenat FM dhe AM (ajrore) me marrësin (faqe 33).



- 1 Zgjidhni "Listen" nga menya kryesore dhe më pas shtypni (+).
- 2 Zgjidhni "FM/AM" dhe më pas shtypni (+).

Ekran FM/AM

Mund të zgjidhni dhe të komandoni çdo artikull në ekran duke shtypur ↑/↓/↔/↔ dhe (+).



- 1 Treguesi i bandës (faqe 51)
- 2 Treguesi i frekuencës (faqe 51)
- 3 Lista e stacioneve të paravendosura (faqe 52)

Ndërrimi midis radios FM dhe AM

- 1 Zgjidhni "Listen" nga menya kryesore dhe më pas shtypni (+).
- 2 Zgjidhni "FM/AM" dhe më pas shtypni (+).
Shfaqet ekran FM/AM.
- 3 Zgjidhni treguesin e bandës.
- 4 Shtypni vazhdimisht ↑/↓ për të zgjedhur "FM" ose "AM" dhe më pas shtypni (+).

Sintonizimi automatik në një stacion (Auto Tuning)

- 1 Zgjidhni treguesin e frekuencës në ekranin FM/AM.
- 2 Shtypni ↑/↓.
Shtypni ↑ për të kërkuar për stacione nga frekuenca më e ulët te më e larta, shtypni ↓ për të kërkuar për stacione nga më e larta te më ulëta.
Marrësi ndalon kërkimin sa herë që kapet një stacion.

Në rast se ka marrje të dobët stereo FM

- 1 Sintonizohuni në stacionin që dëshironi të dëgjoni me anë të Auto Tuning, Direct Tuning ose zgjidhni stacionin e paravendosur që dëshironi (faqe 51).
- 2 Shtypni OPTIONS.
Shfaqet menya e opsioneve.

Shënim

- Mund të caktoni modalitetin FM në menyën e opsioneve kur zgjidhet treguesi i frekuencës.
- 3 Zgjidhni "STEREO/MONO" dhe shtypni (+).
 - 4 Zgjidhni "MONO" dhe shtypni (+).

Sintonizimi i drejtpërdrejtë në një stacion (Direct Tuning)

Ju mund të vendosni frekuencën e një stacioni direkt duke përdorur butonat e numrave.

- 1 Shtypni **D.TUNING**.
- 2 Shtypni butonat numerikë për të futur frekuencën dhe shtypni (+).

Shembull 1: FM 102,50 MHz

Zgjidhni 1 → 0 → 2 → 5 → 0

Shembull 2: AM 1350 kHz

Zgjidhni 1 → 3 → 5 → 0

Këshillë

Rregulloni drejtimin e antenës AM qarkore (ajrore) për marrje optimale kur sintonizoheni në stacion AM.


Nëse nuk mund të sintonizoheni në një stacion

Shfaqet " - - - . - - MHz" ose " - - - - kHz" dhe më pas ekrani kthehet në frekuencën aktuale.

Sigurohuni të jepni frekuencën e duhur. Përndryshe, përsëritni hapin 2. Nëse ende nuk mund të lidheni me stacionin, frekuenca ka gjasë të mos përdoret në rajonin ku ndodheni.

Paravendosja e radiostacioneve FM/AM (Preset Memory)

Mund të ruani deri në 30 stacione FM dhe 30 stacione AM si stacione të preferuara.



- 1 Sintonizohuni në një stacion që dëshironi të paravendosni me Auto Tuning (faqe 51) ose Direct Tuning (faqe 52).

- 2 Shtypni **OPTIONS**. Shfaqet menyyja e opsioneve.

Shënim

Memorien e stacioneve të paravendosura mund ta caktoni në menynë e opsioneve kur zgjidhet treguesi i frekuencës.

- 3 Zgjidhni "Set Preset" dhe më pas shtypni (+).
- 4 Zgjidhni një numër për stacionin e paravendosur dhe shtypni (+). Stacioni ruhet në numrin e zgjedhur të paravendosur.
- 5 Përsëritni hapat 1 deri 4 për të ruajtur një stacion tjetër. Stacionin mund ta ruani si më poshtë:
 - Banda AM: AM 1 deri në AM 30
 - Banda FM: FM 1 deri në FM 30

Sintonizimi në stacione të paravendosura

- 1 Zgjidhni "Listen" nga menyyja kryesore dhe më pas shtypni (+).
- 2 Zgjidhni "FM/AM" dhe më pas shtypni (+).
- 3 Zgjidhni numrin e stacionit të paravendosur nga lista dhe shtypni (+). Disponohen numra të paracaktuar nga 1 në 30.

Për të emërtuar stacionet e paravendosura (Name Input)

- 1 Zgjidhni numrin e stacionit të paravendosur që doni të emërtoni.
- 2 Shtypni **OPTIONS**. Shfaqet menyyja e opsioneve.
- 3 Zgjidhni "Name Input" dhe më pas shtypni (+). Në ekranin e televizorit shfaqet tastiera virtuale.
- 4 Shtypni ↑/↓/←/→ dhe (+) për të zgjedhur shkronjat një nga një për të futur emrin.

5 Zgjidhni "Enter" dhe më pas shtypni (+).

Emri që dhatë është i regjistruar.

Shënim

Disa shkronja që mund të shfaqen në ekranin e televizorit nuk mund të shfaqen në panelin e ekranit.

Për të anuluar procesin e emërtimit

Shtypni RETURN .

Marrja e transmetimeve RDS

Ky marrës mundëson përdorimin e Radio Data System (RDS), që u mundëson radiostacioneve të dërgojnë informacione shtesë në sinjalin normal të programit. Ky marrës ofron veçori të dobishme, si p.sh. shfaqjen e emrit të shërbimit të programit. RDS është e disponueshme vetëm për stacionet FM.*

* Jo të gjitha stacionet FM ofrojnë shërbimin RDS, por as nuk ofrojnë të njëjtin lloj shërbimesh. Nëse nuk i njihni mirë shërbimet RDS në zonën tuaj, kontaktoni me stacionet e radiove lokale për detaje.

Tjeshhtë zgjidhni një stacion në bandën FM.

Kur sintonizoheni te një stacion që ofron shërbime RDS, në ekranin e televizorit dhe panelin e ekranit shfaqet emri i shërbimit të programit*.

* Nëse nuk merret transmetim RDS, shërbimi i programit nuk do të shfaqet.

Shënime

- RDS mund të mos funksionojë mirë nëse stacioni ku jeni sintonizuar nuk e transmeton sinjalin RDS, ose nëse fuqia e sinjalit është e dobët.
- Disa shkronja që mund të shfaqen në ekranin e televizorit nuk mund të shfaqen në panelin e ekranit.

Këshillë

Ndërkohë që shfaqet emri i Program Service (shërbimit të programit), mund të kontrolloni frekuencën duke shtypur vazhdimisht DISPLAY (faqe 102).

Përdorimi i efekteve zanore

Zgjedhja e fushës zanore

- 1 Zgjidhni "Sound Effect" nga menya kryesore dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni "Sound Field" dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni fushën zanore që dëshironi.

Këshilla

- Mund të shtypni vazhdimisht SOUND FIELD +/- në telekomandë për të zgjedhur fushën zanore që dëshironi.
- Mund të përdorni gjithashtu A.F.D./2CH, MOVIE ose MUSIC te marrësi.

Auto Format Direct (A.F.D.)/ 2 channel sound mode

- **Auto Format Direct (A.F.D.) mode:** Ky modalitet mundëson dëgjimin e audios në Hi-Fi më të lartë dhe zgjedhjen e modalitetit të dekodimit për dëgjim audioje stereo 2-kanalëshe ose mono si audio shumëkanalëshe.
- **2 channel sound mode:** Audion në dalje mund ta kaloni në 2-kanalëshe, pavarësisht formateve të regjistrimit të softuerit që përdorni, pajisjes së lidhur luajtëse apo cilësimeve të fushës zanore të marrësit.

■ A.F.D. Auto (A.F.D. AUTO)

E paracakton zërin sipas regjistrimit/kodimit pa i shtuar efekte rrethuese. Megjithatë, për modelet në SHBA dhe Kanada, ky marrës do të krijojë një sinjal me frekuencë të ulët për dalje në altoparant bas kur nuk ka sinjale LFE.

■ Multi Stereo (MULTI ST.)

Nxjerr sinjale 2-kanalëshe majtas/djathtas ose sinjale mono nga të gjithë altoparlantët. Megjithatë, audioja mund të mos dalë nga disa altoparlantët, në varësi të cilësimeve të altoparlantit.

■ 2ch Stereo (2CH ST.)

Marrësi e nxjerr zërin vetëm nga altoparlantët e përpamë majtas/djathtas. Nuk ka dalje të zërit nga nën-vuferi. Burimet standarde stereo 2-kanalëshe e anashkalojnë plotësisht procesimin e fushës zanore dhe formatet shumëkanalëshe rrethuese miksohen në 2 kanale.

■ 2ch Analog Direct (A. DIRECT)

Audion e zgjedhur hyrëse mund ta kaloni në hyrjen analoge 2-kanalëshe. Ky funksion mundëson burime analoge të cilësisë së lartë. Kur përdorni këtë funksion, mund të rregullohet vetëm volumni dhe niveli i altoparlantëve të përpamë.

Shënim

Nuk mund të zgjidhni "2ch Analog Direct" kur përdorni funksionet BD, DVD, GAME, VIDEO 2, VIDEO 3, USB, Home Network, SEN dhe AirPlay.

Modaliteti i filmit

Audion rrethuese mund ta caktoni thjesht duke zgjedhur një prej fushave të paraprogramuara zanore të marrësit. Ato sjellin në shtëpinë tuaj audion emocionuese dhe të fuqishme të kinemasë.

■ HD-D.C.S.

HD Digital Cinema Sound (HD-D.C.S.) është teknologjia e re novatore e kinemasë në shtëpi nga Sony, e cila përdor teknologjitë më bashkëkohore të procesimit të sinjaleve dixhitale dhe akustike. Ajo bazohet në të dhënat e përpikta të matjes së reagimit nga studio masterizimi.

Me këtë modalitet, mund të shihni në shtëpi filma Blu-ray dhe DVD, jo vetëm me cilësi të lartë të zërit, por edhe me atmosferën e përshtatshme akustike, ashtu siç ka qenë qëllimi i inxhinierit të zërit të filmit gjatë masterizimit.

- **Dynamic:** Ky cilësim është i përshtatshëm për ambiente kumbuese, por i mungon ndjesia e hapësirës (ku përthithja e zërit nuk është e mjaftueshme). Ai thekson pasqyrimin e zërit dhe riprodhon zërin e një kinemaje të madhe klasike. Në këtë mënyrë, forcohet ndjesia e hapësirës së një studioje regjistrimi të zërit dhe krijohet një fushë e veçantë zanore.
- **Theater:** Ky cilësim është i përshtatshëm për një dhomë të zakonshme ndenjeje. Ai riprodhon rezonancën e zërit si në kinema (studio regjistrimi). Është më i përshtatshmi për të parë materiale të regjistruara në Blu-ray Disc, kur dëshironi të krijoni atmosferë kinemaje.
- **Studio:** Ky cilësim është i përshtatshëm për dhomë ndenjeje me pajisjet e duhura zanore. Ai riprodhon rezonancën kur burimi zanor i filmit është miksuar për Blu-ray Disc në volum të përshtatshëm për përdorim në shtëpi. Niveli i pasqyrimin dhe i rezonancës së zërit mbahet në minimum. Megjithatë, dialogët dhe efektet zanore rrethuese riprodhohen në mënyrë të gjallë.

■ PLII Movie

Kryen dekodim Dolby Pro Logic II të modalitetit të filmit. Ky cilësim është ideal për filmat e koduar me Dolby Surround. Përveç kësaj, ky modalitet mund të riprodhojë zë në format 5.1-kanalësh për të parë videot e filmave me dublim ose të filmave të vjetër.

■ PLIIx Movie

Kryen dekodim Dolby Pro Logic IIx të modalitetit të filmit. Ky cilësim zgjeron Dolby Pro Logic II Movie ose Dolby Digital 5.1 në 7.1-kanalësh të dedikuar për filma.

■ **PLIIz Movie (PLIIz)**

Kryen dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic IIz. Ky cilësim mund të zgjerojë audion burimore nga 5.1 në 7.1 kanale, së cilës i aplikohet pajisja vertikale duke përfutur ndjesinë e pranisë dhe të përmasave fizike.

■ **Neo:6 Cinema (Neo:6 CIN)**

Kryen dekodim të modalitetit DTS Neo:6 Cinema. Një burim i regjistruar në format me 2 kanale dekodohet deri në 7 kanale.

Modaliteti i muzikës

Mund të keni zë rrethues thjesht duke zgjedhur një prej fushave të paraprogramuara zanore të marrësit. Ato sjellin në shtëpinë tuaj audion emocionuese dhe të fuqishme të sallave të koncerteve.

■ **Berlin Philharmonic Hall (BERLIN)**

Riprodhon veçoritë akustike të Sallës së Filarmonisë së Berlinit.

■ **Concertgebouw Amsterdam (CONCERTGEB)**

Riprodhon veçoritë akustike që krijohen nga aftësia kumbuese e sallës së koncerteve në Amsterdam, Holandë, e cila ka një skenë të madhe akustike.

■ **Musikverein Vienna (MUSIKVEREI)**

Riprodhon veçoritë akustike të sallës së koncerteve në Vjenë, Austri, e cila ka akustikë ët veçantë rezonante e kumbuese.

■ **Jazz Club (JAZZ)**

Riprodhon akustikën e një klubi xhazi.

■ **Live Concert (CONCERT)**

Riprodhon akustikën e një salle koncertesh me 300 vende.

■ **Stadium (STADIUM)**

Riprodhon ndjesinë e një stadiumi të madh të hapur.

■ **Sports (SPORTS)**

Riprodhon ndjesinë e transmetimeve sportive.

■ **Portable Audio (PORTABLE)**

Riprodhon një perceptim të qartë të përmirësuar të zërit nga pajisja portative audio. Ky modalitet është ideal për MP3 dhe llojet e tjera të muzikës me skedarë të kompresuar.

■ **PLII Music**

Kryen dekodim Dolby Pro Logic II të modalitetit të muzikës. Ky cilësim është ideal për burimet normale stereo, si p.sh. CD-të.

■ **PLIIx Music**

Kryen dekodim Dolby Pro Logic IIx të modalitetit të muzikës. Ky cilësim është ideal për burimet normale stereo, si p.sh. CD-të.

■ **PLIIz Music (PLIIz)**

Kryen dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic IIz. Ky cilësim mund të zgjerojë audion burimore nga 5.1 në 7.1 kanale, së cilës i aplikohet pajisja vertikale duke përfutur ndjesinë e pranisë dhe të përmasave fizike.

■ **Neo:6 Music (Neo:6 MUS)**

Kryen dekodim të modalitetit DTS Neo:6 Music. Një burim i regjistruar në format me 2 kanale dekodohet deri në 7 kanale. Ky cilësim është ideal për burimet normale stereo, si p.sh. CD-të.

Kur janë lidhur kufje

Mund ta zgjidhni këtë fushë zanore kur kufjet lidhen me marrësin.

■ Headphone (2ch) (HP 2CH)

Ky modalitet zgjidhet automatikisht nëse përdorni kufje (përveç "2ch Analog Direct"). Burimet standarde stereo 2-kanalëshe e anashkalojnë plotësisht procesimin e fushës zanore dhe formatet shumëkanalëshe rrethuese miksohen në 2 kanale, përveç sinjaleve LFE.

■ Headphone (Direct) (HP DIRECT)

Ky modalitet zgjidhet automatikisht nëse përdorni kufjet kur është zgjedhur "2ch Analog Direct".

Nxjerr sinjalet analoge pa procesim balancuesi, fushe zanore etj.

Nëse lidhni një nën-vufer


Ky marrës do të krijojë një sinjal me frekuencë të ulët për dalje në nën-vufer ku nuk ka sinjale LFE, i cili është një efekt zanor me kalim të ulët nga një nën-vufer në sinjal me 2 kanale. Megjithatë, sinjali i frekuencës së ulët nuk krijohet për "Neo:6 Cinema" ose "Neo:6 Music" kur të gjithë altoparlantët janë vendosur në "Large". Për të shfrytëzuar plotësisht qarkun e ridrejtimt të basit Dolby Digital, rekomandojmë vendosjen e frekuencës së prerjes së nën-vuferit sa më të lartë të jetë e mundur.

Shënime për fushat zanore

- Në varësi të cilësimeve të motivit të altoparlantit, disa fusha zanore mund të mos disponohen.
- Nuk mund të zgjidhni "PLIIx Movie", "PLIIx Music", "PLIIz Movie" dhe "PLIIz Music" në të njëjtën kohë.
 - "PLIIx Movie" dhe "PLIIx Music" disponohen vetëm kur motivi i altoparlantit është caktuar në cilësim me altoparlantë të pasmë rrethues.
 - "PLIIz Movie" dhe "PLIIz Music" disponohen vetëm kur motivi i altoparlantit është caktuar në cilësim me altoparlantë të lartë të përparmë.
- Fusha zanore për muzikën dhe filmat nuk funksionon në rastet e mëposhtme.
 - Merrren DTS-HD Master Audio, DTS-HD High Resolution Audio ose Dolby TrueHD me frekuencë modulimi mbi 48 kHz.
 - Zgjidhet "2ch Analog Direct".
- "PLII Movie", "PLII Music", "PLIIx Movie", "PLIIx Music", "PLIIz Movie", "PLIIz Music", "Neo:6 Cinema" dhe "Neo:6 Music" nuk funksionojnë kur motivi i altoparlantit është caktuar në 2/0 ose 2/0.1.
- Kur zgjidhet një nga fushat zanore për muzikën, nuk do të ketë zë nga nën-vuferi nëse të gjitha altoparlantët janë të vendosur si "Large" në menynë Speaker Settings. Sidoqoftë, zëri do të dalë nga nën-vuferi nëse
 - sinjali hyrës dixhital përmban sinjale LFE.
 - altoparlantët e përparmë ose rrethues janë vendosur si "Small".
 - Është zgjedhur "Multi Stereo", "PLII Movie", "PLII Music", "PLIIx Movie", "PLIIx Music", "PLIIz Movie", "PLIIz Music", "HD-D.C.S." ose "Portable Audio".

Rregullimi i balancuesit

Mund të përdorni parametrat e mëposhtëm për të rregulluar cilësinë tonale (nivele të bas/alto) të altoparlantëve të përparmë, qendrorë, rrethues/rrethues të lartë të pasmë dhe të përparmë.



- 1 Zgjidhni "Sound Effects" nga menyuja kryesore dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni "Equalizer" dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni "Front", "Center", "SUR/SB", ose "Front High" dhe shtypni (+).
- 4 Zgjidhni "Bass" ose "Treble" dhe rregulloni përforsimin.

Shënime

- Ky funksion nuk punon kur përdoret "2ch Analog Direct".
- Frekuencat për Bass dhe Treble janë të fiksuara.
- Në varësi të formatit audio, marrësi mund të luajë sinjale në frekuencë më të ulët modulimi se frekuenca origjinale e modulimit të sinjaleve hyrëse.

Përdorimi i funksionit Sound Optimizer

Sound Optimizer mundëson audio të qartë e dinamike në volume të ulëta. Ajo e kalibron automatikisht zërin që nuk mund të dëgjohet mirë kur ju ulni volumnin. Pasi kryhet Auto Calibration, niveli i zërit optimizohet për t'iu përshtatur ambientit tuaj.

- 1 Zgjidhni "Sound Effects" nga menyuja kryesore dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni "Sound Optimizer" dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni "Normal" ose "Low" dhe shtypni (+).

Funksioni Sound Optimizer është i aktivizuar. Për të rregulluar nivelin referencë të një filmi, zgjidhni "Normal". Për të rregulluar një CD ose një softuer tjetër, niveli mesatar i trysnisë zanore të të cilit ka përpunim të lartë, zgjidhni "Low".

Shënime

- Ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme.
 - Kur përdoret "2ch Analog Direct".
 - Kur janë lidhur kufje.
- Marrësi mund të luajë sinjale në frekuencë më të ulët modulimi se frekuenca aktuale e modulimit të sinjaleve hyrëse, në varësi të formatit audio.

Zgjedhja e llojit të kalibrimit

Mund të zgjidhni llojin e kalibrimit që dëshironi pas të keni kryer Auto Calibration. Për detaje, shihni "Auto Calibration Type" (faqe 90).

Përdorimi i funksionit Pure Direct

Modaliteti Pure Direct mundëson audio me Hi-Fi më të lartë. Kur aktivizohet Pure Direct, paneli i ekranit fiket për të ulur zhurmën që ndikon në cilësinë e zërit. Ju mund të përdorni funksionin Pure Direct me të gjitha hyrjet.

- 1 Zgjidhni "Sound Effects" nga menyuja kryesore dhe shtypni (+).**
- 2 Zgjidhni "Pure Direct" dhe shtypni (+).**
- 3 Zgjidhni "On" dhe shtypni (+).**

Shënim

Kur zgjidhet funksioni Pure Direct, "Equalizer", "Sound Optimizer", "Advanced Auto Volume" dhe "Dynamic Range Compressor" nuk punojnë.

Këshillë

Mund të përdorni edhe butonin PURE DIRECT në telekomandë ose marrës për të aktivizuar ose çaktivizuar funksionin Pure Direct.


Për të anuluar Pure Direct

Funksioni Pure Direct do të anulohet kur veproni si më poshtë:

- Zgjidhni "Off" në hapin 3 të "Përdorimi i funksionit Pure Direct" (faqe 58).
- Shtypni përsëri PURE DIRECT.
- Ndryshoni fushën zanore.
- Ndryshoni cilësimin e skenës në televizor (Scene Select).
- Ndryshoni cilësimin e "Equalizer", "Sound Optimizer", "Advanced Auto Volume" ose "Dynamic Range Compressor".

Rivendosja e fushave zanore në cilësimet e parazgjedhura

Sigurohuni të përdorni butonat në marrës për të kryer këtë veprim.



- 1 Shtypni I/⏻ për të fikur marrësin.**
- 2 Ndërsa mbani shtypur MUSIC, shtypni I/⏻.**

"S.F. CLEAR" shfaqet në panelin e ekranit dhe të gjitha fushat zanore rivendosen në cilësimet e tyre të parazgjedhura.

Rreth funksioneve të rrjetit të marrësit

- Mund të shijoni përmbajtjen audio të ruajtur në një pajisje që mbështet DLNA (Produktet DLNA CERTIFIED™) që ka një logo të autorizuar të shfaqur në pajisje (faqe 65).
- Mund ta përdorni marrësin si një pajisje ekuivalente me një pasqyrues media UPnP në rrjetin e shtëpisë.
- Me një lidhje interneti, mund të dëgjoni shërbime muzike (faqe 68) dhe të përditësoni softuerin e marrësit (faqe 73).
- Me funksionin PARTY STREAMING, mund të dëgjoni të njëjtën muzikë në të njëjtën kohë në dhoma të ndryshme.
- Mund të regjistroni pajisje TV SideView për të komanduar marrësin.
- Mund të luani pjesë audio nga pajisje iOS ose iTunes Library me AirPlay.

Rreth DLNA

DLNA (Digital Living Network Alliance) është një organizatë standarde e përbërë nga prodhues të produkteve të ndryshme, si serverë (kompjuterë, etj.), pajisje AV, dhe pajisje llogaritëse të lëvizshme të cilat shkëmbejnë përmbajtje (muzikë, foto, dhe video). DLNA vendos standardet dhe publikon një logo të autorizuar që do të shfaqet te pajisjet që mbështesin standardet DLNA.

Konfigurimi i serverit

Për të dëgjuar materiale audio të ruajtura në serverin tuaj me këtë marrës, duhet të konfiguroni paraprakisht serverin. Pajisjet e mëposhtme të serverit janë të përputhshme me këtë marrës.

- Sony VAIO Media plus 1.3, 1.4, 2.0, dhe 2.1
- Sony HDD Network Audio System NAS-S500HDE*, NAS-S55HDE*
- Marrësi Sony Network AV STR-DA6400ES*, TA-DA5600ES*
- Microsoft Windows Media Player 12 i instaluar në Windows 8 dhe Windows 7 (faqe 60, 62)
- Microsoft Windows Media Player 11 i instaluar në Windows Vista/Windows XP (faqe 63)

* Nuk është i disponueshëm në disa shtete ose rajone.

Nëse serveri ka një funksion që kufizon aksesin nga pajisje të tjera, duhet të ndryshoni cilësimin në server për ta lejuar marrësin që ta përdorë atë. Ky seksion shpjegon si të konfiguroni Windows Media Player kur e përdorni si server.

Për hollësi rreth cilësimeve të pajisjeve të tjera të serverit, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit ose ndihmës të pajisjes ose aplikacionit përkatës.


Shënime

- Elementët e shfaqur në kompjuter mund të ndryshojnë nga të mëposhtmit, në varësi të versionit të sistemit operativ ose ambientit të kompjuterit. Për detaje, referojuni Ndhimës së sistemin tuaj operativ.
- Në varësi të situatës, mund të duhet pak më shumë kohë kur luani muzikë duke përdorur veçorinë "Play To" në Windows.

Kur përdorni Windows 8

Ky seksion shpjegon se si të konfiguroni Windows Media Player 12 të instaluar nga prodhuesi për Windows 8. Për hollësi se si të operoni me Windows Media Player 12, referojuni Ndihmës së Media Player 12.

- Shkoni te Paneli i Kontrollit. Zgjidhni [All Apps (Të gjitha aplikacionet)] te [Start (Nisja)]. Zgjidhni [Control Panel (Paneli i kontrollit)].**



Këshillë

Nëse ekranin e Windows 8 nuk shfaqet si më sipër, procedoni me hapat e mëposhtme.

- Zgjidhni [Control Panel (Paneli i kontrollit)] te [Settings (Cilësimet)].**




- Zgjidhni [View network status and tasks] (Paraqit detyrat dhe statusin e rrjetit) te [Network and Internet] (Rrjeti dhe interneti).**


Shfaqet dritarja [Network and Sharing Center (Qendra e rrjetit dhe e ndarjes)].

Këshillë


Nëse elementi që dëshironi nuk shfaqet në ekran, përpikuni të ndryshoni llojin e ekranit të Panelit të Kontrollit.



3 Zgjidhni [Change advanced sharing settings] (Ndrysho parametrat e përpaparur të përbashkimit).




4 Zgjidhni [Choose media streaming options...] (Zgjidh opsionet e transmetimit të vazhdueshëm të medias...) te [Media streaming] (Transmetimi i medias) nga [All Networks] (Të gjitha rrjetet).



5 Nëse [Media streaming is not turned on] (Transmetimi i vazhdueshëm i medias nuk është aktivizuar) shfaqet në dritaren [Media streaming options] (Opsionet e transmetimit të vazhdueshëm të medias) zgjidhni [Turn on media streaming] (Aktivizo transmetimin e vazhdueshëm të medias).

6 Zgjidhni [Allow All (Lejo të gjitha)]. Hapet dritarja [Allow All Media Devices (Lejo të gjitha pajisjet e medias)].

Nëse të gjitha pajisjet në rrjetin lokal janë të caktuara në [Allowed (Lejuar)], zgjidhni [OK] dhe mbyllni dritaren.



7 Zgjidhni [Allow all computers and media devices (Lejo të gjithë kompjuterët dhe pajisjet e medias)].

8 Zgjidhni [Next (Tjetër)] dhe [Finish (Përfundo)] për të mbyllur dritaren.


9 Freskoni listën e serverëve.

Kur të përfundojnë cilësimet, rifreskoni listën e serverit të marrësit dhe zgjidhni këtë server nga lista e serverëve. Për hollësi për zgjedhjen e serverit, shihni "Për të rifreskuar listën e serverëve" (faqe 64).

Kur përdorni Windows 7

Ky seksion shpjegon si të konfiguroni Windows Media Player të instaluar nga prodhuesi për Windows 7. Për detaje se si të operoni Windows Media Player 12, referojuni Ndhimës për Windows Media Player 12.

1 Shkoni te [Start (Nisja)] – [Control Panel (Paneli i kontrollit)].



2 Zgjidhni [View network status and tasks (Shiko statusin e rrjetit dhe detyrat)] te [Network and Internet (Rrjeti dhe interneti)].


Shfaqet dritarja [Network and Sharing Center (Qendra e rrjetit dhe e ndarjes)].

Këshillë

Nëse elementi që dëshironi nuk shfaqet në ekran, përpikuni të ndryshoni llojin e ekranit të Panelit të Kontrollit.

3 Zgjidhni [Public network (Rrjeti publik)] te [View your active networks (Shiko rrjetet aktive)]. Nëse ekran shfaq ndryshe nga [Public Network (Rrjeti publik)], publikani në hapin 6.

Shfaqet dritarja [Set Network Location (Vendos vendndodhjen e rrjetit)].




4 Zgjidhni [Home network (Rrjeti i shtëpisë)] ose [Work network (Rrjeti i punës)] në varësi të ambientit ku përdoret marrësi.


5 Ndiqni udhëzimet që shfaqen në ekran në varësi të ambientit ku përdoret marrësi.

Pasi të përfundojnë cilësimet, konfirmoni që elementi te [View your active networks (Shiko rrjetet aktive)] të jetë ndryshuar në [Home network (Rrjeti i shtëpisë)] ose [Work network (Rrjeti i punës)] në dritaren [Network and Sharing Center (Qendra e rrjetit dhe e ndarjes)].

6 Zgjidhni [Change advanced sharing settings] (Ndrysho parametrat e përpunuar të përbashkimit).




7 Zgjidhni [Choose media streaming options... (Zgjidh opsionet e transmetimit të medias...)] nga [Media streaming (Transmetimi i medias)].



8 Nëse [Media streaming is not turned on (Transmetimi i medias nuk është aktivizuar)] shfaqet në dritaren [Media streaming options (Opsionet e transmetimit të medias)], zgjidhni [Turn on media streaming (Aktivizo transmetimin e medias)].

9 Zgjidhni [Allow all (Lejo të gjitha)]. Hapet dritarja [Allow All Media Devices (Lejo të gjitha pajisjet e medias)]. Nëse të gjitha pajisjet në rrjetin lokal janë të caktuara në [Allowed (Lejuar)], zgjidhni [OK] dhe mbyllni dritaren.



10 Zgjidhni [Allow all computers and media devices] (Lejo të gjithë kompjuterët dhe pajisjet e medias).

11 Zgjidhni [OK] për të mbyllur dritaren.

12 Freskoni listën e serverëve.

Pasi të përfundoni konfigurimin e Windows Media Player 12, freskoni listën e serverëve të marrësit dhe zgjidhni këtë server nga lista. Për hollësi për zgjedhjen e serverit, shihni "Për të rifreskuar listën e serverëve" (faqe 64).


Kur përdorni Windows Vista/XP

Ky seksion shpjegon si të konfiguroni Windows Media Player 11 të instaluar tek Windows Vista/XP*.

Për detaje se si të operoni Windows Media Player 11, referojuni Ndihmës për Windows Media Player 11.

* Windows Media Player 11 nuk është instaluar nga prodhuesi tek Windows XP. Futuni në uebsajtin e Microsoft, shkarkoni instaluesin dhe instaloni më pas Windows Media Player 11 në kompjuterin tuaj.

1 Shkoni te [Start (Nisja)] – [All Programs (Të gjitha programet)].




2 Zgjidhni [Windows Media Player]. Ndizet Windows Media Player 11.

3 Zgjidhni [Media Sharing... (Ndarja e medias)] nga menyuja [Library (Biblioteka)].


Nëse jeni duke përdorur Windows XP, kaloni në hapin 9.

4 Kur shfaqet [Warning (Ndërgjegjësim)] , zgjidhni [Networking... (Rrjeti...)].




Shfaqet dritarja [Network and Sharing Center (Qendra e rrjetit dhe e ndarjes)].

5 Zgjidhni [Customize (Personalizo)].



Shfaqet dritarja [Set Network Location (Vendos vendndodhjen e rrjetit)].


6 Shënoni [Private] dhe zgjidhni [Next (Tjetër)].



7 Konfirmoni që [Location type (Lloji i vendndodhjes)] ka ndryshuar në [Private], dhe zgjidhni [Close (Mbyll)].

8 Konfirmoni që [(Private network) (Rrjet privat)] është shfaqur në dritaren [Network and Sharing Center (Qendra e rrjetit dhe e ndarjes)], dhe mbyllni dritaren.

9 Nëse [Share my media (Ndaj median time)] nuk është zgjedhur në dritaren [Media Sharing (Ndarja e medias)], zgjidhni [Share my media (Ndaj median time)], dhe më pas zgjidhni [OK]. Shfaq një listë pajisjesh që mund të lidhen."



10 Zgjidhni [Settings... (Cilësimet...)] që shfaqet pranë [Share my media to: (Ndaj median time me:)].

11 Shënoni [Allow new devices and computers automatically (Lejo automatikisht të gjitha pajisjet dhe kompjuterët)] dhe zgjidhni [OK].

Shënim

Çzgjidheni këtë element pasi të konfirmoni se marrësi mund të lidhet me serverin dhe mund të luajë materiale audio të ruajtura në server.

12 Freskoni listën e serverëve.

Pasi të përfundoni konfigurimin e Windows Media Player 11, freskoni listën e serverëve të marrësit dhe zgjidhni këtë server nga lista. Për hollësi për zgjedhjen e serverit, shihni "Për të rifreskuar listën e serverëve" (faqe 64).

Për të rifreskuar listën e serverëve

Kur shtoni një server të ri në rrjetin e shtëpisë, ose kur nuk arrini të gjeni serverin që dëshironi në listë, rifreskoni listën e serverëve.

1 Ndërkohë që shfaqet lista e serverëve, shtypni OPTIONS.

2 Zgjidhni "Refresh" dhe shtypni (+).
Shfaqet lista e freskuar e serverëve.

Këshillë

Marrësi ruan një histori të pesë serverëve të fundit të lidhur dhe këto serverë shfaqen në fillim të listës së serverëve. Në një listë serverësh mund të shfaqen deri në 20 serverë.

Për të fshirë një server nga lista e serverëve

1 Ndërkohë që shfaqet lista e serverëve, zgjidhni serverin që dëshironi të fshini, dhe më pas shtypni OPTIONS.

Shfaqet menyuja e opsioneve.

2 Zgjidhni "Delete" dhe shtypni (+).
Dritarja e konfirmimit shfaqet në ekranin e televizorit.

3 Zgjidhni "OK" dhe shtypni (+).
Shfaqet "Complete!" dhe serveri i zgjedhur fshihet.



Shënim

Edhe nëse e fshini serverin nga lista e serverëve, ai do të shfaqet sërish në listë nëse marrësi e gjen në rrjet (si p.sh. kur freskoni listën e serverëve).

Përdorimi i materialeve audio të ruajtura në server



Mund të riprodhoni materiale audio të ruajtura në server duke përdorur marrësin në formate MP3, Linear PCM, WMA, FLAC and AAC*. Materiale audio të mbrojtura nga e drejta e autorit DRM (Digital Rights Management) nuk mund të luhen në këtë marrës.

* Marrësi mund të luajë skedarë vetëm me prapashësë ".m4a", ".mp4" or ".3gp".



1 Shtypni HOME NETWORK.

Lista e serverëve shfaqet në ekranin e televizorit.

Nëse në ekranin e televizorit shfaqet elementi i fundit i zgjedhur (lista e luajtjes, album, dosje, etj.), shtypni në mënyrë të përsëritur RETURN  deri sa të shfaqet lista e serverëve. Kur shfaqet "No server is available", ose kur serveri në listë nuk është i disponueshëm, shtypni OPTIONS. Zgjdhni "Refresh", dhe shtypni . Shfaqet lista e freskuar e serverëve.

Këshillë

Mund dhe të zgjidhni "Home Network" nga "Listen" në menyën kryesore.

2 Zgjidhni ikonën e serverit DLNA dhe shtypni .

Lista e përmbajtjeve shfaqet në ekranin e televizorit.

Shënim

Nëse pajisja e serverit mbështet standardin Wake-on-LAN, marrësi e ndez automatikisht serverin. Nëse serveri nuk mbështet standardin Wake-on-LAN, ndizni paraprakisht serverin. Për hollësi rreth cilësimeve ose veprimeve të serverit Wake-on-LAN, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit ose ndihmës të serverit tuaj.

3 Zgjidhni elementin që dëshironi (lista e luajtjes, album, dosje, etj.) dhe shtypni .

Nëse shfaqet një element tjetër, përsëriteni këtë hap për të pakësuar mundësitë deri sa të shfaqet elementi që dëshironi. Elementët që shfaqen varen nga serveri i lidhur.

4 Zgjidhni pjesën që dëshironi dhe shtypni .

Fillon riprodhimi. Sigurohuni që zëri të dalë nga altoparlantët e marrësit.

Shënime

- Në ekran shfaqen gjithashtu edhe pjesët që marrësi nuk mund t'i luajë. Pjesët që mund të luhen nuk mund t'i rendisni.
- Nëse hiqni kordonin elektrik nga priza, luajtja nuk rinis nga elementi i fundit i zgjedhur.
- Marrësit mund t'i duhet kohë për të shfaqur elementet kur është duke shfletuar dosje që ka numër të madh materialesh audio. Në këtë rast, përdorni Kërkimin e Fjalëve Kyçe (faqe 75).

Këshilla

- Nëse zgjidhni një dosje (si p.sh. dosja e një artisti, dosja e një zhanri, etj.) dhe shtypni butonin ►, marrësi i luan të gjithë elementët në dosjen e zgjedhur.
- Marrësi rinis nga elementi i fundit i zgjedhur kur funksioni ka ndryshuar në funksionin Rrjet i Shtëpisë, deri sa të fiket marrësi. Kur "Network Standby" është "On", luajtja rinis nga elementi i fundit i zgjedhur, edhe kur keni fikur marrësin.

Për të vendosur Access Settings

Mund të caktoni kufizime ose leje hyrjeje për pajisjet në listën e pajisjeve.

1 Shtypni HOME NETWORK.

Këshillë

Mund dhe të zgjidhni "Home Network" nga "Listen" në menynë kryesore.

2 Shtypni OPTIONS.

3 Zgjidhni "Access Settings" dhe shtypni (+).

Për të caktuar leje automatike hyrjeje

- 1 Zgjidhni "Auto Access" tek "Access Settings" dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni "Allow" ose "Not Allow" dhe shtypni (+).
 - **Allow:** Të gjitha pajisjet në rrjetin e shtëpisë janë të lejuara të kenë akses te ky marrës. Ky marrës mund të fillojë një PARTY si pajisje pritëse dhe nëse i kërkohet të bashkohet me një PARTY si pajisje e ftuar.

- **Not Allow:** Ky marrës kufizon një pajisje të re që po krijon akses te marrësi. Kur të lidhni një pajisje të re me rrjetin e shtëpisë, shtoni pajisjen në listën e pajisjeve dhe caktoni lejen e aksesit (faqe 66).

Shënim

Në listën e pajisjeve mund të shtohen deri në 20 pajisje. Nëse tashmë janë regjistruar 20 pajisje, shfaqet "Device Full" dhe nuk mund të shtohen pajisje të reja në listë. Në këtë rast, fshini pajisjet e panevojshme nga lista (faqe 67).

Për të shtuar pajisje te lista e pajisjeve

- 1 Zgjidhni "Control Device" tek "Access Settings" dhe shtypni (+).
Lista e pajisjeve të regjistruara shfaqet në ekranin e televizorit.
- 2 Zgjidhni "Add Device" dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni pajisjen që dëshironi dhe shtypni (+).

Pajisja e zgjedhur i shtohet listës së pajisjeve. Për detajet në cilësimin e aksesit, shihni "Për të vendosur lejen e aksesit për pajisjet" (faqe 66).

Për të vendosur lejen e aksesit për pajisjet

Ju mund të vendosni kufizime për një pajisje në listën e pajisjeve. Vetëm pajisjet e caktuara në "Allow" njihen në rrjetin e shtëpisë.

- 1 Zgjidhni "Control Device" tek "Access Settings" dhe shtypni (+).
Lista e pajisjeve të regjistruara shfaqet në ekranin e televizorit.
- 2 Zgjidhni pajisjen që dëshironi dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni "Access" dhe shtypni (+).
- 4 Zgjidhni "Allow" ose "Not Allow" dhe shtypni (+).

Për të fshirë një pajisje nga lista

Zgjidhni "Delete" në hapin 3 të "Për të vendosur lejen e aksesit për pajisjet" (faqe 66) dhe shtypni (+).
Zgjidhni "OK" në ekranin e konfirmimit dhe shtypni (+).

Përdorimi i TV SideView

TV SideView është një aplikacion falas për pajisjet në distancë (celularët inteligjentë etj.). Nëse përdorni TV SideView me këtë marrës, mund ta shfrytëzoni më lehtë marrësin me anë të veprimeve të pajisjes në distancë.

Për të regjistruar TV SideView Device

1 Shtypni HOME NETWORK.

Këshillë

Mund dhe të zgjidhni "Home Network" nga "Listen" në menyën kryesore.

2 Shtypni OPTIONS.

3 Zgjidhni "TV SideView Device Registration" dhe shtypni (+).

4 Zgjidhni "Start Registration" dhe shtypni (+).

Marrësi fillon të diktojë pajisjen TV SideView që është gati për regjistrimin. "Connecting" shfaqet në ekranin e televizorit. Shtypni "Registration" në pajisjen TV SideView. Megjithatë, marrësi do të dalë nga regjistrimi nëse nuk diktohen pajisje brenda 30 sekondave.

5 Zgjidhni "Finish" dhe shtypni (+).

Për të anuluar regjistrimin

Zgjidhni "Cancel" në hapin 4 dhe më pas shtypni (+).

Shënim

Në listën e pajisjeve mund të shtohen deri në 5 pajisje TV SideView. Nëse tashmë janë regjistruar 5 pajisje, shfaqet "Device Full" dhe nuk mund të shtohen pajisje të reja në listë. Në këtë rast, fshini pajisjet e panevojshme nga lista (faqe 67).

Për të parë Registered TV SideView Device

Zgjidhni "Registered TV SideView Devices" në hapin 3 dhe shtypni (+).

Për të fshirë Registered TV SideView Devices nga lista e pajisjeve

1 Zgjidhni "Registered TV SideView Devices" në hapin 3 dhe shtypni (+).

2 Zgjidhni pajisjen që dëshironi të fshini dhe shtypni (+).

3 Zgjidhni "Delete" dhe më pas shtypni (+).

4 Zgjidhni "OK" dhe shtypni (+).

Pajisja e zgjedhur është fshirë nga lista e pajisjeve.


Për të kontrolluar mbrojtjen e së drejtës të autorit

Marrësi nuk mund të luajë skedarë të formatit WMA të mbrojtur me të drejta autori DRM.

Nëse një skedar WMA nuk mund të riprodhohet në këtë marrës, kontrolloni pronësinë e skedarit në kompjuterin tuaj për të parë nëse ka të drejta autori DRM. Hapni dosjen ose volumnin ku ruhet skedar i WMA dhe klikoni me të djathtën mbi skedar për të shfaqur dritaren [Properties (Vetitë)]. Nëse ka skedë [License] (Licenca), skedari mbrohet me të drejta autori DRM dhe nuk mund të luhet në këtë marrës.

Për të përdorur funksionin Home Network me anë të telekomandës

Për	Veproni si më poshtë
Vendosjen në pauzë të riprodhimit*	Shtypni gjatë riprodhimit. Shtypni ▶ për të rinisur riprodhimin.
Ndalimin e riprodhimit	Shtypni ■ .

Për	Veproni si më poshtë
Vajtjen në fillim të pjesës aktuale, pjesës së mëparshme/tjetër	Shtypni në mënyrë të përsëritur ◀◀/▶▶.
Rizgjedhjen e elementit që dëshironi të luani	Shtypni RETURN  në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet direktoria që dëshironi. Ose shtypni OPTIONS, zgjidhni "Server List" dhe zgjidhni elementin që dëshironi. Për t'u kthyer në ekranin e riprodhimit, shtypni OPTIONS dhe zgjidhni "Now Playing".
Kërkimin e elementit që dëshironi duke përdorur një fjalë kyçe	Ndërsa zgjidhni materialet në server, shtypni ALPHABET SEARCH dhe shkruani një fjalë kërkimi (faqe 75).
Ndryshimi i serverit	Kur luajtja ka ndaluar, shtypni OPTIONS. Zgjidhni "Server List" dhe shtypni ⊕. Zgjidhni serverin që dëshironi dhe shtypni ⊖.
Zgjidhni luajtjen e përsëritur	Shtypni vazhdimisht REPEAT derisa "Repeat All" ose "Repeat 1" të shfaqet në ekranin e televizorit.
Zgjidhni luajtje të përzier	Shtypni vazhdimisht SHUFFLE derisa të shfaqet "Shuffle On" në ekranin e televizorit.

* Në varësi të serverit ose pjesës, ndalimi i riprodhimit mund të mos funksionojë kur është zgjedhur funksioni Home Network.


Shijimi i Sony Entertainment Network (SEN)

Mund të dëgjoni shërbimet e muzikës të ofruara në internet me anë të këtij marrësi (funksioni SEN).

Për të përdorur këtë funksion, marrësi duhet të jetë i lidhur me rrjetin dhe rrjeti duhet të jetë i lidhur me internetin. Për hollësi, shihni "6: Lidhja me rrjetin" (faqe 34).


Vizitoni uebsajtin e mëposhtëm për më shumë informacione rreth SEN-it:

<http://www.sonyentertainmentnetwork.com>




Shënim

Përpara se të përdorni shërbimet e muzikës, mund t'ju duhet të regjistroni marrësin tuaj në varësi të ofruesit të shërbimit. Për hollësi rreth regjistrimit, vizitoni sajtin mbështetës për konsumatorët të ofruesit të shërbimit.



Hapat e mëposhtëm shpjegojnë si të zgjidhni "vTuner", si shembull i shërbimeve të muzikës të ofruara në internet.

1 Shtypni SEN.




Lista e ofruesve të shërbimit shfaqet në ekranin e televizorit. Nëse marrësi shfaq automatikisht shërbimin ose stacionin e zgjedhur, shtypni vazhdimisht RETURN  derisa të shfaqet lista e ofruesve të shërbimit.

Këshillë

Mund dhe të zgjidhni "SEN" nga "Listen" në menyën kryesore.

2 Zgjidhni "vTuner" dhe shtypni .

3 Zgjidhni dosjen ose stacionin që dëshironi dhe shtypni .

- Shtypni vazhdimisht  për të zgjedhur elementin.
- Shtypni  për të kaluar te direktoria tjetër ose për të dëgjuar stacionin.
- Shtypni RETURN  për të kaluar te direktoria e mëparshme.



Shënim

Nëse shfaqet "No service is available" dhe nuk mund të përfiton një listë të ofruesve të shërbimit, shtypni OPTIONS dhe zgjidhni "Refresh".

Këshillë

Marrësi shfaq shërbimin ose stacionin e fundit të zgjedhur kur funksioni ka ndryshuar në funksionin SEN, deri sa të fiket marrësi. Kur "Network Standby" është vendosur në "On", shfaqet shërbimi ose stacioni i fundit i zgjedhur edhe po të fikni marrësin.

Për të përdorur funksionin SEN me anë të telekomandës

Për	Veproni si më poshtë
Ndryshimin e stacionit ose shërbimit	Shtypni RETURN  për t'u kthyer tek lista e ofruesve të shërbimit dhe zgjidhni sërish shërbimin. Për t'u rikthyer në ekranin e riprodhimit, shtypni OPTIONS dhe zgjidhni "Now Playing".
Përdorimin e funksioneve të ndryshme gjatë kohës që marrësi zgjedh ose luan një stacion ose shërbim	Shtypni OPTIONS. Elementi i shfaqur mund të ndryshojë në varësi të elementit ose direktorisë së zgjedhur.
Zgjedhjen e opsioneve të shërbimit	Ndërkohë që zgjidhni ose luani përmbajtjen në shërbim, shtypni OPTIONS. Zgjidhni "Service Options" dhe shtypni  . Përmbajtja e opsioneve të shërbimit ndryshon sipas shërbimeve të zgjedhura.
Kërkimin e elementit që dëshironi duke përdorur një fjalë kyçe	Ndërkohë që zgjidhni përmbajtjen në server, shtypni ALPHABET SEARCH dhe shkruani një fjalë kyçe (faqe 75).


Për	Veproni si më poshtë
Shikimin e informacionit të disponueshëm	Shtypni vazhdimisht DISPLAY për të parë emrin e artistit, emrin e albumit, etj.

Paravendosja e stacioneve

Mund të ruani deri në 20 stacione si stacione të preferuara.

- Zgjidhni stacionin që dëshironi të caktoni si të paravendosur.**
- Gjatë marrjes, shtypni MEMORY.** Shfaqet lista e memories së stacioneve të paravendosura.
- Zgjidhni një numër për stacionin e paravendosur dhe shtypni (+).**
- Përsëritni hapat 1 deri 3 për të ruajtur një stacion tjetër.**

Për të dëgjuar stacionet e paravendosura

- Shtypni SEN.
Lista e ofruesve të shërbimit shfaqet në ekranin e televizorit. Nëse marrësi shfaq automatikisht stacionin e zgjedhur të fundit, shtypni vazhdimisht RETURN  derisa të shfaqet lista e ofruesve të shërbimit.

Këshillë

Mund dhe të zgjidhni "SEN" nga "Listen" në menyne kryesore.

- Zgjidhni "Preset" dhe shtypni (+). "Preset" shfaqet në krye të listës së ofruesve të shërbimit.
- Zgjidhni stacionin e paravendosur që dëshironi dhe më pas shtypni (+).

Shënim

Mund të ketë disa stacione që nuk mund të paravendosen, në varësit të ofruesit të shërbimit. Nëse përpiqeni të paravendosni një stacion, "Not available" shfaqet në ekran.

Shfrytëzimi i një larmie shërbimesh muzikore

Mund dëgjoni materiale nga një sërë shërbimesh muzikore të ofruara në internet.


Vizitoni uebsajtin për më shumë informacione rreth shërbimeve të muzikës, si të shijoni shërbimet dhe kodin e regjistrimit të marrësit.

<http://munlimited.com/home>

Kontrollin e kodit të regjistrimit

Mund t'ju kërkohet kod regjistrimi i marrësit për të hyrë në shërbime të reja muzikore.

- Shtypni SEN.

Lista e ofruesve të shërbimit shfaqet në ekranin e televizorit. Nëse marrësi shfaq automatikisht shërbimin ose stacionin e zgjedhur, shtypni vazhdimisht RETURN  derisa të shfaqet lista e ofruesve të shërbimit.

Këshillë

Mund dhe të zgjidhni "SEN" nga "Listen" në menyne kryesore.


- Zgjidhni "Registration Code" dhe shtypni (+).

Shfaqet kodi i regjistrimit të marrësit.

Përdorimi i funksionit PARTY STREAMING

Përmbajtjet audio që riprodhohen aktualisht në këtë marrës mund të riprodhohen te të gjitha pajisjet që i korrespondojnë njëkohësisht funksionit PARTY STREAMING në rrjetin e shtëpisë. Nëse ka një ndërprerje kur përdorni një lidhje me valë, lidhni marrësin me ruterin me një lidhje me kablo (faqe 35).

Gjatë PARTY streaming, një pajisje e quajtur "PARTY host" fillon një PARTY dhe transmeton muzikë dhe një pajisje e quajtur një "PARTY guest" bashkohet me një PARTY dhe merr muzikë nga "PARTY host". Përpara se të përdorni funksionin PARTY STREAMING, sigurohuni që "PARTY STREAMING" të jetë vendosur në "On" (faqe 96).



Mund të përdorni funksionin PARTY STREAMING me pajisje të tjera* që kanë simbolin PARTY STREAMING si më poshtë.



* Pajisje të disponueshme dhe pajtueshme PARTY STREAMING mund të ndryshojnë në varësi të shteteve ose rajoneve. Për hollësi rreth pajisjeve të disponueshme, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony-t.

Fillimi i një PARTY

Mund të filloni një PARTY në mënyrë që pajisjet e tjera që mbështesin funksionin PARTY STREAMING të mund të luajnë të njëjtën muzikë edhe nëse janë në dhoma të ndryshme.

1 Sigurohuni që pajisjet e ftuara në PARTY të jenë të ndezura dhe gati të bashkohen në PARTY.

2 Luani tingullin burimor që dëshironi.

Përbajtja audio e të gjithë tingujve burimorë në këtë marrës mund të transmetohet.

Shënime

- Vetëm përbajtja audio këtë marrës mund të transmetohet. Gjatë pritjes së PARTY, nuk dalin sinjale video në televizor dhe sinjalet audio do të shpërndahen në dy kanale. Në këtë rast, mund të zgjidhni vetëm "2ch Stereo" si fushë zanore.
- Kur filloni një PARTY si pritës PARTY, mund të keni një vonesë kohore mes daljes audio dhe paraqitjes vizuale në rastet e mëposhtme.
 - Përdoret funksioni i Audio Return Channel (ARC).
 - Dalja video e pajisjes është e lidhur me televizorin dhe dalja audio është e lidhur me foletë hyrëse audio dixhitale ose analoge në marrës.
- Burimet me mbrojtje të të drejtave të autorit mund të mos transmetohen.

3 Shtypni PARTY START.

Në ekranin e panelit shfaqet "START PARTY".

Marrësi e fillon PARTY duke transmetuar si pritës PARTY.

Për të mbyllur PARTY

Shtypni PARTY CLOSE.

Në panelin e ekranit shfaqet "CLOSE PARTY".

Hyrja në një PARTY

Marrësi mund të hyjë në një PARTY të filluar nga pajisje tjetër në mënyrë që të dëgjoni të njëjtat materiale audio siç luhen në dhoma të tjera.

Shtypni PARTY JOIN kur pajisja pritëse PARTY ka nisur PARTY.

Shfaqet "JOIN PARTY" dhe marrësi hyn në PARTY si kalimtar.

Për t'u larguar nga një PARTY

Shtypni PARTY LEAVE.

Sfaqet "LEAVE PARTY" dhe marrësi del nga PARTY.

Shënime


- Nuk mund të hyni në PARTY në rastet e mëposhtme:
 - keni një PARTY në këtë marrës.
 - jeni bashkuar tashmë me një PARTY tjetër.
- Nëse shtypni PARTY JOIN kur nuk ka filluar asnjë PARTY, por një pajisje luan konform me funksionin PARTY STREAMING, pajisja do të jetë pritëse e PARTY dhe marrësi do të bashkohet me PARTY si i ftuar i PARTY.
- Funksioni i pajisjes së ftuar PARTY ndizet automatikisht te HOME NETWORK kur pajisja bashkohet me një PARTY. Ndonëse pajisja e ftuar në PARTY largohet nga PARTY, funksioni vazhdon të mbetet si HOME NETWORK.

Këshillë

Nëse "Network Standby" është në "On", marrësi ndizet dhe bashkohet automatikisht në PARTY kur pajisja pritëse PARTY e fillon PARTY.

Shijon muzikë nga iTunes me AirPlay

Duke përdorur një rrjet me valë, mund të riprodhoni përmbajtje audio në pajisje iOS si p.sh. iPhone, iPod touch, iPad ose një iTunes Library në kompjuterin tuaj me këtë marrës.



Modelet e përputhshme të iPod/iPhone/iPad


iPhone 4S, iPhone 4, iPhone 3GS, iPod touch (2nd, 3rd ose 4th generation), iPad, iPad2, iPad 3rd generation me iOS 4.2 ose version të mëvonshëm dhe Mac ose PC me iTunes 10.1 ose version të mëvonshëm.

Shënime


- Referojuni "Modelet e përputhshme të iPod/iPhone/iPad" në këtë faqe për hollësi rreth versioneve të mbështetura të iOS ose iTunes.
- Përditësoni iOS ose iTunes në versionin më të fundit përpara se ta përdorni me marrësin.
- Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes tuaj për hollësi rreth pajisjeve vepruese iOS, iTunes ose AirPlay.
- Nuk mund ta përdorni marrësin si një pritës PARTY teksa përdorni funksionin AirPlay.

1 Prekni/shtypni ikonën djathtas poshtë ekranit të pajisjes iOS ose dritares iTunes.


[iOS device] (pajisje iOS)




[iTunes]



2 Zgjidhni "STR-DN1040" në menyën AirPlay të iTunes ose në pajisjen tuaj iOS. [iOS device] (pajisje iOS)



[iTunes]



3 Filloni të luani materiale audio në pajisje iOS ose në iTunes. AirPlay zgjidhet automatikisht si një funksion i marrësit.






Këshilla

- "*****" janë 6 shifrat e fundit të adresës MAC të marrësit.
- Nëse luajtja nuk fillon, kryeni sërish procesin nga hapi 1.

Për të konfirmuar/redaktuar emrin e pajisjes

Shihni "Device Name" (faqe 96) për udhëzime se si të riemërtoni pajisjen.

Për të kontrolluar luajtjen me AirPlay

Mund të përdorni butonat SHUFFLE dhe REPEAT  +/-, , , , . Veprimi nga marrësi dhe telekomanda është aktiv vetëm kur marrësi zgjidhet si pajisje dalëse.

Kur përdorni iTunes, caktoni një pajisje iOS për të pranuar kontrollin nga ky marrës dhe telekomandë kur doni ta përdorni marrësin dhe telekomandën për të kontrolluar një pajisje iOS.

Këshilla

- I jepet përparësi komandës më të fundit të marrësit. Marrësi fillon të riprodhojë materiale audio të një pajisjeje tjetër kur pranon kontrollin nga ajo pajisje AirPlay, ndonëse marrësi përdoret për AirPlay me pajisjen origjinale.
- Nga ky marrës mund të dalë tingull shumë i lartë kur vendosni e volumnin shumë lart duke përdorur pajisje iOS ose iTunes.
- Për hollësi për përdorimin e iTunes, referojuni Ndhmës së iTunes.
- Niveli i volumnit të pajisjeve iOS ose iTunes mund të mos jenë në gjendje të lidhet me nivelin e volumnit të marrësit.

Përditësimi i softuerit

Duke shkarkuar versionin më të fundit të softuerit, mund të përfitonit nga funksionet e fundit. Marrësi hyn në serverin Sony për të përditësuar softuerin. Nëse ka përditësim të ri, ndiqni udhëzimet në ekran për të përditësuar softuerin. Në panelin e ekranit shfaqet "UPDATE" kur jeni lidhur me internetin dhe kur përdorni funksionin Home Network ose SEN. Sigurohuni që pajisja tjetër e lidhur me marrësin të jetë ndalur përpara përditësimit të softuerit. Për hollësi rreth disponueshmërisë së softuerit, referojuni sajtit të shërbimit të klientit (faqe 120).

Shënime

- Sigurohuni të mos fikni marrësin, të mos shkëpusni kabllo e rrjetit ose të mos kryeni ndonjë veprim të marrësi teksa kryhet procesi i përditësimit.
- Nëse përpigëni të përditësoni softuerin kur Sleep Timer është aktiv, Sleep Timer do të çaktivizohet automatikisht.

1 Zgjidhni "Settings" nga menya kryesore dhe shtypni (+).

Lista e menysë "Settings" shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Zgjidhni "System" dhe shtypni (+).

3 Zgjidhni "Network Update" dhe shtypni (+).

4 Zgjidhni "Start" dhe shtypni (+).

Marrësi fillon kontrollin e përditësimit të disponueshëm të softuerit. Pasi të nisni përditësimin nuk mund ta rivendosni versionin e mëparshëm të softuerit.

Marrësi përfundon shkarkimin e softuerit kur në ekranin e televizorit shfaqet "Download 100%". Atëherë, marrësi nis përditësimin e softuerit. Ndërfaqja grafike dhe paneli i ekranit fiken automatikisht dhe treguesi I/⏏ (aktiv/në gatishmëri) në panelin e përparmë pulson ngadalë. Mund të duhen rreth 40 minuta deri në disa orë për përfundimin e përditësimit më të gjatë të mundshëm. Koha e kërkuar për përditësim luhetet në varësi të kushteve të përditësimit, si p.sh. shpejtësia e lidhjes së internetit etj. Me përfundimin e përditësimit, në panelin e ekranit shfaqet "COMPLETE" dhe marrësi rindizet automatikisht.

Shënim

Mos e shkëputni kordonin elektrik kur treguesi I/⏏ (aktiv/në gatishmëri) në panelin e përparmë pulson ngadalë.

Për të anuluar procedurën

Zgjidhni "Cancel" në hapin 4.

Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm

Shtypni RETURN ↵ përpara se marrësi të fillojë përditësimin e softuerit. Nuk mund të ktheheni në ekranin e mëparshëm kur fillon përditësimi.

Lista e mesazheve të funksioneve të rrjetit

Cilësimet e rrjetit

Mesazhi dhe shpjegimi

Invalid ■■■■*

Vlerat e dhëna janë të pasakta ose të pavlefshme.

* ■■■■ është SSID, adresë IP, kod sigurie, maskë nënrrjeti, portëkalim bazë, DNS kryesore ose DNS dytësore.

■■■■ mund të jetë i ndryshëm në varësi të konfigurimit të rrjetit.

Home Network

Mesazhi dhe shpjegimi

Cannot connect

Pajisja nuk mund të lidhet me serverin e zgjedhur.

Cannot get info

Marrësi nuk mund të gjejë informacione të serverit ose të materialeve.

Cannot JOIN

Marrësi nuk mund të hyjë në PARTY.

Cannot play

Marrësi nuk mund të luajë skedarë audio për shkak të mospërputhjes së formatit të skedarit ose të kufizimeve të luajtjes.

Cannot START

Marrësi nuk mund të nisë një PARTY.

Data Error

U përpoqët të luanit një skedar që nuk mund të luhet.

Device Full!

Nuk mund të regjistroni më pajisje në listën e pajisjeve.

Initialize

Marrësi po konfiguron funksionin Network sipas vlerave të fabrikës.

No server is available

Në rrjet nuk ka server me të cilin të lidhet marrësi. Përpiquni të freskoni listën e serverëve (faqe 64).

No Track

Në dosjen e zgjedhur nuk ka skedarë që mund të luhet.

Mesazhi dhe shpjegimi

Not Found

Në server nuk ka rezultate që të përkohjnë me fjalën e kërkuar.

Not in Use

Po kryhet një veprim që është i ndaluar për momentin.

SEN

Mesazhi dhe shpjegimi

Cannot connect

Pajisja nuk mund të lidhet me serverin e zgjedhur.

Cannot get info

Pajisja nuk mund të marrë materiale nga serveri.

Cannot play

- U përpoqët të luanit një skedar që nuk mund të luhet.
- Marrësi nuk mund të luajë një shërbim ose stacion për shkak të mospërputhjes së formatit të skedarit ose kufizimeve të riprodhimit.

Software update is required

Shërbimi nuk disponohet në versionin aktual të softuerit të marrësit.

Vizitoni faqen e mëposhtme për më shumë informacione rreth përditësimit të softuerit:

<http://munlimited.com/home>

No Preset

Në marrës nuk ka stacion të ruajtur për numrin e zgjedhur të paravendosur.

No service is available

Nuk ka ofrues të shërbimit.

No Stations Available

Në shërbimin e zgjedhur nuk ka stacion.

Not available


- Shërbimi i zgjedhur nuk disponohet.
- Po kryhet një veprim që nuk disponohet për momentin.

Not in Use

Po kryhet një veprim që është i ndaluar për momentin.

Kërkimi për artikujt të caktuar me anë fjalësh kyçe

Kur në ekranin e televizorit shfaqet një listë (si p.sh. listë artistësh, këngësh etj.), mund të jepni një fjalë kyçe për atë që kërkoni. Kërkimi në bazë të fjalëve kyçe disponohet kur është zgjedhur funksioni Home Network ose SEN.



1 Shtypni ALPHABET SEARCH kur ju shfaqet në ekranin e televizorit një listë artikujsh (listë artistësh, këngësh etj.).

Dritarja për shkrimin e fjalëve kyçe shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Shtypni butonat numerike/të tekstit për të shkruar fjalët kyçe.

Fjala kyçe mund të jetë deri në 15 germa.

Shënim

Vendosni një fjalë kyçe që përputhet me shkronjat ose një fjalë në fillim të emrit ose titullit të artikullit që dëshironi të kërkonti. Kur marrësi kërkon një artikull, "The" në fillim të emrit dhe hapësira pas saj nuk do të merren parasysh.

3 Shtypni (+).

Shfaqet një artikull që përputhet me fjalën kyçe. Nëse artikulli që shfaqet nuk është ai që po kërkonti, shtypni ALPHABET PREVIOUS/ALPHABET NEXT për të shfaqur artikullin e mëparshëm/tjetër.

4 Përsëritni hapat 1 deri 3 derisa të gjeni artikullin që dëshironi dhe shtypni (+).

5 Zgjidhni pjesën që dëshironi dhe shtypni (+).

Fillon riprodhimi.

Veçoritë e "BRAVIA" Sync

Çfarë është "BRAVIA" Sync?

Funksioni "BRAVIA" Sync lejon komunikimin mes produkteve Sony si p.sh. TV, luajtës Blu-ray Disc, luajtës DVD, amplifikator AV, etj. që mbështesin funksionin Control for HDMI. Duke lidhur me kablo HDMI (nuk jepet) pajisjet Sony që mbështesin "BRAVIA" Sync, komandimi thjeshtohet si më poshtë:

- One-Touch Play (faqe 77)
- System Audio Control (faqe 77)
- System Power-Off (faqe 78)
- Scene Select (faqe 78)
- Home Theatre Control (faqe 79)
- Remote Easy Control (faqe 79)

Control for HDMI është një standard për funksionin kontrolli reciprok i përdorur nga HDMI CEC (Consumer Electronics Control) për HDMI (High-Definition Multimedia Interface).


Rekomandojmë ta lidhni marrësin me produkte që kanë "BRAVIA" Sync.

Shënime

- Mund të përdorni funksionin "One Touch Play", "System Audio Control", dhe "System Power-Off" me pajisje jo Sony. Megjithatë, nuk garantohet mbështetja për të gjitha pajisjet jo Sony.
- Veçoritë "Scene Select" dhe "Home Theatre Control" janë funksione të Sony të regjistruara me patentë. Ato nuk punojnë me pajisje jo Sony.
- Pajisjet që nuk mbështesin "BRAVIA" Sync nuk mund t'i aktivizojnë këto funksione.
- Funksioni "Control for HDMI" nuk punon në pajisje të lidhura me folenë HDMI OUT B të marrësit.
- Disa prej veprimeve mund të mbështeten kur lidhni pajisje MHL (faqe 79).

Përgatitja për "BRAVIA" Sync

Caktoni individualisht funksionin "Control for HDMI" të marrësit dhe të pajisjeve të lidhura.



- 1 Zgjidhni "Settings" nga menyuja kryesore dhe më pas shtypni (+).
Lista e menyë "Settings" shfaqet në ekranin e televizorit.
- 2 Zgjidhni "HDMI" dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni "Control for HDMI" dhe shtypni (+).
- 4 Zgjidhni "On" dhe shtypni (+).
Funksioni "Control for HDMI" në marrës është caktuar si aktiv.
- 5 Shtypni HOME për të dalë nga menyuja e ndërfaqes GUI.
- 6 Zgjidhni hyrjen HDMI në marrës dhe në televizor që të përkojë me hyrjen HDMI të pajisjes së lidhur, në mënyrë që të shfaqet figura nga pajisja e lidhur.
- 7 Caktojini aktiv funksionin "Control for HDMI" të pajisjes së lidhur.
Për hollësi rreth konfigurimit të televizorit dhe të pajisjes së lidhur, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të pajisjes përkatëse.
- 8 Përsëritni hapin 6 dhe 7 për pajisjet e tjera që dëshironi të përdorni me funksionin "Control for HDMI".

Shënim

Kur hiqni kabllo HDMI ose kur ndryshoni lidhjen, kryeni hapat e mësipërm.

One-Touch Play

Kur nisni riprodhimin e pajisjes së lidhur me marrësin përmes lidhjes HDMI, marrësi dhe funksioni i televizorit thjeshtohen si më poshtë:

Marrës dhe televizor

Aktivizohet (nëse është në modalitet gatishmërie)



Kalon në hyrjen e përshtatshme HDMI

Nëse caktoni "Pass Through" në "On"* ose "Auto" (faqe 94), dhe marrësin në modalitet gatishmërie, zëri dhe figura mund të nxirren vetëm nga televizori.
* Vetëm për modelin e Australisë.

Shënime


- Sigurohuni që funksioni "System Audio Control" të jetë caktuar aktiv nga menyuja e televizorit.
- Kur luani nga pajisje të lidhura, televizori do të humbasë përkohësisht zërin dhe figurën.
- Në varësi të cilësimeve, marrësi mund të mos ndizet kur "Pass Through" caktohet në "On" ose "Auto".

Këshillë

Mund të zgjidhni gjithashtu pajisje të lidhur, si p.sh. luajtës disqesh Blu-ray, luajtës DVD nga menyuja e televizorit. Marrësi dhe televizori do të kalojnë automatikisht në daljen e duhur HDMI.

System Audio Control

Mund të dëgjoni zërin e televizorit nga pajisjet e lidhura me marrësin nëpërmjet një veprimi të thjeshtë.
Ju mund ta përdorni funksionin e System Audio Control përmes menyë së televizorit. Për hollësi, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të televizorit.



Mund të përdorni gjithashtu funksionin e kontrollit të sistemit audio si më poshtë.

- Nëse ndizni marrësin kur televizori është i ndezur, funksioni System Audio Control do të aktivizohet automatikisht për të nxjerrë tingullin e televizorit përmes altoparlantëve të lidhur me marrësin. Megjithatë, nëse e fikni marrësin, zëri do të nxirret nga altoparlantët e televizorit.
- Kur shijoni zërin nga televizori përmes altoparlantëve të lidhur me marrësin, mund të rregulloni volumin ose të fikni zërin përkohësisht duke përdorur telekomandën e televizorit.


Shënime

- Nëse funksioni "System Audio Control" nuk funksionon sipas cilësimeve të televizorit tuaj, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të televizorit.
- Kur "Control for HDMI" është caktuar në "On", cilësimet e "Audio Out" në menynë "HDMI Settings" do të caktohen automatikisht, sipas cilësimeve "System Audio Control" (faqe 94).
- Nëse televizori është ndezur përpara ndezjes së marrësit, televizori do të humbë për momentin daljen e zërit.

System Power-Off

Kur fikni televizorin me anë të butonit të energjisë në telekomandën e televizorit, marrësi dhe pajisja e lidhur fiken automatikisht.

Mund të përdorni gjithashtu telekomandën e marrësit për të fikur televizorin.



Shtypni "TV" dhe pastaj AV I/O.

Televizori, marrësi dhe pajisja e lidhur fiken.

Shënime

- Aktivizimi funksionin e bllokimit të ushqimit të televizorit me energji përpara se të përdorni funksionin Fikja e sistemit. Për hollësi, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të televizorit.
- Në varësi të kushteve të pajisjes së lidhur, ajo mund të mos fiken. Për hollësi, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve të lidhura.
- Nëse përdorni funksionin "System Power-Off" me televizor jo Sony, programoni telekomandën sipas prodhuesit të televizorit.

Scene Select

Cilësia optimale e figurës dhe fusha zanore zgjidhen automatikisht sipas skenës së zgjedhur në televizor.

Për hollësi rreth funksionimit, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të televizorit.

Shënim

Fusha zanore mund të mos ndryshojë në varësi të televizorit.

Tabela korresponduese

Kaktimi i skenës në televizor	Fusha zanore
Cinema	HD-D.C.S.
Sports	Sports
Music	Live Concert
Animation	A.F.D. Auto
Photo	A.F.D. Auto

Caktimi i skenës në televizor	Fusha zanore
Game	A.F.D. Auto
Graphics	A.F.D. Auto

Home Theatre Control

Nëse me marrësin lidhet televizor që mbështet "Home Theatre Control", në televizorin e lidhur shfaqet një ikonë për aplikacionet me bazë interneti. Mund të ndërroni hyrjen e marrësit ose të ndërroni fushat zanore me anë të telekomandës së televizorit. Mund të rregulloni gjithashtu nivelin e altoparlantit qendror ose të basit, ose të rregulloni cilësimet e "Sound Optimizer" (faqe 57), "Dual Mono" (faqe 93) ose "A/V Sync" (faqe 93).

Shënime

Për të përdorur funksionin "Home Theatre Control", televizori duhet të ketë mundësi të hyjë në shërbim me brez të gjerë. Për detaje, referojuni udhëzimeve të përdorimit të televizorit tuaj.

Remote Easy Control

Mund të përdorni telekomandën e televizorit për të përdorur menynë e marrësit. Për hollësi, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të televizorit.

Zgjidhni marrësin (AV AMP) e njohur nga televizori.

Shënime

- Marrësi njihet si "Tuner (AV AMP)" nga televizori.
- Televizori duhet të jetë i përputhshëm me menynë e lidhjes.
- Në varësi të llojit të televizorit, disa nga veprimet mund të mos disponohen.

Komandimi i pajisjes MHL

Me lidhjen e pajisjes MHL me kabllo MHL (nuk jepet), veprimi thjeshtohet si më poshtë:

- One-Touch Play (faqe 79)
- Remote Easy Control (faqe 79)


Shënime

- Ky funksion mundëson komunikimin me televizorë që mbështesin Sony "BRAVIA" Sync me anë kabllorje HDMI (nuk jepet).
- Ky funksion mund të mos punojë në varësi të pajisjes së lidhur MHL.
- Ky funksion mund të punojë vetëm kur
 - Marrësi është i ndezur.
 - "Control for HDMI" është caktuar në "On".
 - Pajisja MHL është lidhur nëpërmjet kabllorje MHL (nuk jepet) në fole të HDMI/MHL (VIDEO 2 IN) (faqe 31).

One-Touch Play

Marrësi kalon në hyrjen e duhur kur lidhet, luan etj. nga pajisja MHL.

Remote Easy Control



Veçoritë e "BRAVIA" Sync

Mund të përdorni butonat $\blacktriangle/\blacktriangledown/\blacktriangleleft/\blacktriangleright$, \oplus , RETURN \curvearrowright , OPTIONS, HOME*, \blacktriangleright , \mathbb{I} , \blacksquare , $\blacktriangleleft/\blacktriangleright$, $\blacktriangleleft/\blacktriangleright$ në telekomandë për të komanduar pajisjen MHL.


* Mbani shtypur HOME për të shfaqur menyën kryesore të pajisjes MHL.

Shënim

Sigurohuni të shtypni AMP përpara se të përdorni butonat për të komanduar pajisjen MHL.

Ndërrimi i monitorëve që nxjerrin sinjale video HDMI

Kur keni dy monitorë të lidhur me foletë HDMI OUT A dhe HDMI OUT B, mund ta ndërroni daljen e këtyre monitorëve me anë të butonit HDMI OUTPUT në telekomandë.



1 Ndizni marrësin dhe dy monitorët.

2 Shtypni HDMI OUTPUT.

Sa herë që shtypni butonin, dalja do të ndryshohet si më poshtë:
 HDMI A → HDMI B → HDMI A + B
 → HDMI OFF → HDMI A...

Shënime

- Nëse formati i mbështetur video ndryshon midis monitorëve të lidhur në fole të HDMI OUT A dhe fole të HDMI OUT B të marrësit, "HDMI A + B" mund të mos punojë.
- Në varësi të pajisjes luajtëse që lidhni, "HDMI A + B" mund të mos punojë.

Veprimet e tjera

Kalimi mes audios dixhitale dhe analoge (INPUT MODE)

Kur lidhni pajisje në foletë hyrëse të audios dixhitale dhe analoge në marrës, mund ta rregulloni modalitetin e hyrjes së audios në secilën prej tyre ose të kaloni nga njëra te tjetra, në varësi të llojit të materialit që doni të shikoni.

1 Shtypni butonat input për të zgjedhur hyrjen.

Mund dhe të aktivizoni INPUT SELECTOR te marrësi.

2 Shtypni vazhdimisht INPUT MODE për të zgjedhur modalitetin e hyrjes audio.

Mund të përdorni dhe INPUT MODE te marrësi.

Në panelin e ekranit shfaqet modaliteti i zgjedhur i hyrjes së audios.

- **AUTO:** U jep përparësi sinjaleve audio dixhitale. Nëse ka më shumë se një lidhje dixhitale, kanë përparësi sinjalet audio HDMI.

Nëse nuk ka sinjale dixhitale audio, zgjidhen sinjalet analoge audio.

Kur zgjidhni hyrjen e televizorit, prioritet u jepet sinjaleve të Audio Return Channel (ARC). Nëse televizori juaj nuk përshtatet me funksionin ARC, zgjidhen sinjalet dixhitale optike audio.

Nëse funksionet "Control for HDMI" të marrësit dhe të televizorit nuk janë të aktivizuara, funksioni ARC nuk funksionon.

- **COAX:** Përcakton hyrjen e sinjaleve dixhitale audio në fole të COAXIAL.
- **OPT:** Përcakton hyrjen e sinjaleve dixhitale audio në fole të OPTICAL.

- **ANALOG:** Përcakton hyrjen e sinjaleve analoge audio në foletë AUDIO IN (L/R).

Shënime

- Sipas hyrjes, shfaqet "-----" në panelin e ekranit dhe modalitetet e tjera nuk mund të zgjidhen.
- Kur përdoret "2ch Analog Direct" hyrja audio caktohet në "ANALOG". Nuk mund të zgjidhni modalitete të tjera.

Përdorimi i foleve të tjera hyrëse video/audio (Input Assign)

Mund të ricaktoni sinjalet video dhe/ose audio në foletë e tjera hyrëse.

Pasi të keni ricaktuar foletë hyrëse, mund të përdorni butonin e hyrjes (ose INPUT SELECTOR në marrës) për të zgjedhur pajisjen që keni lidhur.

Caktimi i hyrjeve video Component dhe audio dixhitale

Mund të ricaktoni foletë e hyrjes COMPONENT VIDEO dhe DIGITAL në hyrje tjetër nëse cilësimet e parazgjedhura të foleve nuk përkojnë me pajisjet e lidhura.

Shembull:

Kur lidhni luajtësin e DVD-ve në foletë OPTICAL IN 1 (SAT/CATV) dhe COMPONENT VIDEO IN 1 (SAT/CATV).

- Caktoni folenë OPTICAL IN 1 (SAT/CATV) te "DVD".
- Caktoni foletë COMPONENT VIDEO IN 1 (SAT/CATV) te "DVD".

1 Zgjidhni "Settings" nga menyuja kryesore dhe më pas shtypni (+).

Lista e menyës "Settings" shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Zgjidhni "Input" dhe shtypni (+).

3 Zgjidhni emrin e hyrjes që dëshironi të caktoni dhe shtypni (+).

4 Shtypni vazhdimisht ⇄ për të zgjedhur "COMPONENT" ose "OPT/COAX".

5 Shtypni vazhdimisht ↑/↓ për të zgjedhur folenë që doni të caktoni dhe shtypni (+).

Emri i hyrjes		BD	DVD	GAME	SAT/ CATV	VIDEO 1	VIDEO 2	VIDEO 3	SA-CD/ CD
Foletë e caktueshme për hyrjen video	IN2	○	○*	○	○	○	○	○	○
	IN1	○	○	○	○*	○	○	○	○
	Asnjë	○*	○	○*	○	○*	○*	○*	○*
Foletë e caktueshme për hyrjen audio	OPT 2	○	○	○	○	○	○	○	○
	OPT 1	○	○	○	○*	○	○	○	○
	COAX	○	○*	○	○	○	○	○	○
	Asnjë	○*	○	○*	○	○*	○*	○*	○*

* Cilësimi i parazgjedhur

Shënime

- Kur caktoni hyrjen dixhitale audio, cilësimi "INPUT MODE" mund të ndryshojë automatikisht.
- Lejohet një ricaktim për secilën hyrje.

Përdorimi i një lidhjeje me dy amplifikatorë

- Zgjidhni "Settings" nga menyuja kryesore dhe më pas shtypni (+).**
Lista e menysë "Settings" shfaqet në ekranin e televizorit.
- Zgjidhni "Speaker" dhe shtypni (+).**
- Zgjidhni "Speaker Connection" dhe shtypni (+).**
- Zgjidhni motivin e duhur të altoparlantëve në mënyrë që të mos ketë altoparlantë rrethues të pasmë dhe altoparlantë të lartë të përparmë, më pas shtypni (+).**
- Zgjidhni "Bi-Amplifier Connection" dhe shtypni (+).**
Të njëjtat sinjale që dalin nga терминалет SPEAKERS FRONT A mund të dalin nga терминалет SPEAKERS SURROUND BACK/BI-AMP/FRONT HIGH/FRONT B.

6 Shtypni (+) për të ruajtur përzgjedhjen.

Për të dalë nga menyuja

Shtypni HOME.

Shënime

- Zgjidhni "Bi-Amplifier Connection" përpara se të kryeni "Auto Calibration".
- Nëse zgjidhni "Bi-Amplifier Connection", niveli i altoparlantëve dhe cilësimet e distancës së altoparlantëve rrethues të pasmë dhe të altoparlantëve të lartë të përparmë bëhen të pavlefshme dhe përdoren ato të altoparlantëve të përparmë.

Përdorimi i funksioneve shumëzonëshe

Mund të merrni audio nga pajisja e lidhur me marrësin në zonë të ndryshme nga zona kryesore. Për shembull, mund të shikoni DVD në zonën kryesore dhe të dëgjoni CD në zonën 2.

Kur përdorni repetitor IR (nuk jepet), mund të komandoni të dyja pajisjet në zonën kryesore dhe marrësin Sony në zonën 2 nga zona 2.


Për të komanduar marrësin nga zona 2

Marrësin mund ta komandoni pa e drejtuar telekomandën drejt marrësit nëse lidhni repetitor infrakuq (nuk jepet) në fletën IR REMOTE.

Përdorni repetitor IR kur instaloni marrësin në vende ku nuk arrijnë sinjalet nga telekomanda.

Kryerja e një lidhjeje zone 2


Nxjerr zërin nga altoparantët në zonën 2 me anë të marrësit dhe një amplifikatori tjetër.



- A** Pajisjet audio
- B** Repetitor infrakuq (nuk jepet)
- C** Altoparantët
- D** Sony Amplifikator/Marrës

Komandimi i marrësit nga zona 2

Veprimet e mëposhtme përshkruhen për lidhjen e repetitorit infrakuq dhe komandimin e marrësit në zonën 2. Kur nuk ka repetitor infrakuq të lidhur, përdoreni marrësin në zonën kryesore.



- 1 Ndizni marrësin kryesor (këtë marrës).**
- 2 Ndizni marrësin në zonën 2.**
- 3 Shtypni ZONE.**
Telekomanda kalon në zonën 2.
- 4 Shtypni I/⏻.**
Aktivizohet funksioni i zonës.
- 5 Shtypni butonat hyrës për të zgjedhur burimin sipas dëshirës.**
- 6 Rregullojeni në volum të përshtatshëm me anë të marrësit në zonën 2.**

Veprimet e mundshme të zonës 2

INPUT	ZONE 2 ¹⁾
BD	-
DVD	-
GAME	-
SAT/CATV ²⁾	○
VIDEO 1 ²⁾	○
VIDEO 2	-

INPUT	ZONE 2 ¹⁾
VIDEO 3	-
TV	-
SA-CD/CD	○
FM ³⁾	○
AM ³⁾	○
USB	-
HOME NETWORK	-
SEN	-
SOURCE	○

- ¹⁾ Për zonën 2, nxirren vetëm sinjale audio analoge.
- ²⁾ Vetëm kur zgjidhet SOURCE nxirren sinjalet që hyjnë aktualisht në zonën kryesore.
- ³⁾ Mund të zgjidhni ose "FM" ose "AM" nga zona kryesore dhe nga zona 2. Përparësi ka zgjedhja që është zgjedhur më së fundi, edhe nëse ka pasur zgjedhje tjetër në njërin prej zonave.

Për të dalë nga komandimi në zonën 2


Shtypni ZONE dhe shtypni I/⏻.

Këshilla

- Edhe nëse ky marrës është në gjendje gatishmërie (shtypni I/⏻ në telekomandë për ta fikur marrësin), marrësi në zonën 2 mbetet i ndezur.
- Kur marrësi është në modalitetin e gatishmërisë, treguesi I/⏻ (ndezur/në gatishmëri) në panelin e përparmë ndizet në ngjyrë tulle nëse ndizet marrësi në zonën 2.
- Funksioni "AirPlay" disponohet vetëm në zonën kryesore.

Kthimi në cilësimet e parazgjedhura të fabrikës

Mund të pastroni të gjitha cilësimet e memorizuara dhe ta ktheni marrësin në cilësimet e parazgjedhura të fabrikës duke kryer procedurën e mëposhtme. Kjo procedurë mund të përdoret gjithashtu për ta nisur marrësin, përpara se ta përdorni për herë të parë. Sigurohuni të përdorni butonat në marrësi për të kryer këtë veprim.



- 1 Shtypni I/⏻ për të fikur marrësin.
- 2 Mbani shtypur I/⏻ për 5 sekonda.

Në panelin e ekranit shfaqet "CLEARING" për pak kohë, më pas ajo bëhet "CLEARED!". Ndryshimet ose përshtatjet që u janë bërë cilësimeve, tani rikthehen në cilësimet e parazgjedhura.


Shënim

Pastrimi i plotë i memories zgjat pak minuta. Mos e fikni marrësin derisa në ekran të shfaqet "CLEARED!".


Rregullimi i cilësimeve

Përdorimi i menysë "Settings"

Mund të rregulloni cilësimet e ndryshme për altoparlantët, efektet rrethuese, etj. me anë të menysë së Settings.




- 1 Shtypni AMP dhe shtypni HOME. Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.




2 Zgjidhni "Settings" dhe shtypni (+) për të hyrë në modalitetin e menysë.

Lista e menysë "Settings" shfaqet në ekranin e televizorit.



3 Zgjidhni elementin e menysë që dëshironi dhe shtypni (+).

Shembull: Kur zgjidhni "Speaker".



4 Zgjidhni parametrin që dëshironi dhe shtypni (+).


Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm


Shtypni RETURN ↶.

Për të dalë nga menya

Shtypni HOME për të shfaqur menyën kryesore dhe më pas shtypni përsëri HOME.

Lista e menysë Settings





Shënim

Parametrat e mënyës të shfaqura në ekranin e televizorit ndryshojnë në varësi të cilësimeve aktuale ose të statusit të ikonës së zgjedhur.

Easy Setup

Riekzekuton Easy Setup për të kryer cilësimet bazë. Ndiqni udhëzimet në ekran (faqe 42).

- 1 Ndiqni udhëzimet në ekranin e televizorit dhe shtypni \oplus për të zgjedhur "Start".

Matja fillon pas pesë sekondash. Procesi i matjes do të zgjasë afro 30 sekonda me një sinjal testimi. Kur të përfundojë matja, do të dëgjohet një sinjal bip dhe ekrani do të ndryshojë.

Menyja "Speaker Settings"

Mund ta rregulloni manualisht çdo altoparlant.

Mund të rregulloni gjithashtu nivelet e altoparlantit pasi të ketë përfunduar "Auto Calibration".

Shënim

Cilësimet e altoparlantit janë vetëm për pozicionin aktual të ndenjes.

■ Auto Calibration

Mundëson kryerjen e kalibrimit automatik automatikisht nga pozicioni juaj i ndenjes.

Shënim

Nëse në ekran shfaqet kod gabimi ose mesazh paralajmërues, shikoni "Lista e mesazheve pas matjes së "Auto Calibration"" (faqe 89).

- 2 Zgjidhni artikullin që dëshironi dhe shtypni \oplus .

- **Save:** Ruan rezultatet e matjes dhe del nga procesi i konfigurimit.
- **Retry:** Kryen përsëri "Auto Calibration".
- **Discard:** Del nga procesi i konfigurimit pa i ruajtur rezultatet e matjes.

- 3 Ruani rezultatit e matjes.

Zgjidhni "Save" në hapin 2.

Shënim

Nëse ndryshoni përsëri pozicionin e altoparlantit, rekomandojmë që të kryeni përsëri "Auto Calibration" për audio rrethuese.

Këshilla

- Ju mund ta ndryshoni njësinë e distancës në "Distance Unit" në menynë Speaker Settings (faqe 92).
- Madhësia e një altoparlanti ("Large"/"Small") përcaktohet nga karakteristikat e frekuencës së ulët. Rezultatet e matjes mund të ndryshojnë, në varësi të pozicionit të mikrofonit të optimizuesit dhe altoparlantëve, si dhe formës së dhomës. Rekomandohet që të zbatoni rezultatet e matjes. Sidoqoftë, ju mund t'i ndryshoni ato cilësimet në menynë Speaker Settings. Ruani rezultatet e matjes në fillim dhe më pas provoni të ndryshoni cilësimet.

Për të kontrolluar rezultatet e "Auto Calibration"

Për të kontrolluar kodin e gabimit me mesazhin paralajmërues të marrë në "Auto Calibration" (faqe 89), ndiqni hapat e mëposhtëm.

Kur shfaqet kod gabimi

Kontrolloni gabimin dhe kryeni përsëri "Auto Calibration".

- 1 Zgjidhni "Retry" dhe shtypni (+).
- 2 Përsëritni hapat 1 deri 3 në "Auto Calibration" (faqe 88).

- Shtypni  për të anuluar funksionin e heshtjes.
- Proveni të shtypni butonin e hyrjes në telekomandë ose të rrotulloni INPUT SELECTOR në marrës për të zgjedhur pajisjen që preferoni (faqe 44).

- Kur dëshironi të dëgjoni zërin nga altoparlanti i televizorit, caktoni "HDMI Audio Out" në "TV+AMP" në menynë "HDMI Settings" (faqe 94). Nëse nuk mund të luani burimin e audios shumëkanalëshe, caktojeni në "AMP". Sidoqoftë, zëri nuk do të dalë përmes altoparllantit të televizorit.
- Zëri mund të ndërpritet nëse ndërrohet frekuenca e modulimit, numri i kanaleve ose formati audio i sinjaleve audio që dalin nga pajisja luajtëse.

Ka gumëzhitje ose zhurmë të madhe.

- Kontrolloni që altoparllantët dhe pajisjet të jenë lidhur mirë.
- Kontrolloni që kabllot e lidhjes të jenë larg transformatorëve a motorëve dhe së paku 3 metra larg televizorëve apo llambave fluoreshente.
- Lëvizeni pajisjen audio larg televizorit.
- Fishat dhe foletë janë të papastra. Fshijini me një copë të lyer paksa me alkool.

Nga altoparllantët specifike nuk del zë ose dëgjohe vetë një zë shumë i ulët.

- Lidhni një palë kufje me folenë PHONES për të verifikuar që nga kufjet del zë. Nëse nga kufjet del vetëm një kanal, pajisja mund të mos jetë lidhur saktë me marrësin. Kontrolloni që të gjithë kordonët të jetë futur plotësisht në marrës dhe në pajisje. Nëse nga kufjet dalin të dy kanalet, altoparlanti i përparmë mund të mos jetë lidhur saktë me marrësin. Kontrolloni lidhjen e altoparllantit të përparmë që nuk nxjerr zë.
- Sigurohuni që ta keni lidhur me të dyja foletë L dhe R të një pajisjeje analoge, pajisja analoge kërkon të dyja lidhjet L dhe R. Përdorni një kordon audio (nuk jepet).
- Rregulloni nivelin e altoparllantit (faqe 90).

- Kontrolloni nëse cilësimet e altoparlantëve janë të duhurat për konfigurimin me anë të "Auto Calibration" ose "Speaker Connection" në menynë "Speaker Settings". Në vijim kontrolloni nëse zëri del si duhet nga çdo altoparlant, me anë të "Test Tone" në menynë e "Speaker Settings".
- Disa disqe nuk kanë asnjë informacion Dolby Digital Surround EX.
- Kontrolloni nëse nën-vuferi është lidhur mirë dhe saktë.
- Sigurohuni që e keni ndezur nën-vuferin.
- Në varësi të fushës së zgjedhur zanore, nuk do të ketë një zë të disponueshëm nga nën-vuferi.
- Kur të gjithë altoparlantët të jenë vendosur në "Large" dhe "Neo:6 Cinema" ose "Neo:6 Music" të jetë e zgjedhur, nga nën-vuferi nuk do të ketë zë.
- Sinjalet audio (formati, frekuenca e modulimit, numri i bitëve etj.) që transmetohen nga një fole HDMI mund të kompresohen nga pajisja e lidhur. Kontrolloni konfigurimin e pajisjes së lidhur nëse cilësia e figurës është e dobët ose nëse zëri nuk del fare nga pajisja e lidhur nëpërmjet kablos HDMI.
- Kur pajisja e lidhur nuk përputhet me teknologjinë mbrojtëse për të drejtat e autorit (HDCP), figura dhe/ose zëri që del nga foleja HDMI TV OUT mund të deformohet ose mund të mos dalë fare. Në raste të tilla, verifikoni specifikimet e pajisjes së lidhur.
- Vendoseni rezolucionin e figurës së pajisjes së riprodhimit në më shumë se 720p/1080i për të shijuar High Bitrate Audio (DTS-HD Master Audio, Dolby TrueHD).
- Rezolucioni i figurës i pajisjes së riprodhimit mund të ketë nevojë të vendoset në disa cilësime të caktuara përpara se të shijoni DSD dhe PCM lineare shumëkanalëshe. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve të riprodhimit.

Një pajisje specifike nuk lëshon zë.

- Kontrolloni që pajisja të jetë lidhur saktë me foletë e hyrjes audio për atë pajisje.
- Kontrolloni që kabllot e përdorura për lidhjen të jenë futur plotësisht në marrës dhe në pajisje.
- Kontrolloni "INPUT MODE" (faqe 80).
- Kontrolloni që pajisja të jetë lidhur saktë me folenë HDMI për atë pajisje.
- Në varësi të llojit të pajisjes së riprodhimit, mund të jetë e nevojshme të konfiguroni cilësimet HDMI të pajisjes. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me çdo pajisje.
- Sigurohuni të përdorni kablo HDMI të shpejtësisë së lartë për materialet audiovizuale, sidomos për transmetime 1080p, Deep Color (Deep Colour), 4K ose 3D.
- Nga marrësi mund të mos dalë fare zë kur në ekranin e televizorit shfaqet ndërfaqja GUI. Shtypni HOME për ta çaktivizuar ndërfaqen GUI.
- Nëse televizori nuk e ka funksionin "System Audio Control", caktojini cilësimet e "Audio Out" në menynë "HDMI Settings" në
 - "TV+AMP" nëse dëshironi ta dëgjoni zërin nga altoparlanti i televizorit dhe nga marrësi.
 - "AMP" nëse dëshironi që ta dëgjoni zërin nga marrësi.
- Kur e lidhni marrësin me pajisje videoje (projektor etj.), mund të mos dalë audio nga marrësi. Në raste të tilla, caktojini "Audio Out" te "AMP" në menynë "HDMI Settings" (faqe 94).
- Nuk mund ta dëgjoni zërin e pajisjes së lidhur me marrësin, nëse në marrës është zgjedhur hyrja e televizorit.

- Sigurohuni që ta ndryshoni hyrjen e marrësit të HDMI kur dëshironi të shikoni një program në pajisjen e lidhur me marrësin nëpërmjet lidhjes HDMI.
- Ndryshoni kanalën e televizorit kur dëshironi të shikoni një transmetim televiziv.
- Sigurohuni të zgjidhni burimin e saktë të hyrjes ose pajisjen që dëshironi kur shikoni një program nga një pajisje të lidhur me televizorin. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të televizorit për këtë veprim.
- Kur përdoret "2ch Analog Direct" nuk ka dalje të zërit. Përdorni fushë tjetër zanore (faqe 53).
- Kur përdorni funksionin Control for HDMI (Kontrolli për HDMI), nuk mund të komandoni pajisjen e lidhur me anë të telekomandës së televizorit.
 - Në varësi nga pajisja e lidhur dhe televizori, mund të nevojitet konfigurimi i pajisjes dhe i televizorit. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me secilën pajisje dhe televizor.
 - Ndryshoni burimin e hyrjes së marrësit të hyrja HDMI e lidhur me pajisjen.
- Kontrolloni që fisha e zgjedhur e hyrjes së audios dixhitale nuk u është caktuar hyrjeve të tjera (faqe 81).

Zëri majtas dhe djathtas nuk është i ekuilibruar ose është në të kundërt.

- Kontrolloni që altoparlantët dhe pajisjet të jenë lidhur saktë dhe mirë.
- Rregulloni parametrat e nivelit të zërit me anë të menyse së Cilësimeve të altoparlantit.

Tingulli shumëkanalësh Dolby Digital ose DTS nuk riprodhohet.

- Verifikoni nëse DVD-ja etj. që po luani është e regjistruar në formatin Dolby Digital ose DTS.
- Kur lidhni luajtësin DVD etj., në foletë e hyrjes dixhitale të këtij marrësi, sigurohuni që cilësimi i daljes së audios dixhitale i pajisjes së lidhur të jetë i disponueshëm.

- Caktojini "Audio Out" të "AMP" në menyne "HDMI Settings" (faqe 94).
- Audio me shpejtësi të lartë të bitëve (DTS-HD Master Audio, Dolby TrueHD), DSD dhe PCM lineare shumëkanalëshe mund të dëgjoni vetëm me lidhje HDMI.

Nuk arrihet efekti i audios rrethuese.

- Sigurohuni që të keni zgjedhur fushën zanore për filma ose muzikë (faqe 53).
- Fushat zanore nuk funksionojnë kur merren DTS-HD Master Audio, DTS-HD High Resolution Audio ose Dolby TrueHD me një frekuencë modulimi me më shumë se 48 kHz.

Nga altoparlantët nuk ka dalje të tingullit të testimit.

- Kabllot e altoparlantëve mund të mos jenë lidhur mirë. Kontrolloni për të parë nëse ato janë lidhur mirë dhe nuk mund të shkëputen nëse tërhiqen lehtë.
- Kabllot e altoparlantëve mund të kenë problem lidhjeje me qark të shkurtër.
- Sigurohuni që nuk jeni duke përdorur funksionin PARTY STREAMING (faqe 70).

Sinjali i testimit del nga një altoparlant tjetër i ndryshëm nga ai i treguar në ekranin e televizorit.

- Konfigurimi i motivit të altoparlantëve nuk është i saktë. Sigurohuni që ka një përputhje të saktë të lidhjeve të altoparlantëve dhe motivit të tyre.

Kur marrësi është në modalitet gatishmërie, nuk ka dalje të zërit nga televizori.

- Kur marrësi hyn në modalitetin të gatishmërisë, zëri është nga pajisja e fundit HDMI e zgjedhur para se të fiknit marrësin. Nëse po përdorni një pajisje tjetër, luani pajisjen dhe kryeni veprimin "One-Touch Play" (luajtje me një prekje) ose ndizni marrësin për të zgjedhur pajisjen HDMI që dëshironi të përdorni.

- (Vetëm për modelin e Australisë) Sigurohuni që "Pass Through" të jetë çaktuar në "On" në menyën "HDMI Settings" nëse lidhni pajisje që nuk mbështet "BRAVIA" Sync te marrësi (faqe 94).

Ka njëfarë intervali kohor midis daljes së zërit dhe figurës.


- Kontrolloni që funksioni PARTY STREAMING të mos jetë në përdorim. Për të mbyllur një PARTY, shtypni PARTY START/CLOSE, derisa të shfaqet "CLOSE PARTY". Për hollësi, shihni faqe 71.

Sintonizuesi

Marrja e sinjalit FM është e dobët.

- Përdorni kabllo koaksiale 75-om (nuk jepet) për të lidhur marrësin me një antenë FM të jashtme (ajrore) siç tregohet më poshtë.

Antena FM e jashtme (ajrore)



Stacionet e radios nuk mund të sintonizohen.

- Kontrolloni që antenat (ajrore) të jenë lidhur mirë. Rregulloni antenat (ajrore) dhe lidhni një antenë të jashtme (ajrore) nëse është e nevojshme.
- Forca e sinjalit të stacioneve është tepër e dobët me sintonizimin automatik. Përdorni sintonizimin direkt.
- Sigurohuni që të vendosni saktë shkallën e sintonizimit (kur sintonizoni stacionet AM me sintonizim direkt) (faqe 52).

- Nuk është vendosur asnjë stacion ose stacionet e paravendosura janë fshirë (kur përdoret sintonizimi duke skanuar stacionet e paravendosura). Bëni vendosjen e stacioneve të paracaktuara (faqe 52).
- Shtypni AMP dhe shtypni DISPLAY vazhdimisht në telekomandë në mënyrë që frekuenca të shfaqet në panelin e ekranit.

RDS nuk funksionon.


- Sigurohuni që jeni të sintonizuar në kanal FM RDS.
- Zgjidhni një stacion më të fortë FM.
- Stacioni ku jeni sintonizuar nuk e transmeton sinjalin RDS ose fuqia e sinjalit është e dobët.

Informacioni RDS që dëshironi nuk shfaqet.

- Shërbimi mund të jetë përkohësisht jashtë shërbimit. Kontaktoni me stacionin e radios dhe informohuni nëse e ofrojnë në të vërtetë shërbimin në fjalë.

iPod/iPhone

Zëri ka distorsion.

- Shtypni vazhdimisht  në telekomandë. Mund të përdorni gjithashtu MASTER VOLUME te marrësi.
- Caktojeni cilësimin "EQ" të iPod/iPhone në "Off" ose "Flat".

Nuk ka dalje të zërit nga iPod/iPhone.

- Shkëputeni iPod/iPhone dhe lidhni përsëri pajisjen iPod/iPhone.

iPod/iPhone nuk mund të ngarkohet.

- Kontrolloni nëse marrësi është i ndezur.
- Sigurohuni që iPod/iPhone është lidhur mirë.

iPod/iPhone nuk mund të përdoret.

- Kontrolloni nëse e keni hequr kasën mbrojtëse të iPod/iPhone.
- Në varësi të përmbajtjes së iPod/iPhone, mund të duhet pak kohë derisa të fillojë luajtja.
- Fikeni marrësin dhe pastaj shkëputni pajisjen iPod/iPhone. Ndizeni përsëri marrësin dhe pastaj rilidhni pajisjen iPod/iPhone.
- Po përdorni një iPod/iPhone që nuk mbështetet. Shihni "Modelet e përputhshme të iPod/iPhone" (faqe 46) për llojet e pajisjeve që mbështeten.

Volumi i zileve të iPhone nuk ndryshohet.

- Rregullojeni volumin e ziles me anë të komandave në iPhone.

Pajisja USB

Po përdorni një pajisje të mbështetur USB?

- Nëse lidhni një pajisje të pambështetur USB, mund të ndodhin problemet e mëposhtme. Shihni "Pajisjet USB të pajtueshme" (faqe 48) për llojet e pajisjeve që mbështeten.
 - Pajisja USB nuk njihet.
 - Emrat e skedarëve ose të dosjeve nuk shfaqen në këtë marrës.
 - Riprodhimi nuk është i mundur.
 - Tingulli kapërcehet.
 - Ka zhurmë.
 - Zëri del i shtrembëruar.

Ka zhurmë, zëri kapërcehet ose është i shtrembëruar.

- Fikeni marrësin dhe pastaj rilidhni pajisjen USB, dhe më pas ndizeni marrësin.
- Vetë të dhënat e muzikës kanë zhurmë ose zëri është i shtrembëruar.

Pajisja USB nuk njihet.

- Fikeni marrësin dhe pastaj shkëputni pajisjen USB. Ndizeni përsëri marrësin dhe pastaj rilidhni pajisjen USB.

- Lidhni pajisjen e mbështetur USB (faqe 48).
- Pajisja USB nuk punon si duhet. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB për mënyrat sesi ta zgjidhni këtë problem.

Riprodhimi nuk fillon.

- Fikeni marrësin dhe pastaj rilidhni pajisjen USB, dhe më pas ndizeni marrësin.
- Lidhni pajisjen e mbështetur USB (faqe 48).
- Shtypni ► për të nisur riprodhimin.

Pajisja USB nuk mund të lidhet me portën ψ (USB).

- Pajisja USB është lidhur mbrapsht. Lidhni pajisjen USB në drejtimin e duhur.

Afishim i gabuar.

- Të dhënat e ruajtura në pajisjen USB mund të jenë të dëmtuara.
- Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky marrës janë si më poshtë:
 - Shkronjat e mëdha (A deri në Z)
 - Shkronjat e vogla (a deri në z)
 - Numrat (0 deri në 9)
 - Simbolet (' = < > * + , - . / @ [\] _ ')Karakteret e tjera mund të mos shfaqen saktë.

"Reading" shfaqet për një kohë pak të gjatë ose duhet një kohë e gjatë para se të nisë riprodhimi.

- Procesi i leximit mund të kërkojë një kohë të gjatë në rastet e mëposhtme.
 - Ka shumë dosje ose skedarë në pajisjen USB.
 - Kur struktura e skedarëve është jashtëzakonisht e ndërlikuar.
 - Kur kapaciteti i memories është shumë i madh.
 - Kur memoria e brendshme është e fragmentuar.

Për këtë arsye rekomandojmë të ndiqni këto udhëzime.

- Dosjet në total në pajisjen USB: 256 ose më pak (duke përfshirë dosjen "ROOT")
- Nr. total i skedarëve për dosje: 256 ose më pak.

Skedari audio nuk mund të riprodhohet.

- Skedarët MP3 në formatin MP3 PRO nuk mund të riprodhohen.
- Skedari audio është një skedar audio me shumë pjesë.
- Disa skedarë AAC nuk mund të riprodhohen si duhet.
- Skedarët WMA në formatin Windows Media Audio Lossless dhe Professional nuk mund të luhen.
- Pajisjet USB të formatuara me sisteme skedarësh të ndryshme nga FAT16 ose FAT32 nuk mbështeten.*
- Nëse përdorni një pajisje USB të ndarë në disa particione, mund të luhen vetëm skedarët audio në ndarjen e parë.
- Luajtja është e mundur deri në 8 nivele (përfshirë dosjen "ROOT").
- Numri i dosjeve i ka kaluar 256 (përfshirë dosjen "ROOT").
- Numri i skedarëve brenda një dosjeje i ka kaluar 256.
- Skedarët e enkriptuar ose të mbrojtur me fjalëkalime, etj. nuk mund të luhen.

* Kjo njësi mbështet FAT16 dhe FAT32, por disa pajisje USB mund të mos i mbështetin të gjitha këto FAT. Për hollësi, drejttojuni udhëzimeve të përdorimit të çdo pajisjeje USB ose kontaktoni me prodhuesin.

Lidhja me rrjetin

Nuk mund të lidhet me WPS përmes lidhjeje rrjeti LAN me valë.

- Nuk mund të lidheni me një rrjet duke përdorur WPS kur pika e hyrjes është caktuar në WEP. Konfiguroni rrjetin pasi të kërkonti pikën e aksesit duke përdorur skanimin e pikës së aksesit.

Shfaqet një mesazh gabimi.

- Kontrolloni natyrën e gabimit. Shihni "Lista e mesazheve të funksioneve të rrjetit" (faqe 74).

Nuk mund të lidhet me rrjetin.

- Kontrolloni gjendjen e rrjetit. Shihni "Connection Status" te "Information" në menyën "Network Settings" (faqe 96). Nëse shfaqet "Not connected", konfiguroni sërish lidhjen e rrjetit (faqe 38).
- Kur sistemi lidhet me rrjet me valë, lëvizni marrësin dhe rrugëzuesin e rrjetit LAN me valë/pikën e hyrjes më pranë njëra-tjetrës dhe kryeni sërish konfigurimin.
- Kontrolloni cilësimet e ruterit LAN me valë/pikës së aksesit dhe kryeni konfigurimin sërish. Për hollësi rreth cilësimeve të pajisjeve, drejttojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve.
- Sigurohuni që të përdorni një ruter LAN-i me valë/pikë aksesi.
- Rrjetet me valë influencohen nga rrezatimi elektromagnetik i emetuar nga furrat me mikrovalë dhe pajisjet e tjera. Lëvizni njësinë larg këtyre pajisjeve.
- Sigurohuni që ruteri LAN me valë/pikë aksesi të jetë ndezur.

Nuk mund të kontrolloni marrësin duke përdorur pajisjen TV SideView.

- Marrësi mund të kërkojë shumë kohë për t'u lidhur me rrjetin pasi ndizni marrësin. Pritni për pak çaste, pastaj provoni të përdorni përsëri TV SideView.
- Sigurohuni që "Network Standby" të jetë vendosur në "On" në menyën e Cilësimeve të rrjetit në mënyrë që të mund të përdorni TV SideView menjëherë pasi të keni ndezur marrësin.

Nuk mund të zgjidhni menyën e Cilësimeve të rrjetit.

- Prisni pak momente pasi të ndizni marrësin, dhe më pas zgjidhni sërish menyën e Cilësimeve të rrjetit.

Nuk mund të lidhet me rrjetin.

- Sigurohuni që ruteri LAN me valë/pikë aksesit të jetë ndezur.
- Sigurohuni që serveri është i ndezur.
- Cilësimet e rrjetit në marrës mund të jenë kryer në mënyrë të pasaktë. Kontrolloni gjendjen e rrjetit. Shihni "Connection Status" te "Information" në menynë "Network Settings" (faqe 96). Nëse shfaqet "Not connected", konfigurujeni sërish lidhjen e rrjetit (faqe 38).
- Serveri mund të jetë i paqëndrueshëm. Rindizeni.
- Konfirmimi që marrësi dhe serveri janë lidhur me ruterin LAN me valë/pikën e aksesit në mënyrë të saktë.
- Konfirmimi që serveri të jetë vendosur saktë (faqe 59). Konfirmimi që marrësi të jetë regjistruar në server dhe të lejojë transmetimin e muzikës nga serveri.
- Kur sistemi lidhet me rrjetin me valë, lëvizni marrësin dhe ruterin LAN me valë/pikën e aksesit më pranë njëra-tjetrës.
- Nëse funksioni ICF (Internet Connection Firewall) është aktiv në kompjuter, kjo mund të parandalojë marrësin që të lidhet me kompjuterin (vetëm kur kompjuteri përdoret si server). Mund të jetë e nevojshme që të ndryshoni cilësimet e murit mbrojtës për të lejuar që marrësi të lidhet. (Për hollësi rreth ndryshimit të cilësimeve të murit mbrojtës, referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me kompjuterin tuaj).
- Nëse keni nisur marrësin ose keni kryer rikuperimin e sistemit në server, kryeni sërish cilësimet e rrjetit (faqe 38).

Serveri (si p.sh. një kompjuter) nuk shfaqet në listën e serverëve. (Në ekranin e televizorit shfaqet "No server is available").

- Mund ta keni ndezur këtë marrës përpara se të keni ndezur serverin. Rifreskoni listën e serverëve (faqe 64).
- Sigurohuni që ruteri LAN me valë/pikë aksesit të jetë ndezur.
- Sigurohuni që serveri është i ndezur.
- Konfirmimi që serveri të jetë vendosur saktë (faqe 59). Konfirmimi që marrësi të jetë regjistruar në server dhe të lejojë transmetimin e muzikës nga serveri.
- Konfirmimi që marrësi dhe serveri janë lidhur me ruterin LAN me valë/pikën e aksesit në mënyrë të saktë. Kontrolloni informacionin e cilësimeve të rrjetit (faqe 96).
- Referojuni udhëzimeve të përdorimit të ruterit LAN me valë/pikës së aksesit dhe kontrolloni cilësimin multikast. Nëse cilësimi multikast është aktivizuar në ruterin LAN me valë/pikën e aksesit, çaktivizojeni atë.

Të dhënat audio nuk mund të luhen normalisht.

- Është zgjedhur "Shuffle Play". Shtypni SHUFFLE vazhdimisht derisa "Shuffle On" të zhduket.

Luajtja nuk fillon ose nuk kalon automatikisht te pjesa ose te skedari tjetër.

- Sigurohuni që skedari audio që po provoni të luani të jetë në një format që mbështetet nga ky marrës (faqe 48).
- Skedarët WMA me mbrojtje të drejtave të autorit DRM nuk mund të luhen. Për të ditur si të kontrolloni mbrojtjen e të drejtave të autorit të një skedari WMA, shikoni faqe 67.

Tingulli kapërcehet gjatë riprodhimit.

- Gjerësia e bandës së LAN-it tuaj me valë mund të jetë shumë e vogël. Lëvizeni marrësin dhe ruterin LAN me valë/ pikën e aksesit më pranë njëra-tjetrës, pa pengesa mes tyre.
- Kur përdorni si server një kompjuter, kompjuteri mund të jetë duke ekzekutuar shumë aplikacione. Nëse softueri i antivirusit është aktiv në kompjuter, çaktivizojeni përkohësisht softuerin duke qenë se ai ka nevojë për një sasi të madhe burimesh të sistemit.
- Në varësi të mjedisit të rrjetit, mund të mos jetë e mundshme të luhen pjesët me më shumë se një pajisje që funksionin njëkohësisht. Çaktivizoni pajisjen tjetër për të aktivizuar marrësin që të luajë pjesët audio.

Shfaqet "Cannot play".

- Nuk mund të luani skedarë të tjerë veç skedarëve audio.
- Konfirmoni që serveri të jetë vendosur saktë (faqe 59). Konfirmoni që marrësi të jetë regjistruar në server dhe të lejojë transmetimin e muzikës nga serveri.
- Kontrolloni që të konfirmoni nëse skedari audio në server është dëmtuar apo fshirë. Drejtjuni udhëzimeve të përdorimit që vijnë me serverin.
- Nuk mund të luani pjesët e mëposhtme:
 - Një pjesë që shkel kufizimet e riprodhimit.
 - Një pjesë me informacion të parregullt mbi të drejtat e autorit.
 - Një pjesë që e keni blerë në një dyqan muzike në internet që nuk lejon transmetimin në rrjetin e shtëpisë.
 - Një pjesë në format të pambështetur nga marrësi (faqe 48).
- Konfirmoni që pjesa e zgjedhur nuk është fshirë nga serveri. Nëse pjesa është fshirë, zgjidhni një pjesë tjetër.
- Sigurohuni që ruteri LAN me valë/pikë aksesi të jetë ndezur.
- Sigurohuni që serveri është i ndezur.

- Serveri mund të jetë i paqëndrueshëm. Rindizeni.
- Konfirmoni që marrësi dhe serveri janë lidhur me ruterin LAN me valë/ pikën e aksesit në mënyrë të saktë.

Shfaqet "No Track".

- Nëse në dosjen e zgjedhur nuk ka pjesë apo dosje, nuk mund të zgjeroni dosjen për të shfaqur përmbajtjen.

Nuk mund të luani një pjesë me format WMA të mbrojtur me të drejta autori.

- Për të ditur si të kontrolloni mbrojtjen e të drejtave të autorit të një skedari WMA, shikoni faqe 67.

Nuk mund të zgjidhet pjesë audio e zgjedhur më parë.

- Informacioni i pjesës audio mund të jetë ndryshuar në server. Zgjidhni sërish serverin në listën e serverëve (faqe 64).

Pajisjet në rrjetin e shtëpisë nuk mund të lidhen me marrësin.

- "Network Standby" mund të jetë vendosur në "Off". Ndizni marrësin ose vendoseni "Network Standby" në "On" në menyën e Cilësimeve të rrjetit (faqe 96).
- Konfirmoni që rrjeti të jetë konfiguruar saktë. Nëse jo, nuk mund të kryhet lidhja (faqe 96).
- Pajisja në listën e pajisjeve është vendosur në "Not Allow" (faqe 66) ose pajisja nuk është shtuar në listën e pajisjeve (faqe 66).
- Është vendosur maksimumi prej 20 pajisjesh që mund të lidhen. Fshini pajisjet e panevojshme në listën e pajisjeve dhe më pas vendosni "Auto Access" në "Allow" (faqe 66).
- Përdorimi i serverit nga marrësi pezullohet nëse marrësi kryen një nga veprimet e mëposhtme.
 - Luajtja e një pjesë të ruajtur në server (marrësi përdoret si luajtës)
 - Përditësimi i softuerit
 - Formatimi i sistemit

Marrësi nuk mund të ndizet automatikisht kur aksesohet nga pajisje të tjera në rrjet.

- Marrësi vetë nuk mbështet standardin Wake-on-LAN. Prandaj, marrësi nuk mund të ndizet nga Wake-on-LAN kur "Network Standby" është caktuar në "Off" në menynë "Network Settings". Caktoni "Network Standby" në "On" në mënyrë që marrësi të mund të reagojë ndaj veprimeve të pajisjeve në rrjet (faqe 96).

Pajisjet në rrjet nuk mund të ndezin marrësin.

- Marrësi nuk mund të ndizet automatikisht me ndezje Wake-on-LAN që përdoret nga pajisje të tjera në rrjet.

Marrësi nuk mund të luajë pjesën që po luhet aktualisht nga organizuesi i PARTY.

- Organizuesi i PARTY po luan një pjesë në format audio që nuk mund të luhet në marrës.
- Mund të duhet pak kohë përpara se të dalë tingulli i riprodhimit.

Marrësi bashkohet në një PARTY aksidentalisht.

- Nëse niset më shumë se një PARTY kur bashkohet marrësi, marrësi mund të mos jetë në gjendje të bashkohet me PARTY që dëshironi. Mbyllni PARTY tjetër dhe më pas bashkohuni me PARTY që dëshironi.

AirPlay

Marrësi nuk gjendet nga një pajisje iOS.

- Kontrolloni konfigurimin e murit mbrojtës së softuerit të sigurisë. Referojuni uebsajtit (faqe 120) për detaje.
- Sigurohuni që pajisja iOS ose kompjuteri me iTunes të jetë lidhur me rrjetin e shtëpisë.
- Përditësoni versionin e softuerit AirPlay të marrësit dhe pajisjes iOS sipas versionit më të fundit (faqe 72).

Tingulli kapërcehet.

- Tingulli mund të kapërcehet në varësi të faktorëve si p.sh. mjedisi i rrjetit kur përdorni një rrjet me valë.
- Serverët janë të mbingarkuar. Mbyllni të gjitha aplikacionet e panevojshme që po përdorni aktualisht.

Ky marrës nuk mund të përdoret.

- Përditësoni versionin e softuerit të pajisjes iOS sipas versionit më të fundit (faqe 73).
- Përditësoni versionin e softuerit të marrësit në versionin e fundit (faqe 73).
- Sigurohuni që asnjë pajisje tjetër të mos transmetojë në të njëjtën kohë në pajisjen që mbështet AirPlay.

Butonat si ◀ +/-, ▶, II, ■, ◀◀, ▶▶, SHUFFLE dhe REPEAT nuk funksionojnë.

- Sigurohuni që të jenë aktive cilësimet që lejojnë iTunes të pranojnë kontroll nga ai marrës.
- Marrësi nuk është zgjedhur si altoparlant në distancë për pajisjen iOS. Zgjidhni marrësin si altoparlantin e rrjetit.

SEN

Marrësi nuk mund të lidhet me një shërbim.

- Sigurohuni që ruteri LAN me valë/pikë aksesit të jetë ndezur.
- Kontrolloni gjendjen e rrjetit. Shihni "Connection Status" te "Information" në menynë "Network Settings". Nëse shfaqet "Not connected", konfiguroni sërish lidhjen e rrjetit (faqe 38).
- Kur sistemi lidhet me rrjetin me valë, lëvizeni marrësin dhe ruterin LAN me valë/ pikën e aksesit më pranë njëra-tjetrës.

- Nëse kontrata juaj me ofruesin e shërbimit të internetit kufizon lidhjen e internetit vetëm me një pajisje njëkohësisht, kjo pajisje nuk do të mund të ketë akses në internet kur është e lidhur një pajisje tjetër. Konsultohuni me operatorin ose ofruesin e shërbimit.

Tingulli kapërçehet.

- Gjerësia e bandës së LAN-it tuaj me valë mund të jetë shumë e vogël. Lëvizeni marrësin dhe ruterin LAN me valë/ pikën e aksesit më pranë njëra-tjetrës, pa pengesa mes tyre.

"BRAVIA" Sync (Control for HDMI)

Funksioni "Control for HDMI" nuk punon.

- Kontrolloni lidhjen HDMI (faqe 30, 31).
- Sigurohuni që "Control for HDMI" të jetë caktuar në "On" në menyën "HDMI Settings" (faqe 94).
- Sigurohuni që pajisja e lidhur të jetë e përputhshme me funksionin Control for HDMI.
- Kontrolloni cilësimet e Control for HDMI në pajisjen e lidhur. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve të lidhura.
- Nëse e shkëputni kabllon HDMI ose ndryshoni lidhjen, përsëritni procedurat e "Përgatitja për "BRAVIA" Sync" (faqe 77).
- Kur "Control for HDMI" është e vendosur në "Off", "BRAVIA" Sync nuk punon si duhet, edhe nëse pajisja është e lidhur me folenë HDMI IN.
- Llojet dhe numri i pajisjeve që mund të komandohen nga funksioni "BRAVIA" Sync janë të kufizuara në standardin HDMI CEC si më poshtë.
 - Pajisje regjistruese (regjistruese disqesh Blu-ray, regjistruese DVD etj.): deri në 3 pajisje

- Pajisje luajtëse (luajtës Blu-ray Disc, luajtës DVD, etj): deri në 3 pajisje
- Pajisjet e lidhura me sintonizuesin: deri në 4 pajisje (marrësi përdor një prej tyre për veprimet e në ndërfaqen GUI).
- Marrësi AV (sistemi audio): deri në 1 pajisje

Pajisja që mbështet burim MHL nuk mund të ngarkohet.

- Kontrolloni nëse marrësi është i ndezur.
- Sigurohuni që pajisja është lidhur mirë.

Nuk ka figurë nga pajisja që mbështet burim MHL.

- Kontrolloni cilësimin e pajisjes suaj. Për hollësi drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes.
- Kontrolloni nëse pajisja është lidhur me kablo MHL në folenë HDMI/MHL (VIDEO 2) IN (faqe 31).

Telekomanda

Telekomanda nuk funksionon.

- Drejtojeni telekomandën drejt sensorit të telekomandës në marrës (faqe 9).
- Largoni çdo pengesë mes telekomandës dhe marrësit.
- Zëvendësoni të gjitha bateritë në telekomandë me të reja, nëse janë të shkarkuara.
- Sigurohuni që të zgjidhni hyrjen e saktë në telekomandë.
- Kur përdorni një pajisje të programuar jo Sony, telekomanda mund të mos funksionojë si duhet, në varësi të modelit dhe të prodhuesit të pajisjes.

Mesazhet e gabimit

Nëse ka keqfungsionim, shfaqet një mesazh në panelin e ekranit. Mund të kontrolloni gjendjen e mesazhit me këtë mesazh. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

PROTECTOR

Marrësi do të fiket automatikisht pas pak sekondash, kontrolloni si më poshtë:

- Mund të ketë shkarkim elektrik apo probleme furnizimi me korrent. Shkëputni kordonin elektrik nga priza dhe rivendoseni pas 30 minutash.
- Marrësi është i mbuluar dhe vrimat e ajrimit janë bllokuar. Hiqni sendet që kanë zënë vrimat e ajrimit të marrësit.
- Afërsia e altoparlantëve të lidhur është nën distancën e vlerësuar të afërsisë së shënuar në panelin e pasmë të marrësit. Ulni volumnin.
- Shkëputni kordonin elektrik nga priza, lëreni marrësin të ftohet për 30 minuta ndërsa shihni për probleme si më poshtë:
 - Shkëputni të gjithë altoparlantët dhe altoparlantin bas.
 - Kontrolloni nëse telat e altoparlantëve janë përthyer fort në të dy skajet.
 - Lidhni përpara altoparlantin e përparmë, ngrini volumnin dhe mbajeni në punë marrësin për së paku 30 minuta derisa të ngrohet. Në vijim, lidhni secilin altoparlant me radhë dhe testojini veç e veç derisa të zbuloni cili altoparlant shkakton gabimin e mbrojtjes.

Pasi të kontrolloni sa më lart dhe të ndreqni problemet e mundshme, futeni kordonin elektrik në prizë dhe ndizni marrësin. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

USB FAIL

Ka mbingarkesë elektrike në folenë ψ (USB). Marrësi do të fiket automatikisht pas pak sekondash. Kontrolloni iPod/iPhone ose pajisjen USB dhe shkëputeni e ndizeni sërish.

Për mesazhe të tjera shihni "Lista e mesazheve pas matjes së "Auto Calibration"" (faqe 89), "Lista e mesazheve e iPod/iPhone" (faqe 48), "Lista e mesazheve të USB-së" (faqe 50) dhe "Lista e mesazheve të funksioneve të rrjetit" (faqe 74).

Pastrimi i memories

Seksionet e referencave

Për të pastruar	Shihni
Të gjitha cilësimet e memorizuara	faqe 85
Fushat zanore të përshtatura	faqe 58

Rreth informacionit për mbështetjen

Për hollësi rreth informacioneve më të fundit për marrësin vizitoni faqen e mëposhtme të internetit.

Për klientët në Evropë:

<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në Australi:

<http://www.sony-asia.com/support>

Specifikimet

Seksioni i amplifikatorit

Fuqia minimale e daljes RMS¹⁾
(6 om, 20 Hz – 20 kHz, THD 0,09%)
100 W + 100 W

Fuqia në dalje në modalitetin stereo¹⁾
(6 om, 1 kHz, THD 1%)
120 W + 120 W

Fuqia në dalje në modalitetin rrethues^{1) 2)}
(6 om, 1 kHz, THD 0,9%)
165 W për kanal

- ¹⁾ Matur në kushtet e mëposhtme: Kërkesat e ushqimit elektrik: 230 V AC, 50 Hz
²⁾ Dalja referencë e fuqisë për altoparlantët e përparmë, qendrorë, rrethues, rrethues të pasmë dhe të lartë të përparmë. Në varësi të cilësimeve të fushës zanore dhe të burimit, mund të mos ketë fare dalje të zërit.

Reagimi i frekuencës

Analoge
10 Hz – 100 kHz, +0,5/-2 dB
(me fushën zanore dhe balancuesin e kapërcyer)

Hyrja

Analoge
Ndjeshmëria: 500 mV/50 kiloom
S/N³⁾: 105 dB (A, 500 mV⁴⁾)
Dixhital (koaksial)
Rezistenca: 75 om
S/N: 100 dB (A, 20 kHz LPF)
Dixhital (optik)
S/N: 100 dB (A, 20 kHz LPF)

Dalja (analoge)

ZONE 2
Tensioni: 500 mV/1 kiloom
SUBWOOFER
Tensioni: 2 V/1 kiloom

Balancuesi

Nivelet e përfërcimit
±10 dB, hapi 1 dB

³⁾ INPUT SHORT (me fushën zanore dhe balancuesin e kapërcyer).

⁴⁾ Rrjeti i vlerësuar, niveli i hyrjes.

Seksioni i sintonizuesit FM

Diapazoni i sintonizimit
87.5 MHz – 108.0 MHz
(hapa nga 50 kHz)

Antenë (ajrore)

Antena FM me tel (ajrore)

Terminalet e antenës (ajrore)

75 om, të pabalancuara

Seksioni i sintonizuesit AM

Diapazoni i sintonizimit
531 kHz – 1,602 kHz (hapa nga 9 kHz)

Antenë (ajrore)

Antena në formë kornize (ajrore)

Seksioni i videos

Hyrjet/daljet

Video:
1 Vp-p, 75 om
COMPONENT VIDEO:
Y: 1 Vp-p, 75 om
Pb: 0,7 Vp-p, 75 om
Pr: 0,7 Vp-p, 75 om
80 MHz HD Pass Through

Video HDMI

Hyrja/dalja (grup repetitor HDMI)

Formati	2D	3D		
		Frame packing	Side-by-Side (Half)	Over-Under (Top-and-Bottom)
4096 × 2160p @ 23,98/24 Hz	○	-	-	-
3840 × 2160p @ 29,97/30 Hz	○	-	-	-
3840 × 2160p @ 25 Hz	○	-	-	-
3840 × 2160p @ 23,98/24 Hz	○	-	-	-
1920 × 1080p @ 59,94/60 Hz	○	-	○	○
1920 × 1080p @ 50 Hz	○	-	○	○
1920 × 1080p @ 29,97/30 Hz	○*	○	○*	○*
1920 × 1080p @ 25 Hz	○*	○	○*	○*
1920 × 1080p @ 23,98/24 Hz	○*	○	○*	○*
1920 × 1080i @ 59,94/60 Hz	○*	○	○*	○*
1920 × 1080i @ 50 Hz	○*	○	○*	○*
1280 × 720p @ 59,94/60 Hz	○*	○	○*	○*
1280 × 720p @ 50 Hz	○*	○	○*	○*
1280 × 720p @ 29,97/30 Hz	○*	○	○*	○*
1280 × 720p @ 23,98/24 Hz	○*	○	○*	○*
720 × 480p @ 59,94/60 Hz	○*	-	-	-
720 × 576p @ 50 Hz	○*	-	-	-
640 × 480p @ 59,94/60 Hz	○*	-	-	-

* Këto formate mbështeten nga MHL kur lidhni pajisje burim që mbështesin MHL në folenë HDMI/MHL (VIDEO 2 IN).

Seksioni për MHL-në

Versioni i mbështetur i MHL-së

Përmban MHL 2

Korrenti maksimal

900 mA

Seksioni për iPod/iPhone

DC 5V 1.0 A MAX

Seksioni për USB-në

Formati i mbështetur*

MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3):

32 kbps – 320 kbps, VBR

AAC:

16 kbps – 320 kbps, CBR, VBR

WMA9 Standard:

40 kbps – 320 kbps, CBR, VBR

WAV:

8 kHz – 192 kHz, 16 bit PCM

8 kHz – 192 kHz, 24 bit PCM

FLAC:

8 kHz – 192 kHz, 16 bit FLAC

44.1 kHz – 192 kHz, 24 bit FLAC

* Nuk mund të garantohet pajtueshmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues, pajisjet regjistruese dhe mjetet regjistruese.

Shpejtësia e transferimit

High-speed

Pajisja e mbështetur USB

Kategori e ruajtjes në masë

Korrenti maksimal

500 mA

Seksioni NETWORK

Rrjeti LAN Ethernet

10BASE-T/100BASE-TX

Rrjeti LAN me valë

Standardet e përputhshme:

IEEE 802.11 b/g

Mbrojtja:

WEP 64 bit, WEP 128 bit, WPA/

WPA2-PSK (AES), WPA/

WPA2-PSK (TKIP)

Frekuenca e radios:

2,4 GHz

Të përgjithshme

Zona	Furnizimi me energji
Evropë	230 V AC, 50/60 Hz
Australi	230 V AC, 50 Hz

Konsumi i energjisë

240 W

Konsumi i energjisë (gjatë modalitetit të gatishmërisë)

0,3 W (kur "Control for HDMI", "Pass Through" dhe "Network Standby" janë caktuar në "Off" dhe marrësi në zonën 2 është fikur.)

Përmasat (gjerësia/lartësia/thellësia)
(afërsisht)

430 mm × 172 mm × 329,4 mm duke përfshirë pjesët e dala dhe komandat

Masa (afërsisht)

10,0 kg

Modelimi dhe specifikimet mund të ndryshojnë pa njoftim.

Indeksi

Identifikuesit numerikë

2 kanale 53
4K Scaling 94
5.1-kanalëshe 23
7.1-kanalëshe 23

A

A/V Sync 93, 101
Adresë fikse IP 40
Advanced Auto Volume 93
AirPlay 72
Alto 57, 100
AM 51
Antena e rrjetit LAN me valë 13
Audio Out 94
Audio Settings 92
Auto Phase Matching 90
Auto Standby 97
Auto Tuning 51

B

Bas 57, 100
BRAVIA Sync
përgatitja 77

C

Center Speaker Lift Up 92
Cilësimet e altoparlantit 99
Cilësimet e audios 101
Cilësimet e EQ 100
Cilësimet e hyrjes 100
Cilësimet e Kalibrimin automatik 98
Cilësimet e nivelit 98
Cilësimet e sintonizuesit 101
Cilësimet e sistemit 102

Cilësimet HDMI 101
Cilësimet rrethuese 100
Control for HDMI 94
Crossover frequency 91

D

Dalja audio 101
DCAC (Kalibrimi Automatik
i Kinemasë Dixhitale) 36
Device Name 96
Digital Legato Linear (D.L.L.) 92, 101
Direct Tuning 52
Distance Unit 92
DLNA 59
Dolby Digital EX 22
Dual Mono 93, 101

E

Easy Setup 36
EQ Settings 57

F

Fast View 95
FM 51
Frekuenca mbikalesë 100
Fuqia e sinjalit LAN me valë 12

G

Gatishmëria automatike 102

H

HD-D.C.S. 54
HDMI 101
HDMI Settings 94
HDMI Subwoofer Level 95

Home Network 65
Home Theatre Control 79
Hyrja 44

I

Input Assign 81
INPUT MODE 80
Input Settings 95
IP Setting 96
iPod/iPhone 33
 Karikimi 47
 Modelet e përputhshme 46

K

Kërkim sipas alfabetit 16
Kompresimi i diapazonit
 dinamik 93, 101
Kontrolli i audios së sistemit 77
Kontrolli për HDMI 101
Konvertim me rritje rezolucioni 21

L

Language 97
Lidhja
 altoparlantët 25
 antenat 33
 iPod/iPhone 33
 Me kablllo 35
 Me valë 35
 Pajisja MHL 31
 Pajisja USB 33
 Rrjeti 34
 TV 27
Lidhja me dy amplifikatorë 82
Lista e serverëve 64
Listen 43
Luajtës CD 30
Luajtës disqesh Blu-ray 30

Luajtës DVD 30
Luajtës Super Audio CD 30

LI

Lloji i Kalibrimit automatik 98

M

Menyja 85, 98
Menyja e cilësimeve 85
Mesazhi
 Auto Calibration 89
 Gabimi 120
 iPod/iPhone 48
 USB 50
 Veçoritë e rrjetit 74
MHL 31
Modaliteti FM 51, 101
Modaliteti i filmit 54
Modaliteti i muzikës 55
Motivi i altoparlantit 99
Music Services 68
Muting 45

N

Name Input 52
Ndërfaqja GUI 42
Network Settings 96
Network Standby 96
Network Update 97
Niveli i altoparlantit bas HDMI 101
Niveli i efektit 54, 100

Nj

Njësia e distancës 100

O

One-Touch Play 77

P

Pajisja USB 33, 48
Paneli i ekranit 11
Paraqitja e informacionit në panelin e ekranit 102
PARTY STREAMING 70
Pass Through 94, 101
Pastrimi
 fusha zanore 58
 memoria 85
 telekomanda 107
PlayStation 3 30
Preset Memory 52
PROTECTOR 120
Pure Direct 58

R

RDS 53
Regjistrues DVD 30
Remote Easy Control 79
Rivendosja 85

Rr

Rrjet me kablo 42
Rrjet me valë 38

S

Scene Select 78
SEN 68
Serveri 59
Sintonizues satelitor 30
Sintonizues televizioni kabllor 30
Sintonizuesi 51
Skanimi i Pikës së Aksesit 39
Sleep Timer 15
Software Update Notification 97
Software Version 97
Sound Effects 53
Sound field 53

Speaker Connection 90
Speaker Pattern 90
Speaker Settings 88
Stacionet e paravendosura 52
System Power-Off 78
System Settings 97

Sh

Shumëzonësh 83

T

Telekomanda 14, 103
Test Tone 92
Tingulli i testimit 98
TV 27
TV SideView 67

U

USB FAIL 120

V

VCR 30

W

Wake-on-LAN 65
Watch 43
WPS
 Kodi PIN 41
 Shtyp butonin 41

Z

Zona 2 83

MARRËVESHJA E LICENCËS SË PËRDORUESIT PËR SOFTUERIN SONY

Ju duhet të lexoni me kujdes marrëveshjen e mëposhtme përpara se të përdorni SOFTUERIN SONY (i përkufizuar më poshtë). Përdorimi i SOFTUERIT SONY tregon se ju pranoni marrëveshjen. Nëse nuk jeni dakord me të, nuk autorizoheni të përdorni SOFTUERIN SONY.

E RËNDËSISHME - LEXONI ME KUJDES: Kjo Marrëveshje Licence për Përdoruesin ("EULA") është një marrëveshje ligjore mes jush dhe Sony Corporation ("SONY"), prodhuesit të pajisjes suaj të harduerit Sony ("PRODUKTI") dhe licencuesit të SOFTUERIT SONY. Të gjithë softuerët Sony dhe softuerët e palëve të treta (përveç softuerëve që janë subjekte të licencës së tyre të veçantë) të përfshirë me PRODUKTIN tuaj dhe çdo përmirësim dhe përditësim i tyre do të referohen këtu si "SOFTUERI SONY". Ju mund të përdorni SOFTUERIN SONY vetëm me PRODUKTIN.

Duke përdorur SOFTUERIN SONY, ju bini dakord të zbatoni kushtet e kësaj EULA. Nëse nuk bini dakord me kushtet e kësaj EULA, SONY nuk do t'juja licencojë SOFTUERIN SONY. Në rast të tillë, ju nuk duhet të përdorni SOFTUERIN SONY.

LICENCA E SOFTUERIT SONY

SOFTUERI SONY mbrohet nga ligjet e të drejtave të autorit dhe marrëveshjet ndërkombëtare të të drejtave të autorit, si edhe ligje dhe marrëveshje të tjera të pronës intelektuale. SOFTUERI SONY licencohet, nuk shitet.

DHËNIA E LICENCËS

Të gjithë titujt, të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të SOFTUERIT SONY dhe në të, zotërohen nga SONY ose licencuesit e tij. Kjo EULA ju jep juve të drejtën të përdorni SOFTUERIN SONY vetëm për përdorim personal.

PËRSHKRIMI I KËRKESAVE, PENGESAVE, TË DREJTAVE DHE KUFIZIMEVE

Kufizimet. Ju nuk mund të kopjoni, modifikoni, zbrërtheni për qëllim publikimi, zbrërtheni ose çmontoni SOFTUERIN SONY plotësisht ose pjesërisht.

Ndarja e komponentëve. SOFTUERI SONY licencohet si një produkt i vetëm. Pjesët e tij nuk mund të ndahen.

Përdorimi në një PRODUKT të vetëm. SOFTUERI SONY mund të përdoret vetëm në një PRODUKT të vetëm.

Dhënia me qira. Ju nuk mund të jepni me qira apo me rentë SOFTUERIN SONY.

Transferimi i Softuerit. Ju mund t'i transferoni në mënyrë të përhershme të gjitha të drejtat tuaja sipas kësaj EULA vetëm kur SOFTUERI SONY transferohet së bashku me PRODUKTIN dhe si pjesë e tij, me kusht që ju të mos ruani asnjë kopje, të transferoni të gjithë SOFTUERIN SONY (duke përfshirë, por pa u kufizuar me, të gjitha kopjet, pjesët e komponentëve, mjetet ruajtëse, manualët e përdorimit, manualët e udhëzimeve, materialet e tjera të printuara, dokumentet elektronike, disqet e rikuperimit dhe këtë EULA) dhe marrësi të bjerë dakord me kushtet e kësaj EULA.

Përfundimi. Pa paragjykuar të drejtat e tjera, SONY mund të përfundojë këtë EULA nëse nuk zbatoni kushtet e kësaj EULA. Në këtë rast, kur kërkohet nga SONY, ju duhet të dërgoni PRODUKTIN te një adresë e përcaktuar nga SONY, dhe SONY do t'juja dërgojë PRODUKTIN sërish sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur pasi nga PRODUKTI të jetë fshirë SOFTUERI SONY.

Konfidencialiteti. Ju bini dakord se do ta ruani konfidencial informacionin që ndodhet në SOFTUERIN SONY i cili nuk njihet publikisht dhe se nuk do ta zbuloni këtë informacion te të tjerët pa miratimin paraprak me shkrim të SONY.

AKTIVITETET ME RREZIK TË LARTË

SOFTUERI SONY nuk është tolerant ndaj gabimeve dhe nuk është projektuar, prodhuar apo synuar për përdorim ose rishitje si pajisje kontrolli në linjë në mjediset të rrezikshme që kërkojnë performancë pa gabime, si p.sh. në funksionimin e impianteve bërthamore, navigimin ose sistemet e komunikimit të avionëve, kontrollin e trafikut ajror, makineritë e mbajtjes së drejtpërdrejtë në jetë ose sistemet e armëve, ku dështimi i SOFTUERIT SONY mund të sjellë vdekje, lëndime personale ose dëmtime të rëndë fizik ose mjedisor ("Aktivitetet me rrezik të lartë"). SONY dhe furnitorët e tij heqin dorë në mënyrë specifike nga çdo garanci e shprehur apo e nënkuptuar e përputhshmërisë për Aktivitetet me rrezik të lartë.

PËRJASHTIMI I GARANCISË PËR SOFTUERIN SONY

Ju pranoni shprehimisht dhe bini dakord se përdorimi i SOFTUERIT SONY kryhet duke marrë vetë parasysh rreziqet. SOFTUERI SONY jepet "SIÇ ËSHTË" dhe pa garanci të ndonjë lloji, dhe SONY, shitësit e tij dhe licencuesit e SONY (për qëllime vetëm të këtij paragrafi, kolektivisht të referuar si "SONY"), HEQIN DORË SHPREHIMISHT NGA TË GJITHA GARANCITË, TË SHPREHURA DHE TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË POR PA U KUFIZUAR ME, GARANCITË E NËNKUPTUARA TË TREGTUESHMËRISË DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR. SONY NUK GARANTON SE FUNKSIONET QË PËRMBAN SOFTUERI SONY JANË PA GABIME APO DEFEKTE NË PROGRAMIMI OSE QË DO TË PLOTËSOJNË KËRKESËN TUAJ, DHE SONY NUK GARANTON SE FUNKSIONIMI I SOFTUERIT SONY DO TË KORRIGJOHET. GJITHASHTU, SONY NUK GARANTON APO JEP NDONJË GARANCI NË LIDHJE ME PËRDORIMIN APO REZULTATET E PËRDORIMIT TË SOFTUERIT SONY NË LIDHJE ME KORREKTËSINË E TIJ, SAKTËSINË, BESUESHMËRINË OSE NDRYSHE. ASNJË KËSHILLË APO INFORMACION I DHËNË ME GOJË OSE ME SHKRIM NGA SONY APO NJË PËRFAQËSUES I AUTORIZUAR I SONY NUK DO TË KRIJOJË GARANCI OSE NË NDONJË MËNYRË DO TË ZGJEROJË QËLLIMIN E KËSAJ GARANCIE. DISA JURIDIKSIONE NUK LEJOJNË PËRJASHTIMIN E GARANCIVE TË NËNKUPTUARA, RAST NË TË CILIN PËRJASHTIMI I MËSIPËRM NUK DO T'JU APLIKOHET JUVE.

Pa kufizuar sa më lart, parashikohet specifikisht se SOFTUERI SONY nuk është projektuar apo synuar për përdorim me ndonjë produkt ndryshe nga PRODUKTI. SONY nuk jep asnjë garanci se produkti, softueri, përmbajtja apo të dhënat e krijuara nga ju apo një palë e tretë nuk do të dëmtohen nga SOFTUERI SONY.

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

SOFTUERI, FURNITORËT E TIJ DHE LICENCUESIT E SONY (për qëllime vetëm të këtij paragrafi, kolektivisht të referuar si "SONY"), NUK DO TË JENË PËRGJEGJËS PËR DËME RASTËSORE APO PASUEE NË LIDHJE ME SOFTUERIN SONY, QË LINDIN NGA OSE BAZUAR NË SHKELJEN E NDONJË GARANCIE TË SHPREHUR APO TË NËNKUPTUAR, SHKELJE KONTRATE, NEGLIZHENCË, PËRGJEGJËSI E CAKTUAR APO NDONJË TEORI TJETËR LIGJORE. DËME TË TILLA PËRFSHIJNË, POR NUK KUFIZOHEN ME, HUMBJE TË FITIMIT, HUMBJE TË TË ARDHURAVE, HUMBJE TË TË DHËNAVE, HUMBJE TË PËRDORIMIT TË PRODUKTTIT OSE PAJISJE TJETËR SHOQËRUESE, KOHË JOPRODUKTIVE DHE KOHË TË PËRDORUESIT, PAVARËSISHT NËSE SONY ËSHTË KËSHILLUAR MBI MUNDËSINË E KËTYRE DËMEVE. NË ÇDO RAST, E GJITHË PËRGJEGJËSIA E SONY NDAJ JUSH SIPAS PARASHIKIMEVE TË KËSAJ EULA DO TË KUFIZOHET ME SHUMËN E PAGUAR AKTUALISHT TË CAKTUESHME PËR SOFTUERIN SONY.

EKSPORTET

Nëse përdorni apo transferoni SOFTUERIN SONY në ose drejt një vendi tjetër ndryshe nga vendi juaj i qëndrimit, ju do të zbatoni ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me eksportet, importet dhe doganat.

LIGJIDREJTUES

Kjo EULA do të shpjegohet, drejtohet, interpretohet dhe aplikohet në përputhje me ligjet e Japonisë, pa marrë parasysh konfliktet e dispozitave ligjore. Çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo EULA do t'i nënshtrohet vendin ekskluziv dhe juridiksionit të gjykatave të Tokios, Japoni, dhe ju dhe SONY përmes kësaj bini dakord për vendin dhe juridiksionin e këtyre gjykatave. JU DHE SONY HIQNI DORË NGA TË DREJTAT E GJYKIMIT NGA NJË JURI, NË LIDHJE ME ÇËSHTJET QË LINDIN APO JANË RRJEDHOJË E KËSAJ EULA.

RIFORMULIMI

Nëse ndonjë pjesë e kësaj EULA konsiderohet si e pavlefshme dhe e pazbatueshme, pjesët e tjera do të mbeten të vlefshme.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë EULA ose garancinë e kufizuar të dhënë këtu, ju mund të kontaktoni me SONY duke i shkruar SONY në adresën e caktuar të kontaktit të përmendur në fletën e garancisë brenda paketimit të produktit.



<http://www.sony.net/>

4-454-443-41(1) (AL)



* 4 4 5 4 4 4 3 4 1 * (1)